Përparim Hysi

"LOTËT" E KUMURISË

Tregime

Tiranë, 2014

Redaktor: Nuri Plaku

Design: Da Vinci Studio

ISBN: 978-9928-178-22-3

© Autori

Shtëpia Botuese Shtypshkronja ILAR®

PËRMBJATJA

"Lotët" e kumurisë.....5
Si po ia çon, moj dashuri e parë?!!!.....11
Të lutem, falëm! 16
Firma e Rrahmanit.....20
Ik e ik nëpër Zhapokikë.....26
"Lente" për sytë.....31
Tek Shega e Muratit.....34
Një imazh që nuk dua të harroj.....38
Ndjesë Vezirit!.....43
Ndal tri here?!.....45
Dervishi.....52
Profesori.....56
As me qepë dhe as me hudhëra!.....61
“Dëgjoni, milet! …”.....65
Bejtexhiu.....70
Gjykatësi.....74
“Disidenti” i çuditshëm.....80
Oha, Balash!... 86
“Kolera” në fshat?!!!.....92
Rrëfimet e një "mëkatari"/1.....98
Rrëfimet e një mëkatari /2.....104
Rrëfimet e një "mëkatari?!"/3 109
Memuaret e një zboristi...*.....114
Këpucët me qafa*.....121

tjetrin, por di që vetëm që nuk u faktua njohja, e degdisën në Skrapar. Titullarin RR... e futën në burg, ndërsa Hamit Matjanin e varën. Doktorin e degdisën po kurrë nuk e hapi gojën për këpucët me qafa dhe kujt ia dhuroi ato. Por kusuret e këtij mjeku kaq të mirë, nuk mbarojnë me Skraparin. Syri «vigjelent» nuk harronte. E arrestuan dhe e përfshin me grupin armiqësor te Teme Sejkos. E dënuan me 15 vjet burg dhe vetëm në fund të pleqërisë së vonë, doli nga burgu. U kthye pranë familjes, në Fier, dhe, sa erdhi demokracia ndërroi jetë.

Duke sjellë veç këto pasazhe nga jeta e këtij mjeku, them se ia vlen që të njihesh me të. Ai nuk qe vetëm një përfaqësues i ndejnjë i kohortës së mjekëve të ndershëm, besnik të betimit të Hiopkratit, por dhe njeri me shpirt të madh dhe besnik deri në vetmohim.

Le të jetë ky shkrim imi, si një homazh i bukur për të mbetur në kujtesë të të gjithë atyre që e lexojnë dhe atyre që e kanë njohur.

**për arssye subjektive kam ndërhyrë tek tregimi*

Tiranë, 8 janar 2013

PARATHËNIE

Koleg i nderuar Përparim,

Të falënderoj për kënaqësinë e papritur që më dhe sot me essenë aq të bukur të Zborit tënd të dikurshëm! Nuk di nga jeni! Kam lexuar diku, në s'gaboj se keni qënë mësues diku nga Myzeqeja, por tregimi i sotëm i mrekullueshëm më thotë se jeni diku nga labëria ime, pasi rrëfimi dhe humori të rjedh si gjalpi i deleve që ushqehen me luleverdha në lëndinat e staneve (atje ku jam rritur në fëmini). Kështuqë, kudo që ke qënë, gjaku nuk të është holluar si lëng qershie të fushave. Mbase gaboj, dhe për këtë tërhiqem si qenushi qe"ka gabuar duke i lehur një mysafiri të mirë! Është tregim që s'të harrohet, me copëza jete e valë shpirti nga të tuat. Ia lexova dhe gruas (edhe pse ka mbaruar letërsi në Universitet, është nga Vlora dhe e kupton këtë gjuhë. Ca humor bëri sikur s'i donte a s'i kuptonte, kurse sytë i ndrinin nga kujtimet e largëta. Sidoqoftë, ke dhe përshëndetjet e saj! Tregimi rrëf yer aq mjeshtërisht në gjuhën më të kulluar

labe, do dhe një padstrim a lëmim, mendimi im, që të mbetet si hëna prej ari të qëruar sipër tufës së deleve! Të uroj shëndet e mbarësi - një vëllim qoftë dhe me disa tregimeve të tilla.

Agim Shehu

Titullari i pushtetit në Lushnje sh. RR... e kish thirrur në një bisedë kokë më kokë doktor Miçon.

- Kam një mik në shtëpi që, aksidentalisht, është plagosur. Nuk do që të shtrohet në spital dhe, si mik për kokë që e kam, e kam në shtëpinë time. A pranon të vish ta mjekosh në shtëpi?

Doktor Miçoja jo vetëm që qe human, por qe njeri i besës. Jo vetëm pranoi, por shkonte «Ikonjito» tek shtëpia e titullarit dhe e mjekoi të plagourin me aq kujdes, sa e riktheu prapë në gjëndje të mirë shëndetësore. I sëmuri duke ndjekur me vëmëndje gjithë atë kujdes, pothuaj, i miqësua me mjekun. Kur mjeku nuk kishte punë më aty, i sëmuri, befas, pyeti:

- Sa u detyrohem?! (në ato vite lejoheshin vizitat private dhe mjekët shpërbleheshin nga pacientët).

- Ti je miku i sh. RR... , të cilin e kam mik. Mik tani të kam dhe ty. Asnjë gjë nuk dua.

Tani qe radha e «mikut të fliste:

- Me që nuk pranon para, po të falë këto këpucë. Them që ia vlejnë.

Doktori u zu ngusht. E pranoi dhuratën dhe, pasi u përcoll me dashuri, me pacientin-mik, mori këpucët dhe më tej, për fatin e tyre, lexuesi e di. Fatin e këpucëve me qafa lexuesi e di, po nuk di se ç›fshihej pas «mikut» që dhuroi këpucët.

* * *

Në ato vite, hynte e dilte nga jashtë në Shqipëri diverasnti Hamit Matjani. Hyrjet e daljet e tij e kishuin nxjerrë jashtëloje sa e sa herë «syrin vigjelent të sigurimit shqiptar». Hynte e dilte si në shtëpi të tij dhe, mezalla, s›e binte në grackë. Deri sa ndodhi «tradhtia e Kim Filbit që zbardhi dhe faqen e «vigjelentëve tanë». Në vitin 1954 Hamit Matjani u zu rob dhe atje tregoi se ku strehohej. Gjente strehë tek baxhanaku i tij, RR... , atëherë titullar i pushtetit në Lushnjë. Ndërsa e kërkoni gjithandej kënetave dhe pyjeve të Lushnjes, ai, së fundi i plagosur, mjekohej nga dr. Miço Konomi. Nuk e kam marrë vesh në bën»njohjereale» me njëri-

Unë që ndiqja nga afër këtë dialog mes tyre, kur pashë që këpucët u bënë të xhaxhait, i mora në duar dhe, tek rroka lëkurën e butë, pata një ndjesi gëzimi dhe aq prekëse bëhej kjo ndjesi, se këto qenë këpucë të»vërteta» që kapa me duar. Ndjesia bëhej më prekëse, kur i ktheva nga prapa: shkëlqenin gozhdët që shërbenin si «koracë» për shuallin. Xhaxhai e falnderoi mikun e tij për dhuratën dhe ju them se ato këpucë i kaluan nja 10 dimra, në këmbët e xhaxhait tim.

* * *

Për rezultate të «larta» në mësime, babai më hoqi nga Lushnja dhe më nuk e pashë doktor Miçon. Por ja aty nga muaji maj 1955, kur qeshë në klasën e shtatë, unë u sëmura prapë. E lajmëruan xhaxhan në Lushnje dhe ky jo vetëm erdhi me një frymë, por më mori me vete dhe më shtroi jo në Lushnje, po në Fier. Në Fier sapo kishte ardhur dr. Miçoja, shpëtimtari im. Ai m› u gjend sërishmi dhe jo vetëm më shpëtoi, por më mbushi dhe një raport se qeshë në prag të provimeve të lirimit. Saj këtij raporti dhe saj rezultateve të larta në mësime, unë e mora dëftesën e lirimit, pa dhënë provimet.

Kisha dalë nga spitali, por doktor Miçon nuk e hiqja nga goja. Atij i detyroheshim edhe për hatër të timungji, por veçanërisht për ato që kish bërë për mua.

Në Fier dr Miçoja nuk qëndroi gjatë. Atë e transefruan për në Skrapar. Të hiqje një mjek aq të mirë pathollog nga Fieri dhe ta çoje në një provincë siç qe Skrapari, pa tjetër ë diçka kish ndodhur. Natyrisht, që kur iku dr. Miçoja askujt nuk i shkonte në mëndje për arsyet e një degdisjeje të tillë. Por ja që me kalimin e kohës, dalëengadalë, dolën në sipërfaqe dhe arsyet e kësaj «degsisjeje» se transferim nuk i thoshin.

Arsyeja kryesore e këtij «transefrimi» ka lidhje me këpucët me qafa që, ky, doktor Miçoja, i dhuroi timungji në shënjë miqësie. Po çfarë kish ndodhur kështu?!...

* * *

"LOTËT" E KUMURISË

Njeriut të mirë, Ismet Sulçe

Çifti Sulçe, Ismet dhe Protoko Sulçe, mbasi kishin bërë një xhiro goxha të gjatë, për moshën e tyre, sapo u futën në apartamentin e tyre, diku pranë pastiçerisë «Flora». Kishin kohë që banonin aty dhe, për çdo ditë, qëkur dolën në pension e bënin një xhiro të tillë, sado që qe paksa e gjatë. Siç thoshin: një rrugë e dy punë ! Së pari, shkonin deri tek banesa e tyre e vjetër ku, tashmë, banonte djali i tyre i madh, Agimi, së bashku me të shoqen dhe dy fëmijët. Po pikërisht, për fëmijët e djalit se gjysh mos qofsh, thoshin ata dhe, së dyti, për të ruajtur shëndetin si një shtysë që vinte vetvetiu. Djali i tyre shtëpinë e kishte tek «bloku», por jo se qe «blokist» nga ata pinjojtë e ish-kastës. Në këtë pallat ku tash rronte i biri, ata kishin banuar dhe vetë së bashku dhe me tre djem të tjerë. Se katër djem kishte çifti Sulçe.

Po mos kujtoni se historia e strehimit të këtij çifti ka qenë komod gjithë kohën. Përkundrazi. Ardhur si çift në Tiranë qysh mesviteve ‹50-të, ata fillimisht qenë strehuar në një bodrum mu pranë kinema «Agimi» ku kishin një dhomë e një kuzhinë. Punonin në kombinatin e tekstileve «Stalin» në fabrikën e filaturës së leshit dhe, në këtë bodrum u lindën dhe 4 djem njëri pas tjetrit. Dhe, sado që ata rronin, si të thuash, cip mbi cip, kjo nuk i pengonte që të prisnin, pothuaj, për çdo natë mysafirë që nuk reshtnin.

* * *

Çifti Sulçe, burrë e grua, me origjinë qenë nga Skrapari dhe mjafton që aksh skraparlli, i afërm apo sadopak i njohur që zbriste në Tiranë për një hall apo për spital, strehë do gjente tek ajo hyrja një plus një e çiftit Sulçe. Dhe jo vetëm do strehohej, po do trajtohej si një mik i veçantë dhe i ftuar enkas. Tek shkruaj dhe rrëfej, jam një nga ata që e kam hasur atë lloj pritjeje sa nuk kam se si ta harroj. Dhe mos kam qenë i vetmi? Jo. Kjo ka ndodhur me aq shumë njerëz (të afërm të tyre po se po) sa sikur të mundësh e t›i rreshtosh, për një kohë prej 50 vjetësh, pa patur frikë se ekzagjeroj, po lista do qe e tillë që sa do skuqte mysafirët që mësynin kohë paskohe, në këtë derë, aq do ta zbardhte faqen e çiftit Sulçe. Se në thuhet diku: u rrokullis tenxherja dhe gjeti kapakun, ky çift qe si i zgjedhur me dorë. Të dy bujarë e zemërqëruar sa nuk u gjendet gjetkë të gjajshëm. Nuk është se po shkruaj me superlativa për ta. Po mund t›ju them, se nuk përjashtoj qoftë dhe një student apo nxënës të shkollës së mesme që studionte në Tiranë; nuk përjashtoj një ushtar me shërbim po në Tiranë që kishte të bënte , qoftë dhe larg me ta, shto këtu dhe mysafirë që vinin papritur që jo vetëm do hanin një apo dy vakte, por kini kujdes: skraparllinjtë e moshuar janë mësuar që të marrin kur ikin nga miku, edhe bukë me vete. Se kështu ka ndodhur në këtë shtëpi kaq mikpritëse. Dhe sikur kaq të ishte pak, ju do të çuditeni dhe do të tundni kokën me mosbesim kur unë do t›u jap dhe një fakt tjetër: në atë hyrje të një bodrumi tek pallatet «Agimi» çifti Sulçe, vet i gjashtë, kanë strehuar për muaj të tërë, një çift(burrë e grua) se qenë në pritje të marrjes së një hyrjeje dhe Ismeti qe koleg pune, me Medi Gurin nga Skrapari. Ky, i fundit, është gjallë dhe mund të dëshmojë me gojën e tij. Ja i tillë ka qenë ky çift kaq bujarë!

* * *

Kishin mbi 10-vjet në këtë bodrum dhe, ndërsa djemtë po rriteshin, për fat të mirë ata morën zgjerim tri plus një tek pallati i «Shijakut». Ky pallat është mu tek blloku, ngjitur aso kohe me vilën ku rronte Ministri i mbrojtjes, Beqir Balluku. Nga kjo vilë, i

shtëpia jonë) dhe, në vënd të më çonin në Fier, më dërguan dhe më shtruan në Lushnje. Atje se xhaxhai tjetër imi, Avdullai, qe shef shëndetësie. Më shtruan atje (unë qeshë në botën e tejme) dhe, mbas dy ditësh, pashë tek koka ime, veç nënës, xhaxhanë së bashku me një të panjohur. I panjohuri qe mjeku që më shpëtoi: Dr. Dhimitër Konomi apo, siç i thoshin shkurt: Dr. Miçua. Ky qe truphollë, me gjyslykë dhe, tek buzëqeshte, i shpjegonte sime mëje, se sa në rrezik kisha qenë; sa me fat kisha qenë që kish mbrritur me kohë dr. Vojo Bilvia dhe se. së afërmi, pas një jave do dilja. Unë tani kisha shpëtuar nga temperatura dhe qeshë bërë qiqër. Aq mirë e ndjeja veten, sa i merrja si me të qeshur ato që doktori i thoshte sime ëme dhe as që e vrisja mëndjen. kur doktori seç flisnin me timungj, me gjuhën e profesionit. Qeshë si qeshë, po kur dola. isha gati që t›i puthja duarët doktor Miços që hoqi kthetrat e vdekjes nga unë.

Nuk ndënja as një muaj në fshat dhe ja tek kthehem, përsëri, në Lushnje, por këtë radhë jo si i sëmurë, por si nxënës shkolle.

* * *

Më duket se kish hyrë nëntori, kur në shtëpinë tonë erdhi për vizitë doktor Miçua. Ai kishte shoqëri të ngushtë me tim ungj. Doktori, asi kohe, qe drejtor i spitalit civil (rural siç quhej) dhe me tim ungj qenë jo vetëm kolegë, por dhe miq. Pse ishin të tillë, nuk i kursenin dhe vizitat tek njëri-tjetri. Arsyen pse e mbaj mend këtë vizitë për të cilën po shkruaj, është si më poshtë.

Doktori ndënji sa ndënji dhe, para se të çohej për të ikur, nxorri nga çanta një palë këpucë me qafa. Qenë të tilla që, menjëherë, të binin në sy. Nga ato lloj këpucësh që quheshin «alpine». Ai i nxori dhe tha:

- Të kam sjellë këto këpucë që m›i dhuroi një pacient. Mua nuk më bëjnë se e kam këmbën pak më të madhe se tënden. Pa provoj njëherë a të bëjnë.

Xhaxhai futi njërën këmbë dhe doktori, kur pa që qenë si të porositura, i tha: - T'i gëzosh!

Lushnja, mbaj mend që, veç shkollës sonë, kishte dhe një shkollë tjetër unike: ajo quhej "Skënder Libohova". Kaq. Ca dyqane. Një a dy restorane, një hotel, një kinema dhe, veç tyre, edhe një fushësporti. Tek fusha e sportit mend jepnim xhanin. Atje na gjeje se dy djemtë e të zotit të shtëpisë, sa nuk ia thoshin për mësime, aq u qante syri për futbollin. Natyrisht, unë u bëra si një trup me ta dhe nga një nxënës shumë i mirë në fshat, këtu, në Lusnnjë u bëra "futbolllist". Kur erdhi fundi i vitit shkollor, dola me këpucë të kuqe. Hiq lëndën e gjuhës e letërsisë që kisha një katër e në tjetrën pesë, gjithë notat e tjera, për turpin tim, qenë tresha. Im atë, ndjesë pastë, kur pa këto "arritje" të miat, më tha: - Nuk e ke fis qytetin ti. Vitin tjetër, u përcolla me Lushnjen dhe e vazhdova në Fier (bëja çdo ditë 10 km rrugë vajtje-ardhje) dhe e mbarova shkollën unike (7-vjeçaren) me nota aq të larta, sa nuk dhashë provimet e lirimit, por m'u njohën notat që kisha marrë gjatë vitit, në klasën e shtatë. Këtë favor nuk ma bën se qeshë vetëm unë me nota të larta. Jo. Qëllova që u sëmura tërë muajin maj dhe rregullorja e shkollës e kish paraparë që, për nxënës cilësorë, t'u njihej kjo e drejtë. Kur shkruaj këto gjëra për veten time, nuk kam për qëllim që ta lakoj veten, por, ja që, çuditërisht, në këto ngjarje vjen e më ravijzohet portreti i Doktor Dhimitër Konomit.

* * *

Verës së vitit 1952, befas, goditem nga një sëmundje infektive. Kisha temeperaturë të lartë dhe në fshat, asi kohe, nuk kishte doktor jo që jo, por as infermier. Jepnin e merrnin ime ëmë dhe gjyshja ime e mirë, me mjete rrethanore, kur thuhet në ushtri, por temperatura nuk zbriste. Komshia jonë, bosnjaku Rrahman Maka e mbajti frymën në Libofshë (nja 7 km larg fshatit tonë) dhe solli që andej të vetmin mjek të asikohe. Qe Vojo Bilvia që më bëri dy gjëlpëra një pas një dhe porositi që të më nisnin urgjent për në spital, në Fier. Sado që Fieri qe qyteti ku «përplasnim» kokën për çdo gjë, xhaxhai im, Avniu, mbreu qerren dhe atje hipa unë me gjithë nënën time. Dolëm në xhade (tri km larg xhadja nga

ndante veç murin ndarës. Para pallatit qe një furrëpjekës që quhej furri i Kikut. Kiku qe usta me halle, qysh nga koha e mbretit, mjeshtër dhe, pse qe i tillë, shpesh piqte bukëmisri kur u tekej atyre të bllokut, për të «englendisur» stomakun. Jo më kot nuk e kujtoj Usta Kikun. Fëmijët e çiftit Sulçe, pothuaj, kohën e lirë e kalonin pranë këtij plaku të urtë e bujar. I thonë njëherë Kikut: -Dajë Kiku ka dalë një thjatro për Qazim Mulletin a ta presim një biletë me ardh me e pa.

-Po vij, - pranoi Kiku. Dhe shkoi në «thjatro». Qe ajo pjesa «Prefekti» e shkruar nga Besim Levonja. Kur dolën nga shfaqja, ndërsa fëmijët nuk e mbanin të qeshurit, ustai turfulloi: -Po jo, mër dajë, s›ka qenë Xima (Qazim Mulleti) dhe as Moni (Man Kukaleshi) ashtuna. Daja i ka njof ndryshe, fare ndryshe. Ene atë Besin (Besim Levonjën) e kam njof. Kokrrën e krypës s›ka pasë me hongër e vallaj, sa di veta, e ka ndihmu nji ky Xima; nji ky Moni... e taby starfulla... e bukë e djegme aj Besi, -kish folur tërë mllef, usta Kiku, duke harruar se ai që e dëgjonte qe veç një adoleshent, si Edi, djali i tretë i çiftit Sulçe. Por sado në bllok e pranë bllokut, këta djem të çiftit Sulçe, sikur kishin dreqin në bark: kishin alergji për bllokun dhe mbinin pranë furrit të Kikut. Sikur dhe kokën t›u prisje, një fjalë nuk nxirrnin nga ato që nxirrte ustai aq i mirë dhe i dashur.

* * *

Kur djali i madh, Agimi, u martua dhe tre të tjerët po i kalonin të njëzetat (kaq qe më i vogli), çiftit Sulçe iu dha zgjerim dhe u vendosën tek pastiçeri "Flora". Sidoqoftë, në banesën e vjetër, mbeti djali i tyre, Agimi, që qe bërë me dy fëmijë: me çupë e djalë. Ismeti dhe Kokoja, tani kishin dalë në pension dhe kjo i shtynte që të bënin këtë rrugë gati 45 minuta të mira, pothuaj çdo ditë.

Qenë të kënaqur se fëmijët i rritën me nder dhe, deri sa fëmijët dolën në punë, nuk ua kishin nxirë faqen. Punonin secili në frontin e tij dhe, kur vinte mbrëmja, mblidheshin në shtëpi.

Si pensionistë që qenë, tek mblidheshin aty në shtëpinë e tyre, zinin ndonjëherë dhe humbisnin kujtimeve.

Kështu ndodhi dhe këtë herë. Ismeti kish hapur albumin e fotografive dhe sytë i kish hedhur tek ajo fotografia bardhë e zi, të mesviteve ‹pesëdhjetë, kur sapo qenë fejuar. E hoqi nga albumi dhe i thirri së shoqes:

-Koko, -a vjen pak?

Ajo, pasi fshiu duarët (qe duke larë enët) u afrua.

-Pa shikoje, - i tha. Shikoje se si ke qenë dhe se si je? Atëherë e drejtë, fine me gërsheta, kurse sot je trashur dhe je bërë që, po të çashë dërrasa, e shtron një konak.

Shpotisë, tek vështronte fotografinë, iu përgjejg: -Ehu, ikën ato kohë, në jam trashur dhe jam bërë ashtu se më janë hapur shpatullat me të bërë byrekë (mbi njëzet e ca vjet punoi në byrektoren speciale) dhe nuk kam ndënjur këmbë përmbi këmbë, u mbrojt ajo.

Ndërsa shfletonin të tjera fotografi, kur , befas, trokiti xhami. Të dy i lanë fotografitë se si mund të trokasë xhami në katin e tretë veç nga ndonjë gur. Shkuan në një kohë tek dritarja dhe u befasuan: trokiste një kumuri.

Ou, -bëri Ismeti kur e pa më mirë. E paska një këmbë të plagosur. Pa shko merr pak oriz që t›i hedhim. Kokoja shkoi mori një dorë dhe Ismeti, hapi dritaren, pak lehtë që mos e trëmbte dhe ia hodhi. Kumuria u afrua, shikoj njëherë përqark dhe filloi çukitjen. Çifti ndiqte tek hante dhe Ismeti, kur pa se u afrua dhe dy të tjera, nuk i la. -Lëri, - i tha e shoqja. -Jo. Jo. Kjo është e plagosur. Ato të tjerat le të shkojnë gjetkë. Pasi hëngri, ai provoi t›i hidhte prapë, po kumuria nuk pranoi më. -Qenka ngopur, tha. Dhe, sakaq, në një filxhan hodhi ujë, por kumuria jo vetëm nuk piu, por fluturoi, duke zgjatur ca më shumë këmbën e plagosur.

-Ishalllah vjen dhe nesër, -tha Ismeti, se kurrë kemi kaq vjet s›na ka ndodhur që një zog të trokas në xham. Duke u marrë me këtë ndjesi të re, ata e harruan albumin.

KËPUCËT ME QAFA*

Në kujtim të Dr. Dhimitër Konomit

Shtatori i vitit 1952 mua më gjeti në Lushnje. Lushnja atovite qe si një qytezë, me pak shtëpi dhe s'është se kishte një shtrirje të tillë gjeografike që të të jepte përshtypjen e ndonjë qyteti. Pak ndërtesa kishte ku të binte në sy ajo e komitetit ekzekutiv që qe dykatëshe dhe, veç kësaj, s'është se kishte një bum ndërtesash të tilla që të të mbetetnin në mëndje.

Shumë-shumë, me sa më kujtohet, mund të ishin nja dhjetë të tilla ku përfshihej dhe shkolla "Model" (shkollë unike quhej asi kohe) ku unë qeshë regjistruar si nxënës i klasës së pestë. Kisha ardhur nga një fshat i Fierit, Petova, dhe, me që në fshat nuk kishte shkollë unike, unë u mbarta në Lushnje tek xhaxhai im, Avdulla Hysi. Tek xhaxhai banonim në një ndërtesë dykatëshe, mbushur me qeraxhinj dhe që qe si pronë e Hysen Toshkëzit dhe djemëve. Banonim në një dhomë të katit të dytë dhe, asikohe, xhaxhai im qe si shefi i shëndetësisë së rrethit.

Shtëpia ku banonim me qera ishte në lagjen "Xhevdet Neparvishta". Këtu, në këtë shtëpi, bashkë me qeraxhinjtë rronte dhe familja e të ndjerit. Djali i madh i tij qe shofer dhe kish dy djem. Ata qenë moshatarë me mua dhe unë nuk e ndjeja, pothuaj, fare mungesën e shokëve të fshatit. Me ta shkoja në shkollë (rreth gyjsëm ore larg nga shtëpia jonë) dhe me ta kaloja tërë kohën e mbasditës. Për t'u bindur ju, si lexues, se sa e madhe qe

Femrat

Gjithmonë e vras mëndjen: -Përse na joshin?
Ç'djall kanë me vete që na tundojnë?
Ah, sa të mira!Ato»mos qofshin?!»
Kur dhe ca me thinja, pas tyre vrapojnë.

Dhe e dinë mirëfilli nga ne pëlqehen
Nisen e stisen sikur shkojnë për sfilatë
Kush s›humb pusullën; disa dhe «dehen»
Nga sharmi i tyre, tundohet dhe një plak.

24 dhjetor 2004

** tregimin e kam shkruar në vitin 2007 dhe e kam ripunuar.*

20 janar 2011

* * *

Të nesërmen kumuria erdhi prapë. Ismeti, si të priste një mysafir të dashur, shpejtoi tek bufeja, e mbushi një pjatë me oriz dhe ia zgjati. Kish frikë se mos i trëmbej, po kur pa që kumuria iu përvesh pjatës, i erdhi aq mirë sa i thirri së shoqes: - Hajde shikoje. Dhe mos të shoh më që t'ia hedhësh mbi parmak të dritares, po me pjatë: si zonjave. Dhe në filxhan ujë. Po ajo nuk e piu, -tha e shoqja. -Nuk e piu herën e parë, po do mësohet.

Dhe kështu ndodhi. Ata u bënë miq me kumurinë. Vinte, hante e pinte dhe, pastaj, fluturonte në punë të saj.

Kjo miqësi mes çiftit Sulçe dhe kumurisë vazhdoi muaj e muaj të tërë.

* * *

Aty, nga muaji gusht i vitit 2005, Ismet Sulçe u sëmur nga një sëmundje e pashërueshme. E kishin nxjerrë nga spitali dhe veç të shoqes, Kokos, pincë sa tek koka aq tek këmba i rrinte një nga djemtë, Bujari, ardhur enkas nga emigracioni. Në emigracion kishte dhe dy djemtë e tjerë, Edin dhe Ilirin, që dhe ata vini herë pas here, kurse djali i madh, Agimi, sa linte punën së bashku me nusen Verën qenë pranë. Sëmundja, në ditët e fundit të gushtit, përparoi mjaft. Sidoqoftë, kujdesi për «mysafirin» (kumurinë) nuk mungonte. Dikush tjetër do kujdesej për të.

31 gusht 2005. Kumuria u rrëfye tek dritarja. Njëri nga djemtë i serviri ushqimin. Ajo as që e preku. Veç shikonte nga përtej xhamit dhe ulte e ngrinte kokën duke gulçuar. I afruan dhe filxhanin me ujë. Po as ujin nuk e preku. Lëshonte një timbër si e një të sëmuri që lëngon. Dhe nuk ikte. Por ç›të ketë kumuria? E hapën fjalën dhe dikush që njihte më shumë nga bota e shpezëve, tregoi se këto shpezë kanë ndjeshmëri; janë si shpezë vaji dhe instinktivisht kumuria shfaq dhimbje për mikun e saj që po lëngon.

Të nesërmen, më 1 shtator 2005, njeriu i mirë, Ismet Sulçe, ndërroi jetë. Kumuria u rrëfye përsëri në dritare dhe nuk pranoi as të hante dhe as të pinte. Ajo jepte e merrte duke ulur e ngritur

kokën, lëshonte mërmërima si ai njeriu kur heq me supe dhe mbeti me ato «konvulsione» deri sa doli arkivoli jashtë. Ndërsa të afërmit u nisën për në funeral, befas panë që mbi kokë fluturoi një kumuri. Siç duket, mysafirja nuk qe bukëshkalë. Përshëndeste, për së fundi, mikun e saj. Erdhi tek dritarja edhe dy ditë me radhë pas vdekjes së Ismetit dhe më nuk u pa.

Kushedi mund të ketë ngordhur, -tha Kokoja.

* * *

Më 1 shtator 2006, Kokoja së bashku me djemtë e më të afërm qenë mbledhur për të bërë përvjetorin e parë të të ndjerit. Aty nga ora 10 e paradites, trokiti përsëri dritarja.

Ou, -bëri Kokoja! Qenka gjallë. O burra dhe ia bëri gati orizin me gjithë ujë. Po Kumuria as që i preku. Përsëri sikur hiqte me supe dhe vetëm gulçonte. Aty qëndroi deri sa dolën për të shkuar në varreza, fluturoi mbi ta sikur t›u çonte mesazhin e saj të mirënjohjes për mikun e saj dhe më nuk erdhi. Të gjithë u befasuan nga kjo sjellje e saj, dhe, ca të moshuara. zunë e po bënin kryqin si për një ogur të mirë. Guleçet dhe mërmërimat e padëshiruar të kumurisë qenë "lotët"e saj të mirënjohjes.

Tiranë, 1 nëntor 2012

dhe të hyra dorë në sytë të gjithëve. Por Puçja nuk hante pyka. Pepe, - foli mbasi u largua paksa nga xhaxhai, - huqin kalit ia di ai që i hipën sipër!!! E, që thoni ju. dëgjoni tani këtë historinë me time shoqe. Erdhi një akshëm nga puna. -Hë, erdhe, - i thashë. -Erdha. Dëgjo, shko më bëj një kafe. -Ç›kafe? Unë do iki se do thyjemë kapule misri. Se ja filloi mjegulla dhe thahet kollaj. - Ku do shkoni?Tek shega e Muratit. -Jo, nuk do shkosh, se është natë. Natë pa natë unë do shkoj. Jo, - thira unë, - nuk do shkosh, se jo vetëm që është natë, por brigadieri është pusht dhe ndaj dhe të ka thirrur. -Mua më merr të keqen. Të bëj ku të gjej ai. Shkurt, o vëllezër, iku. Iku ajo, po dhe unë nuk e hëngra thatë. Një të marrë një thes dhe nga një rrugë tjetër, drejt e tek shega e Muratit. U afrova tinëz dhe, sa gruaja hodhi kapulen e misrit, mbi prehër, tak i hidhem si një shqarth, e vë poshtë; thesin e kisha hedhur që mos të më njihte. Jua them unë: gruaja e ndershme nuk bën berihaj. Nuk u ndje dhe unë, sa mbarova «punë», u ktheva në shtëpi. Prisja që të tktheje dhe ajo. Ashtu pas nja dy orësh erdhi, E, i thashë erdhe. Erdha. Të thashë unë që do të zërë brigadieri. Ke fjalë tjetër ti apo. Zuraa dhe ia tregoja të gjithë ç›ndodhi tek shega e Muratit, por ajo nuk jepej. Tregoja ndonjë tjetri, më thosh, po mua më mer të keqen njeri. Hë, pepe, e digjove? Dhe, për t›i shpëtuar të keqes, iku duke qeshur. Ne tani njëzëri»kurorën» ia dhamë Puçes që tek u largua, bërititi: Nuk i besoj gruas unë, jo... .

Epilog

Unë vetëm tregova për ca ditëzbori, por për femrat unë kam respekt. Mëkati nuk pyet për gjini. Dhe sa për femrat, ja mendimi im:

nusen dhe e çojnë të pres dru në pyll. Presin plakat buzë pylli me mushkat për t›i ngarkuar. Sa më shpejt t›i pres drutë, aq më e mirë është. E, kështu, Hasani, kish martuar djalin. Nusja-yll e shkuar yllit. E marrin plakat e në pyll. Ia fillon nga puna ajo. Kur ç›të sheh? Dikë që afrohet. Lë punën dhe njeh vjerrin. Po ky ç›kërkon këtu? Vjen ai dhe ndezur nga bukuria e së resë (se qe pushte kaluar pushtit), i shtie çikë asaj. Medemek, këtu në pyll vetëm unë e ti dhe asnjeri dhe zgjat dorën, po ajo një ia jep me mykë të sëpatës dhe e rrëzon përmbys. Por sa e bukur dhe aq e ndershme. Bërtet: -Oj, hankoni, hajdeni se Hasan-aganë e ka vrarë mushka!!! Vrapuan ato dhe, si e gjetën ashtu përmbys, e hodhën mbi mushkë e frymën në shtëpi. Lajmi mori dhenë: -Hasan-aganë e vrau mushka!! !Dhe ai, ashtu behot, i kish dëgjuar fjalët e së resë. Kushdo që vinte për ta parë dhe e pyestte se ç›të ka gjetur, i përgijgej. -Më vrau mushka! Dhoma rrinte plot dhe ja tek i erdhi radha dhe se resë. U fut ajo, terbie si ishte, dhe i thotë: -Aga, ç'të gjeti kështu? Ai, si i përhumbur, i tha: -Më vrau mushka. Ajo: -Po kur nuk i dije zananë, pse iu qase pranë?!!!

Ky labi, gjysmë burri, sikur u vuri kapakun të të tërave. Aq na bëri për vete, sa të tërë thoshim: -Po kur s›i dije zananë, pse iu qase pranë?!!!

Por nuk qe e thënë me kaq. E mori fjalën Puçja. Ky qe një burrë faqekuq, që, në vënd të pushkës, qe lejuar të mbante një stap të gjatë se, gjasme, qe rrëxuar e qe vrarë. Thoshhin që dhe në kooperativë me hile punonte, po kishte një grua të zonjën që mbante shtëpinë gjallë. se, këtë, Puçen e kish vetëm për gaztor. Epo ky, gaztori, Puçja na la pa mënd.

* * *

Po ç›ma ngisni muihabetin me gratë ju, - foli Puçja. Po unë , or babaxhanër, nuk i zë besë gruas. Ti ke gojë të zëshë tëtshoqe me gojë, more gojëshpuar, - iu lëshua kërcënueshëm një i moshuar që ishte vet xhxaxhai i tij. Po për tëtshoqe betohet një fshat i tërë dhe ti gojac e jargash, e zë në gojë!U sikter, se ta mora atë stapin

SI PO IA ÇON, MOJ DASHURI E PARË?!!!

Sado që kemi vjete e vjete që jemi ndarë, vjen një moment që zë e të kujtoj. Kjo ndodh jo se do zhbëjmë atë që ndodhi, por nuk ke se si u shpëton ca asosacioneve që, ashtu kur nuk i pret, vijnë dhe vënë domenin. I mundur nga këto, ua lëshon kapistallin kujtimeve dhe, si në një film me metrazh të gjatë, bie peng aq sa zë e mbresohesh. Befas, e shkuara, sado e shkurtër, të vjen para sysh dhe të bëhet sikur po e përjeton tani atë që ka mbi pesëdhjetë vjet që ka ndodhur. Mbresa, sado e largët, bëhet e prekshme dhe të sëmbon. Të sëmbon sikur heq korën e një plage dhe, sa e heq këtë korë sado metaforike, ndjen dhimbje. Një dhimbje paksa të ëmbël, por edhe të dhimbshme.

* * *

Ne u deshëm. Kjo dashuri lindi ashtu tak-fap, sapo u pamë sëpari. Atëherë ti ishe si një lule e brishtë, me ca sy të zinj që unë gjetkë nuk i kisha parë. Sa u takuam, lëshove një buzëqeshje dhe mua m›u duk se ti dije të qeshje më bukur se kushdo në botë. Pra, nga një lule e brishtë, ti u zhdrrove në një engjëll apo si një diell që shndrisje vetëm për mua. Natyrisht, unë hesapet i bëja pa pyetur hanxhinë. Po, më thuaj, moj e dashur, cili nga ata që dashuron është racional? Që atë çast, unë të desha dhe aq i vendosur qeshë, sa thosha: - Po duket që atje tej që edhe ajo më do. Qeshë apo nuk qeshë afër të vërtetës, këtë do ta tregonte koha, por unë ama

e kisha të mbushur mendjen top: ti nuk kishe se si të më thoshe: jo. Se nuk kishe arsye, - mendoja unë. Se... epo ku kish më të bukur se unë?!!!! Dhe, tek të shkruaj sot që jam mendjekthjellët, s›kam se si mos vë buzën në gaz me atë «bukurosh të pashokë». Për ta bërë më të plotë «portretin tim të bukur», nuk lashë vazo me brilantinë në dyqan, për të shtruar flokët e mi si gjëmbairiqi të asaj kohe, të kësaj koke, sot me thinja, që nuk duronte krëhër. Nga natyra, tërë jetës kam qenë rebel dhe dukej dhe flokët qenë si tel. Nuk kishte krëhër që t›i shtronte. Brilantina kish bërë punën e saj dhe, tek shiheshim, ti më hidhje sytë dhe ia jepje të qeshurit. Zor se vije vetëm në ato pak raste. Pranë teje, një shoqe pak më e madhe se ti në moshë. Kjo kish dhe përvojë në këtë fushë ku ne sapo shkelnim. Ajo qe e fejuar dhe qe si «tutore» për ty. Ti qe dy klasë më poshtë se sa unë, por vendi ku takoheshim, qe konvikti. Qemë të dy konviktorë dhe, po t›i zije besë «horoskopit» tim (aso kohe as që njihej fjala horoskop!), unë «lexoja» kështu: jemi nga një rreth dhe kjo është një arsye që ti të më doje. Aq i bindur qeshë në këtë arsyetim, sa nuk kish burrënëne, të ma rrëxonte bindjen time. Konviktorë: po ne qemë si vëllezër e motra. Po të mendoje kështu, atëherë si mund që të më doje? Po unë e ngarkoja mushkën më shumë këtej nga ana ime dhe thosha: - Pse mos jam ai Halili i «Visareve të Kombit» që thoshte: - Tanë çikat e Jutbinës ku janë/ bash si motra po më duken. Jo, mor xhan, - i bëja vetes qejfin, - ç›motër e kam. E dua dhe pikë. E dua dhe pikë ishte pak. Por betohesha: - Dhe ajo më do.

* * *

Askujt nuk i kisha thënë që të doja. E bukura është se as ty nuk të kisha thënë gjë. Pra, qe si një «film pa zë». Qe, sipas meje, një fshat që dukej dhe fshati që duket, nuk ka nevojë për kallauz. Mos kujto se flija rehat, sado që ty nuk të kisha thënë. Prisja momentin. Se, pa ardhur koha, as edhe një gjë nuk realizohet. Për t›u bërë më prezent, dalë e ngadalë po ndryshoja «luk». Nga dollapi i rrobave nxora kostumin dhe i nxora ujtë e zi, sado që i shkreti babai im,

shoqen, vjen, vjedhurazi në shtëpi. Hap derën me çels se nuk do të zgjoj të shoqen. E hap, kur ndjen që dikush kërceu nga dritarja. -Ou, - u alarmua, ai. Ç'qe ai që iku?- i bërtiti të shoqes. Ajo gër-fër, medemek në gjumë (pse kot thonë që gruaja futi shejtanin në shishe?!) . -Moj të pyeta kush qe?- i mshoi zërit ai. Ajo, sikur sapo u zgjua, dhe... -O të keqen, o Solli, oh, sa e ka marrë malli Sijen tënde për ty dhe zgjatet nga i shoqi i jep duarët dhe e tërheq mbi vete. U ndez ditëziu Solli dhe harroi atë hamshorin e ikur. Ne ramë përmbys nga të qeshurit, se ky dreq ingjinieri tregonte si të qe atje dhe kur vinte në rolin e Sijes e shkërbent zërin si ajo dhe, për vete, as qeshte as qante: veç tregonte dhe aq. Ngjarja sa na gajasi, aq dhe na shpoi, se të gjithë, i kishim lënë ato Sijet tona në shtëi për 17 ditë e net. Kaq qe. E nisi igjinieri dhe na ndodhi se atje me «Dekameronin»: secili do të tregonte diçka. E mori fjalën Leci. Ky qe i vetmi shkodran (me punë e banim në Fier, që zborin e bënte tek ne). A e dini ça ka ndodh në Shkodër?I ka pas thanë njana nji shoqes së vetë: -Moj Mari, ça m'ka gjetë?-Ça t'ka gjetë , o e lumja unë?-Po ma lyp drejtori!!-Mirë boll, moj rrezike, . nepja drejtorit se ka me t›mbajt si ujtë e bekuem. E të nesrmen: -Moj Mari ça m›ka gjetë?-Ma ka lyp shefi?-Po nepja, moj shefit, se ke lehtsina. -E prapë: -Moj Mari ça m›ka gjetë?-Po ma lyp brigadieri. Mirë boll, moj, nepja se ai t›i jep metelikët e veç qarë ke prej tijna. E së fundi: -Moj Mari ça m›ka gjetë?-Po ma lyp edhe buuuurri?-Buuurri?A je e marrë apo shtihesh. Kur don dhe burri me ba qejf... Tani ena jonë nuk mbajti më. U thye dhe u bë copa... se nuk kish ku të vinte më. Dhe buuuurri dhe e zgjtanim këtë sikur, secili, vinte në»hellin» e gjykimit, të shoqen e vete. E, Lec, Lec, ç'na kënaqe!

* * *

E, ore, e- emori fjalën një lab. Këto që treguat ju, nuk janë gra, po lapërdhare, se ka gra që të marrin gjak në vetull dhe ta vënë kufinë tek thana. Dhe ia filloi. -Nga anët tona është një zakon. Nusen e re, plakat e lagjes(me të cilat ka dhe lidhje), e marrin

raki dhe bërë çakërr qejf, ia thërrisnim këngës.

***

Ia mori Yzedin Veliu një këngë, nga ato që të prekte shpirtin, se, tani që kishim gati nja 5 ditë pa vajtur në shtëpi, pse ta bëjmë harram: mëndja na shkonte dhe tek gratë, se, domosdo, evliha, nuk qemë. Pra, këngën e zuri Yzedin Veliu dhe, sakaq, ia ktheu Feçorr Tafa, Por kthesa e këngës qe paksa e»rrezikshme», e lehtë për t›u përciell me shumë zëra dhe, dasheje pa dashje, ia kthyemë të gjithë. Kënga qe jo vetëm e bukur, por dhe shumë shpotitëse. Bukuria qëndronte në të, se kthyesi, Feçorri, zuri të bënte ojna dhe shënja që na ngriti avadan aq, sa me këtë entusiazëm që na kish përfshirë në këto çaste, me të vërtetë; -Mjerë armiqtë!Ne, në ato çaste, të merrnim gjak në vetull. Tek shkruaj, nuk mund të lë pa ju njohur me vargjet e bukura të asaj kënge popullore:

-Buzën seç ta dhashë, por më tej ç›kërkoje?- thoshte thënësi. Kurse kthyesi që qe dhe komik, kthente: -Ç›pate, derri i derit? Ç'pate? Çfarë kërkoje? Këtu dhe futeshim që të gjithë dhe pylli ulërinte nga zërat tanë aq gazmorë. E bukura ishte, veç tjerash, se kënga dukej se zbriste shkallë-shkallë që nga buza, tek gusha dhe deri atje ku»falej kandili». E se si bubullonim ne, or tunajtjeta! Armik, gjej vënd e futu. Dhe vetëm më vjen keq që nuk kshim atëherë një kasetë për ta regjitruar a filmuar se do shqyheshim së qeshuri. Por ç›them dhe unë?Kaseta apo filmimi ishin si vjetdrite larg...

* * *

Kur kënga mbaroi, e kthyemë dhe njëherë nga ato faqoret tona dhe, pasi uruam: si goja zëmra hëm thënësin dhe atë që ia mbante, pritëm ndonjë këngë tjetër. Por ja që dikush vërviti një «proçkë». se proçkë qe, se ç'të ishte tjetër.

- E dini se çfarë ndodhi në Ballsh?- tha një igjinier që punonte në uzinë. Ne po sy e vesh nga ai. Kish shkuar një lumëmadh si kjo puna jonë, në zbor 17-ditor. Ditë e net po drejt e në Fratar, se atje qe pika ku mblidhehin. Qe pak si riosh dhe zënë malli për të

<antocë_footer_1">116 Përparim Hysi / "Lotët" e kumurisë</antocë_footer_1">

më kish porositur: - Vishe rrallë e në ditë festash, se këtë ke: lajthaj. Mirë e kishte babai im, po nuk e dinte se tani të gjitha ditët për mua qenë festë. U bëra si ato adoleshentet që nuk i ndahen pasqyrës. Një orë me të shtruar flokët-gjëmb. Zura i mallkoja: si guxonin që rebeloheshin ashtu dhe më prishnin bukurinë? Dhe, pasi sigurohesha se gjithë bashkëshokët i kisha vënë poshtë me lukun tim, turresha tutje korridoreve që të më shihje ti. Mundimi nuk më shkonte kot. Më shihje, lëshoje atë buzëqeshjen (mua kaq më duhej) dhe më tej asgjë. Fare asgjë. Fare asgjë, po përse qeshje?- pyesja unë. Dhe po vet përgjigjesha: - Qesh, se më do. Të qe kështu? Kur një të shtunë në mbrëmje, ia bëra ferk. Qe një mbrëmje vallëzimi. Isha një nga organizatorët. Si t›ia bëja që të kërceja me ty? Se kish shumë çuna dhe pak goca. Me të qeshur (unë shquhesha për shaka dhe këtë e merrja si plus mbi të tjerët) thashë: dyzet kolonjarë, me gjysmare farë. E thashë me zë të lartë (pra, qeshë dhe më i bukuri, por dhe më i zgjuari, de) dhe, kur pashë që të gjithë ia dhanë të qeshurit, unë sytë mbi ty: qeshje për mua. E për kë tjetër?! E rregullova dhe për kërcimin. Vendosëm rregull: me kuadrile. E ndreqa punën që, ndërsa unë bëja si kavalier, Strahilin, ajo, pra që më donte, partneren e Strahilit, Sherinën. Qenë personazhe të një filmi baladë bullgar, ku Strahili bëhet copë për Sherinën. Me demek, të çoja mesazh: kështu bëhen dhe unë copë për ty. Naivitet, domosdo. Po vallë a hahet rrushi i papjekur? Më së fundi, ja kërcyem. Unë të shtrëngoja dorën dhe, tek ti nuk hiqej tënden, e merrja si pranim të asaj që ndjeja. Që «ndjenim», më sakt. Kaq. Sado që kërcyem dhe dy herë të tjera.

* * *

Të dielën me atë «tutoren» që nuk të ndahej, ti erdhe tek klasa ime kur po bënim studim. Klasa plot, por me «tutoren» si gardiane, s›kishe pse të emocionoheshe. Unë (hapu dhe të futem brenda) lëviza tek banka sikur po më hanin pleshtat. Hytë të dyja dhe «tutorja» u drejtua tek unë: - Për ty kemi ardhur (epo kot thosha që më do?!!!), se kjo, Bisharetja, ka një analizë fjalie që

<antocë_footer_2">Përparim Hysi / "Lotët" e kumurisë 13</antocë_footer_2">

nuk e bën dot. Po ç›e kisha unë një analizë? Aq më tepër kur qe puna për Bishareten! Ndërsa unë po i hidhja një sy fjalisë, Bishareti hodhi sytë: jo mbi mua, jo. Tek tabela e nderit. E pa dhe lëshoi atë buzëqeshjen. E kishte për mua. Po si nuk e kishte për mua, kur nga tri emra, një qe emri im. Sado që u kalmenda se plus «bukurisë» që nuk më mungonte, po isha i dalluar. Pak inat më erdhi që mbi emrin tim, domethënë i pari, qe Mit›hati. E mora inat Mit›hatin se në atë moment duhet të isha unë i pari. Sidoqoftë, po a nuk isha më i «bukuri?!», po dhe Strahili, ai komiti i tmerrshëm, që përmbyste dynjanë për Sherinën. Lëre-lëre, seç mendoja dhe se si i prisja drutë për hesapin tim. Për hesapin tonë. Dhe, pak nga pak, një çap sot dhe një nesër, unë ia bëra: bamp! U skuqe dhe po dridheshe si një zog i trembur. Unë aty përballë me ato flokët ngarkuar me brilantinë që dhe sot, kur i mendoj, ma shpallin. Më the: po! Po dhe aq u ngazëlleva, sa qeshë gati të të merrja në krah e të fluturonim në qiell. M›u duk se atë ditë u bë kataklizëm. Bota u përmbys dhe, në gjithë botën mbarë, ekzistonim vetëm unë e ti. Unë e ti dhe asnjë tjetër. Po ç›duheshin të tjerët, vallë? Kur ndodhi «kataklizma», unë sapo mora maturën. Ti kishe dhe dy vjet akoma. Po ç›ishin dy vjet?

A nuk thonë që e mira pret. Pakti u bë. Gojëkyçur. Film pazë. Askush mos e marr vesh.

* * *

Unë po zura qiellin e shtatë. Kaloi një vit dhe ne, sipas paktit, shiheshim në distancë dhe vetëm shkëmbenim letra. Mbi zarf unë vija një emër të një kushërirës tënde dhe ti , gjasme, letrat m›i dërgonte dikush nga shkolla. Po vallë ç›gjë në botë mbeti pa u marr vesh. Kur ti ishe në maturë, unë bëra si bëra, dhe u duka andej nga shkolla. Tani qeshë bërë»tjetër»: veç kostumit, kisha vënë dhe kollare. E kuqe flakë kollarja si domethënie për dashurinë tonë. Enkas për ty erdha, por takimi qe si «tangent». Na dukej sikur gjithë sytë e botës shikonin nga ne. Epo «faji» jo vetëm është i dukshëm, por dhe i lexueshëm. Sado «tangent», por

pulën. Dhe ia dha të qeshurit. U ndava nga shpotia e atij plaku të mirë dhe frymën mu në batalion: nja 6 km larg nga shtëpia tek kisha e Vajkanit. Kjo, kisha e Vajkanit (emrii kish mbetur se e kishin kthyer në repart ushtarak pas 6 shkurtit 1967), për të patur një përfytyrim, sado pak të përafërt, ndodhet nja 3 km larg nga Manastiri i Ardenicës, po erdhe nga Fieri për në Lushnje. Manastiri i Ardenicës dihet që është në kodrën më dominuese mbi fshatin Kolonjë të Lushnjes. Ka qenë pas viteve ‹70-të, qemë prishur dhe me Kinën, dhe ndaj qemë mobilzuar për 17 ditë e net, aty , mes pyllit, që të përgatiteshim për t›i shpartalluar armiqtë që, siç ndodhi, qenë krejtësisht imagjinarë dhe pjellë e mëndjes përçude të timonierit dhe atyre që pasonin atë.

Aty, tek ish-kisha, kalonim tërë atë kohë të pastëstërvitjes. Aty flinim (shtretërit me mjete rrethanore, se po stërviteshim për luftë, de!) dhe, pasi hanim mëngjesin. niseshim përmes pyllit (edhe ditës në këtë kurorë lisash e drurësh të tjerë, mezi shihje diell dhe sa nuk më zë të qarët kur nga ky pyll shekullor dhe dhjetra hektarësh, tani që shkruaj nuk ka mbetur qoft dhe një dru për të bërë një copë shkop! Se e prenë dhe e rrafshuan në këtë kohë tranzicioni), dhe bënim vajtje-ardhje gati 10 km çdo ditë dhe me armatimin në krah. Këtë lloj marshimi e bënim për çdo ditë dhe frymën e mbanim mu tek Manastiri, se aty, në një terren të thyer, ishte poligoni ku stërviteshim për asgjësimin e armiqve. Duke ecur përmes pyllit, një tepelenas (kish ardhur bujtës në fshatin tonë), tha: -Më duket se na gjeti si me atë ushtrinë turke në Zhapokikë. -Ç›lidhje ka kjo me atë Zhapokikën. Kërkonin një të arratisur nga burgjet e Turqisë. Ai fshehur në pyjet e Zhapokikës (ja si, ky, pylli i Vajkanit, de), dhe, ndërsa sulltani, priste lajme, atij i drëgonin: -Ik e ik, nëpër Zhapokikë. Natyrisht, kish qëlluar në shënjë, ndaj dhe u gajasëm. Mbasi stëviteshim, (armët të gjitha pa fishekë!!) shponim "kupacat" made in Brezhnjev apo made in Mao, ktheheshim të lodhur dhe, mbledhur të gjithë tek një shesh në pyll, zinim nga muhabetet. Xhëku kthenim dhe ndonjë gllënjkë

MEMUARET E NJË ZBORISTI...*

Tregim i jetuar

Prolog

Kushdo që do të lexojë këtë tregimin tim, dua që mua të mos gjykoj keq. Po tregoj veç atë që përjetova në një nga ato zboret ku"stërvitshim për të shpartalluar jo vetëm një armik, por bllok armiqësh" që, "në na kishin në gyrkën e pushkës, ne i kishim vënë në grykën e topit". Sidoqoftë, unë e kam vënë kryqin mbi kurriz dhe i pranoj pasojat, sido që të jenë. Se e di që, në thelb të tregimit, lakohet femra. Por thashë, unë vetëm tregoj dhe aq...

* * *

Tek po dilja nga shtëpia, veshur ushtarakshe (veshjen e kishim marr një mbasidte më parë), ballë për ballë ndesha xha Myrten, një plak që qe i muhabetit. E dija që nuk do shpëtoja nga bodeci tij. që. ç'është e drejta, qe pakëz i mprehtë dhe të shponte keqas. Qe burrë i zgjuar dhe fliste me dykuptime apo me rrotulla, kur thonë andej, nga veriu. M›u afrua duke qeshur dhe e zbrazi: -Dhaskal, të keqen xha Myrtja, sa të shkoka kjo rrobë»anglizi» për angari. Unë: -Pse angari e quan ti, xha Myrte!Ai e uli dhe ca zërin: -Angari e shkuar angarisë. Por thuaj shyqyr dhe aq. Se nusja e djalit ‹m›i bleu, o të keqen xha Myrtja ti plot 1500 lekë. Se është në»Çetëvullnetare». Vullnetare-gërr pare!-shpotiti. Mirë që s'i ka vajtur mëndja dhe për ju që ta paguani sa frëngu letrat «kullonin» nga dashuria jonë. Oh, kur po vjen ky qershori i vitit 1961!

* * *

Pas kasavetit, - thonë turqit, - ka selamet. Erdhi dhe qershori që ti more maturën dhe unë mezi prisja të të vija në shtëpi. Buisja dhe bëja «buf» si ajo pema e Krishtlindjes nga dritat. Po a nuk thonë me të drejtë: - Mos u gëzo, o i gëzuar! «Buf» bëja nga gëzimi se, më së fundi, pas një pritjeje të gjatë, do të kurorëzonim dashurinë tonë. Dhe ç›ndodhi! Të tutë sa morën vesh që unë isha me «qere» nga biografia, u hodhën në sulm me gjithë «artilerinë e kohës», për të të shpëtuar ty nga një «armik» potencial. Ti, për fat të keq, u dorëzove. Për ta bërë fakt të kryer dhe, për t›ma lënë mua dopio gjashtën në dorë, të martuan, sa hap e mbyll sytë, me një «kuadër të pjekur» të sërës suaj. Pa frikë, ky «kuadër i pjekur», duhet të qe nja 10-12 vjeç më i madh se sa ti, por sa rëndësi kish: qe një kohë që vriste dhe dashuritë. Unë, Strahili, mbeta pa Sherinën. Epo kot nuk thonë: të tjera duamë, të tjera në duan dhe të tjera marrim. Ja, kështu ndodhi. Ndodhi si ndodhi dhe, tek përsiatem me këtë dashurinë e parë, zë u kthehem atyre viteve dhe nuk para të vë faj. Tani, natyrisht, që të dy jem plakur, por unë ama që nuk të kam parë qysh nga 1961, kë nuk kam pyetur për ty. Me që dhe shkruaj, enkas këtë tregim e kam shkruar për ty: - Si ia çon, moj dashuri e parë? Nuk do kishte ngushëllim më të madh për mua, sikur të lexoje ç›kam shkruar dhe të më shkruaje qoftë dhe dy fjalë. Thonë që shpresa vdes e fundit. Dhe unë shpresoj. Pse shpresoj, ja dhe adresa ime: perparimh@gmail. com

Tiranë, 25 korrik 2014

TË LUTEM, FALËM!

Miku im! Më së fundi, ja tek të gjeta! Fizikisht, jo, por edhe kështu le ta quajmë sikur po takohemi pas kaq e kaq vjetësh. Gjithçka që shkruaje për ne, në vija të trasha, qëndronte. Them "në vija të trasha", se janë ca "hollësi" për të cilat ti as ke dëgjuar dhe as kishe për t'i marrë vesh, në se unë do ndalem për t'i thënë gjërat ashtu siç janë. Në fund të fundit, në se flasim me një gjuhë racionale, si "emërues i përbashkët" në gjithë atë odise të dashurisë sonë, qe biografia. Ti me xhaxha të pushkatuar, unë me xhaxha "Hero i popullit". Por nuk qe vetëm kaq: stolit me këmbë i ra njerka. Njerka dominoi me "ndërhyrjet" aq të kërkuara të asaj kohe. Ajo ju njihte mirë si familje dhe bëri të plotë kuadrin e biografisë së familjes suaj. Gjyshin nga nëna e kishe patur kulak dhe, sikur kaq të qe pak, si thelë përmbi bisht ja dhe tri dëshmi të tjera: të tri hallat e tua, burrat i kishin kulakë. Dhe, sado që njerka nuk më donte, kur i verifikuan: nuk e luante topi. Ou!- lëshoi britmën vëllai im i vetëm, në ndodh që ti ikën me të, atëherë për ne ke vdekur. Unë u tmerrova. U tmerrova dhe isha gati të lëshoja kujën. Nga të gjitha, ti më kishe treguar për xhaxhanë. Presioni qe i madh dhe, siç shkruan ti, u dorëzova.

* * *

U martova me një njeri që nuk e njihja, gati nja dhjetë vjeç më të madh se unë dhe as që e dija se si do ta kisha të ardhmen. A më erdhi keq për ty? Të flas ndershmërisht: u ligështova dhe,

hiqesh sikur ishe ëngjëll. Unë veç të hoqa»maskën» dhe aq. Por hallall se çfarë bëra. Më ke dhënë një kënaqësi që s›e kam gjetur kund. Po ti ke burrë, - i thashë. -Kam burrë, e, po pastaj? Je tjetër ti, tjetër...

syri. Nami im kish vajtur tek molla e kuqe. Kur thonë në Labëri: -Delen e trullosur, lëre le të marrë brinjën. Pra, lajmi kish marrë brinjën. Koletivi ku vajta qe goxha i madh. Më shumë femra se sa meshkuj. Epo, ç'punë më prishte kjo, xhanëm?Kisha vajtur të jepja mësim në shkollë të mesme dhe duhet të isha serioz. se dhe nxënësit e nxënësit ishin gati t›i këndonin «teskeretë» nga xhepi. Mirëpo ja që deles së zezë i ngjiten rrodhet. Dhe çfarë të ngituri, se... Prapë, tjetër?-ndërhyra unë. Opo, lëre e mos e nga. Gjykoje vet në kam faj unë. Na tthirrën në mbledhje, në sallën e personelit. Tavolina e gjatë dhe me një mbulesë që varej gjer mbi këmbët tona. Ulur unë dhe, rastësisht, ngjitur një nga koleget. Apo nuk qe si dash. Dash për t›i vënë këmborë. Qerpiku si krah dallandysheje, vetullat të trasha dhe syri i madh si filxhan. E përsosur: me dy gropëza në faqe dhe një në mjekërr. Tri (hamendësoja) sikur janë shumë. Dhe lum ai që mbush kovat në ato gropëza. Drejtori po mbante raportin, kur ndjej që ky, «dashi», tak dhe më hedh kofshën e saj, mu për mbi kofshën time!!!Pikë e zezë. Hapu dhe të futem brënda. Por historia nuk mbaromn këtu. Jo vetëm ma hodhi, po ma lëvizte lart e poshtë tamam si një lavjerës sahati muri. Kishte qenë sojleshë: dash për kope!Unë duket u skuqa sikur më kish zënë të keqtë dhe drejtori duket më pa. Ndaloi dhe më tha: -Adhurim, mos ke ndonjë shqetësim, se të shoh që je skuqur sikur je mbi furrë. -Nuk jam mirë, të lutem të dalë pak jashtë. -Patjetër, - më mbështeti ai. Dola dhe, si e mora veten, kur u ula, e tërhoqa karriken më nga vetaj, për të evituar ndonjë rrezik. Dashi nënqeshte me dykuptim. -Hë, - thashë me vete, -u betova, por ja që më ngjiten mizat. «Dashit» kam për t›ia thyer «brirët». Kur mbaruam mbledhjen, ajo m›u afrua: -Po ti prisje që të hidhesha në qafë. Pale po na hiqesh si... . dhe nuk e mbaroi. Iku duke lënë prapa misterin e një hamendësie. Dhe Aadhurimi e shkeli betimin. I mbushi ato»gropzat» e bukura të»dashit» dhe kur e pyeti, pse e sulmoi atje, në personel, ajo i tha: -Ne i kemi marrë vesh të tëra. Dhe unë mezi prisja. Por ti more rolin e»qetiut» dhe

kur rrija vetëm, ku nuk e shpija mendjen. Imshoq qëlloi burrë i mirë. Bëhej copë që ta ndjeja veten sa e sa më mirë. Ai kurrë nuk e mori vesh se në kisha apo nuk kisha patur ndonjë të dashur. Si burrë i pjekur që qe, nuk ngutej dhe as kërkonte, kur i thonë, qimen në përpeq. Sa u martuam, në vitin 1961, u transferua në një rreth tjetër dhe, me që qeshë jetime, rrallë apo shumë rrallë u ktheva pranë familjes. Ky kthim u kthye në "nul", kur më vdiq dhe vëllai i vetëm. Kështu që mundësirat për t'u riparë bashkë u zvogëluan aq, sa nuk është për t'u çuditur: asnjëherë nuk jemi parë më. Ka kaluar mbi gjysmë shekulli dhe që të dy jemi bërë gjyshër. Sidoqoftë, për t'i hequr petët lakrorit dhe për të treguar ca të vërteta që nuk duhet t'i marrësh me vete atje, në "botën tjetër", unë kur lexova se kishe shkruar një tregim me titullin "Si po ia çon, o dashuri e parë?", e gjeta tregimin dhe, sado që pena ime ka zënë ndryshk nga koha e gjatë, po të rrëfehem:

Nuk jam nga ato që futem në "Website" dhe, pothuaj, as që lexoj gazeta. Në ndodhi që u futa enkas për tregimin tënd, duhet të falënderosh Bardhoshen, atë gruan e mikut tënd aty në Tiranë. Ti këtyre u kishe dhënë librat që paske shkruar në vite. Jo vetëm kaq, por duke e ditur që Bardhoshja kish punuar mësuese në të njëjtin rreth me mua, i kishe dhënë porosi të veçantë që t'më takonte (mbasi kishe pyetur mbarë e prapë për të gjitha në lidhje me mua). Po. Ç'të ka treguar Bardhoshja, ashtu është dhe nuk kam gjë për të shtuar se sa rëndësi ka, në fund të fundit. Unë nuk po të shkruaj për këtë. Arsyeja është tjetër. Fare tjetër. Dua të të tregoj që, sado që jetoja mirë dhe kisha, ku e ku, një komfort familjar për t›u patur zili, në momente të veçanta, të kam kujtuar dhe e ndjeja veten si bosh. Nuk ia falja vetes nxitimin dhe shpesh pyesja veten: përse? Aq më rrinte mbi kokë kjo pyetje sa më dukej si ajo shpata e Damokleut. Duke u bluar nga mendimet, zija dhe kërkoja ngushëllim me të shkruar. Kurrë nuk ia kam thënë për hartime dhe, kur të lexosh, se si kam shkruar, edhe mund të qeshësh. Qesh apo nuk qesh, unë po t›i dërgoj ashtu siç i kam

ndier në atë kohë, kur qeshë «taze» dhe sapo më dilte e «pira» e martesës. Për t›u çuditur është fakti shumë domethënës: kohë pas kohe, sa herë që mbyllesha në vetminë time, kërkoja të «udhëtoja» në kujtime imagjinare për të justifikuar ç›kish ndodhur. Dhe pse mos ta them: gjithmonë më fanepsej imazhi yt. Nuk më linte të qetë dhe, për të patur një përshtypje sadopak të përafërt, po ta dërgoj si «Express», të zezë mbi të bardhë siç e kam ruajtur në valixhen time që është zverdhur nga koha.

* * *

«... thonë që zemra ka arsye që nuk e njeh arsyen. Gjithashtu thonë që zemra nuk pyet për arsye. Duken si lojëra fjalësh, por nuk është ashtu. E, megjithatë, këto që thuhen, në çaste e situata të caktuara, më bëjnë që të kthjellem e të them: arsyeja duhet të dalë mbi zemrën, ta drejtojë e ta komandojë atë. Gjithkush me këmbë në tokë e me mëndje në kokë, kështu bën. Ti duhet ta dish: unë nuk dalë dot nga vetja. Shpesh gjumi nuk më zë e qetësia më është prishur. Është zëri i brendshëm, zëri i ndërgjegjes që nuk më lë të fle. Ky zë më»vret». Më vret sa herë që mendoj se ç›kam bërë. Nuk e di, por më duket se kurrë nuk do ta gjej qetësinë. Qetësia më ka humbur përgjithmonë.

Mendoja se gjatë kohës do të harroja ç›kish ndodhur. Por jo. Aspak. Të mendoj ty dhe ndihem fajtore pranë njeriut që kam pranë. Fajtore! O Zot, përse duhet të ndodhë kështu? Sipas mendimit tim, mëkat nuk bën vetëm kur vepron, po dhe kur e mendon atë. Dhe aq jam kapur pas këtij mendimi, sa më bëhet sikur dikush më pështpërit në vesh: - Ti je mëkatare! Ti je mëkatare pranë njeriut që ke për bashkëshort dhe kjo është e pafalshme. Ky zë as që më ndahet. Nuk më lë që të mbyll sy dhe ti duhet ta dish këtë. Jo vetëm ta dish, por dhe të më kuptosh. Jam e dënuar të vuaj brerjen e ndërgjegjes të atij që kam pranë. Se në fund të fundit, ai është krejt i pafajshëm. Përse vallë duhet që ta lëndojë kur më ka mbajtur si rrallëkush? Jam e dënuar që për asnjë çast të

ë të japë sinjal, mezalla se ma varë. Sikur nuk e di unë që ti për t›u hargalisur shok ke veten. Po unë kam pritur çastin, se jam e duruar. Nuk shpejtohem unë , jo. S›më shikoje, po unë isha jashtë «listës». Çasti, siç e sheh, erdhi. Leta të më falë. Unë vërtet jam pak e drobitur (vërtet kish një trup të dobët dhe hiç nuk të hante syri!), por ti do të bindesh se ç›magmë të fshehtë ka në «vullkanin» tim. Unë jam prushi i fshehur poshtë hirit, që të djegë. Ndërkaq, ajo e mbërtheu prej zverku, e futi atë në kularine duarëve të saj dhe ai, i futur në këtë zgjedhë, u lëshua mbi të me neps dhe u «dogj» nga një prush i vërtetë. Pas «djegies», qe ajo që e sulmoi: -Hë, si t›u duka? Të pëlqeva, apo jo?-U befasova, - i thashë asaj. As që ma merrte mëndja. Ajo, e kënaqur që arriti atje ku donte, më tha: -Dëgjo, ti je hapur si kungulli dhe ke marrë gardhin dhe hiqesh sikur di çdo gjë për ne, femrat. Dhe jo vetëm ti, vazhdoi ajo të mbante leksion. Ju i ndani femrat në të bukura (nga ato, që ti, shpesh, në kolektiv, thuaj: -femër për t›u pirë në kupë!) , dhe në jo të bukura: të shëmtuara, siç thuaj ti. Unë të dëgjoja (ndaj dhe të dua, se ti flet hapur), dhe thashë me vete: - E, ku dini ju gjë ju, burrat, për ne , femrat! Ne jemi minierë më vete. Duhet të hapësh galeri për të xnjerrë xehërorin që fshehim. Por të gjitha, si të bukurat (për të cilat lëpini gjuhën me neps), por dhe ato që s›janë të bukura, «xehërorin» njëlloj e kanë. Ja, e pe vete!Është apo nuk është kështu? Ke parë ti, - m›u drejtua mua, që ajo «tigresha» që desh më la pa gjuhë, kish të drejtë. Të them të drejtën, kur më doli boja me këtë «tigreshën», më trasferuan në një shkollë tjetër.

* * *

Transferimi im, tani që kisha mbi 30-vjet në arsim, sikur nuk mbante erë të mirë. Po një gjë e vendosa. Më s›do bëja marrëzira. Do t›u shamngesha, se po bëhesha si ajo ena e emaluar që cifloset dhe duhet hedhur, se nuk hahet në të. Pra, këtej tutje, unë, Adhurim Basha, do isha një burrë serioz. Mirë, o burazer, mirë, por, po të lanë për prift, bëhesh dhe dhespot. Më mirë të dalë nami apo

kohë, me demek, dhe duke qeshur më tha: -Nga të mënçmit, ne, budallenjtë, duhet të mësojmë. E di ti më tha se si ka thënë nobelisti Anatol Frans? Që të dashurosh mirë, duhet të provosh shumë. Tani, mos më ndërpre, se mos harroj ndonjë gjë. -Kaq rëndësi kanë për ty? -Pse pyetje është kjo? Po unë e quaj fyerje, po t›më quajnë Don Zhuan. Se kurrë s›kam kërkuar dashuri me dhunë apo të kem shfrytëzuar një rast. Më kanë dashur dhe i kam dashur. Jam larguar apo janë larguar se të tilla qenë aryset, kushtet. Arabët thonë: -Mos e kërko aventurën, po mos iu shmang asaj, po të doli në rrugë. Pra, unë si Adhurim, ndonjëherë jam zënë ngusht. Shiko, - vazhdoi që të justifikohej, - në ca punë dhe në këto-me femra siç i quan ti- ka disa kondicione që ndodhin si pavarësisht nga ne. Se jam pak napoleonian nga mendimet unë. A nuk i tha Napoleoni një ushtari që po frikësohej nga predhat që hidhte kundërshtari: -Dëgjo, ushtar, në se ajo predhë është nisur të të vrasë ty, edhe njëqind pashë nën dhe po të futesh, do të gjejë e do të vrasë. Ja, a nuk më ndodhi me Irisin kështu. Unë qeshë në punën time dhe ajo erdhi si një bekim nga Zoti. Thuaj, po deshe, nga djalli. Zoti. Zoti. Ai është lart, po poshtë shikon. Ai ma dërgoi dhe unë nuk do rrija si guak. Apo jo? Nuk ka faj ai që "vret", po ai që»vritet», u mundua ai të mbrohej.

Një ditë në shtëpi (epo donte të takonte, Letën?!), vjen një kolegia ime. Vetëm unë dhe ajo. Fol o mur, fol, o gur. -Oh, nuk qenka Leta?!-pyeti dyshueshëm ajo. Qe pyetje kot, se e dinte si dreqi që Leta qe në shkollën e mbrëmjes. -Pse kishe ndonjë gjë për t›i thënë?- i erdha në ndihmë unë. -Ëhë, pohoi dhe, sakaq, m›u afrua dhe më thotë: -E nxjerr dot gjuhën, paksa?! Dhe unë, pa hezituar, e nxora. As që më shkonte mendja për gjëkafshë. Hamendësova-po, punë sekondash, ama, se mund të marrë vesh nga astrologjia dhe kushedi seç do të broçkullis?!!Jo, more burazer, jo. Sa e nxora (mos e nxjerrsha, se ç›më panë syrë, s›e them dot me gojë), ma kafshoi me aq forcë, sikur të qe një tigër Azie. Dhe m›u përvesh: -Më ke torturuar prej kaq kohësh. Sado

mos gjej qetësi, deri në fund të jetës. O Zot, a do më falësh dot?! Të lutem, falëm ti!

Bishareti

P. S. Thonë që dashuria të bën të krijosh poezi. Pra, ndodhte, që ato që shkruaja në fletore, t'i bëja poezi. Poezi i thënçin, por sikur malconin plagën. Duhet të kem shkruar nja njëzet të tilla, por, siç duket, unë «poetja» nuk kam qullosur ndonjë gjë dhe i kam grisur. Kanë shpëtuar nja pesë a gjashtë. Të gjitha cylës i bien po në një vrimë. Kur i lexoj, edhe buzëqesh, po edhe mvrejtem, se ndjej se diçka më sëmbon. Çudi: që të gjitha kanë vetëm një titull: «Të lutem, falëm ti!» Duke dërguar vetëm njërën prej tyre, them se i kam dërguar të tëra.

Të lutem, falëm ti!

Të lutem, më thuaj, çfarë dua? Çfarë kërkoj?
Në jetë asnjë gjë nuk më ka munguar
Pse imazhi yt vjen të ma turbullojë?
Si vallë gjatë kohës nuk të kam harruar?

Prej meje nuk ndahet, por më rri pranë
Aq, sa sikur nuk bëj dot pa të!!!
Pse ky imazh kaq lidhur më mban
Më mban, po s›flas si në «filmat pa zë»

Të lutem, më thuaj: çfarë dua? Çfarë kërkoj
Që imazhi yt të largohet nga unë?
O kohë e dikurshme që s›mund të harroj
O Zot, përse më mundon kaq shumë?!... .

Tiranë, 7 gusht 2014

FIRMA E RRAHMANIT

Kujtimit të Sejfulla Malëshovës

-A ndalesh një dekikë, mor jaran?!

Ktheva kokën dhe, kur pashë që ky që po më thërriste qe Rrahmani, frenova këmbët dhe për t'u bërë disi më i afërt me të (në të vërtetë kisha të njëjtën afinitet që kisha për timatë), po në të folmen e tij, iu përgjigja:

- Nji ku më ke mixha Rrahman! Dhe, për të shuar kuriozitetin e të gjithë atyre që do ta lexojnë, paraprakisht u them: Mixha Rrahman Maka, se për të dhe do tregoj, ishte komshiu ynë në fshat, me origjinë prej Bosnjeje. Qe nga ata boshnjakët që nuk kishin vështirësi ta flisnin shqipen: kishin jetuar në NOVI PAZAR, ku, siç thoshin, kish shumë shqiptarë. Por... dhe, nën këtë trysni që ushtron kjo lidhëse qeshë dhe unë, kur frenova që të dëgjoja pse duhet të ndaloja.

Erdhi drejt meje (unë njëzet vjeçar dhe ai i kish kaluar gjashtëdhjetë) dhe, tek rrokëm duarët për t›u përshëndetur, më tha:

- Hej, more jaran, kam ra në nji «usta» shkollet që ku-ku për ty! Medet me të vu ty përballë atijna? A ndjen ça po të them? Qebesa veç aj dhe Pejkamberi dijnë aq. E kurse ti dhe shokët e tu veç u grahni cullëve dhe ça di veta.

RRËFIMET E NJË "MËKATARI?!"/3

Prolog

Sado që "mëkatet" e mikut tim, pothuaj, nuk numërohen, unë, të them të drejtën, nuk do vazhdoja më. Se litari duhet sa më i gjatë dhe biseda duhet të jetë sa më e shkurtër. Në se po vazhdoj, kam arsye. Në mesazhe private më shtrohet pyetja: -A është dashuri kjo e Adhurimit apo është me të vërtetë mëkat dhe aq. Askujt (mes mesazhesh, disa janë femra!) unë nuk i kam kthyer përgjigje. Me këtë prolog, po ju përgjigjem të gjithëve: -Unë jam veç"qela" ku, Adhurimi, është rrëfyer. Se, ç'është e vërteta, ka gjithmonë një moment që njeriu do të rrëfehet. Se kush nuk ka të fshehta, qofshin ato dhe mëkate. Mvaret. kur thotë nobelistiti Grass që a je i zoti që të «qërosh» qepën?Dhe parë me syrin made in Grass, rrëfyesi im, edhe po pati mëkatuar, çlirohet disi prej tyre. A qe dashuri kjo që provoi Adhurimi, mvaret, mandej, si e interpeton njëri apo tjetri dashurinë. Unë nuk po hedh një gur në ferrë dhe po ftoi gjithë lexuesit që të vijnë e ta nxjerrin. Unë thjesht veç po tregoj duke mos demaskuar as atë që më tregon dhe as ato me të cilat, siç thotë, ka kaluar një pjesë të jetës. Nuk paragjykoj asnjë mendim dhe jam i hapur.

* * *

Adhurimi vazhdonte të më tregonte për çaste të tjera intime. Dhe, kur unë i ndërhyra dhe i thashë: -Ore, po dashuri i quan të gjitha këto ti? Ai ndaloi për një çast, e ndezi, si për të përfituar

-Ti më duket se po më puth dhe për mamanë? -Po, - pohooi ai. -Po me mamanë ti ke shkuar dhe më tej. -Kam shkuar. -Me mua nuk dashke?! -Me ty? Po me ty ndryshon puna. Ti je e re dhe të ardhmen e ke përpara.

-Po sikur të»rrezikoj» vetë, çfarë do thoshe?Dhe ajo, pa pritur pëlqimin e tij, u zhvesh e tëra kollopan dhe, si një pafajësi ëngjëllore dhe e bukur, i tha: -Ja, tek jam!Ti do shijosh, i pari, atë që kam ëndërruar. Dhe po , pa marrë leje nga ai (më bëri pjesëmarrërës në «vrasje»-pohonte ai, tek rrëfehej), filloi t›ia hiqte këmishën, pastaj i zbërtheu pantallonat (more po ku e kish gjetur gjithë atë guxim, xhanëm) dhe «profesor» mëkatari u dogj në furrën e»mëkatit». Më pas, ai pa se si ajo ishte nderë e tëra, me këmbë të hapura , dhe dukej se do binte në një gjumë të gjatë pas një beteje që e kish kërkuar vet.

Kur ajo e «mori» veten, u vesh, mori një libër (libri qe dhe shkaku, de!) dhe, pasi u puthën gjatë dhe ngrohtë, doli nga dera.

Ai e ndezi dhe tek pa tymin që davaritej në tavan, u fut në meditim. Ja, khtu qenka jeta. Ajo shtrihet në kohë e hapësirë, është siç davaritet kjo rrëkezë tymi duke humbur në humbëtirë. Ka në jetë kujtime e mbresa dhe ka, gjithashtu, dhe mbresa që lënë vragë apo plagë që mezi zënë korë. Më tej vjen brenga për ato që nuk ke arritur për shkaqe objektive dhe subjektive dhe, veç saj, edhe pendesa për gabime apo dhe faje. Pse kot thonë tureqit që «Njeriu është dhe shejtan, dhe melaqe». Pra çdo njeri është dhe ëngjëll dhe djall. Të jenë mëkate këto të miat apo ?!!!...

15 janar 2011

Unë e dëgjoja me politesë dhe as më rëndej, në më shante se si mësues as që i hyja më në sy, sa kish hasur në këtë «usta» që vinte fill e pas Pejkamberit të tij. - Mixhë, - e ndërpreva, - po si ke ra në këtë «usta», ani unë nuk ta mbush synë.

- Siiiii? - e zgjati pyetjen, sikur do të fitonte kohë. Por nuk rashë unë, jaran, por qe ai që më gjeti. Më gjeti dhe, tak- fap, sa hap e mbylli sytë, ma ka msue firmën, ore. - Po kur ta mësoi kaq shpejt firmën, kur ti as di që të shkruash dhe as të lexosh?

- Eh, allahile, kështu qe dje more jaran, po nga soti tash po e sheh ti Rrahman Makën kur po e hedhi frimën tak-fap, siç heq e vë këtë «plisin» e bardhë mbi kokë. Tek më pa që e vështroja dyshues, më erdhi në ndihmë. -A nuk beson, a? Qit, more nga ajo çanta jote e mësuesit nji fletore e tash po e sheh sa pare të ban nji ajo shkolla jote dhe çfarë «ustait» kam gjetur veta. Bëra sikur i besova dhe për t›ia bërë më të lehtë «firmën», i them: - Mixhë, mua më mjafton fjala jote, po a mundesh me m›tregue si të «gjeti» dhe si ta mësoi firmën «ustai»?

* * *

U ulëm mu aty ku u takuam, se mixha Rrahman nuk ish nga ata burra që duhet të flisje në këmbë. Qe vjeshtë. Vendi qe i thatë dhe, ndërsa prisja rrëfimin e tij, e pashë që, tek zuri vend mirë e mirë, nxori kutinë fafont të duhanit dhe, pasi e drodhi si një terjaki i vërtetë, nxori nga xhepi i brendshëm i xhaketës një cigarishte të gjatë, punuar me ornamente që qe, me të vërtetë, e bukur. Cigarishtja e gjatë tek buzët kishte një pjesë të qelibartë që qe verdhur nga nikotina. Mbasi mbaroi punë me anën «teknike», as që e hapi gojën deri sa tymosi tërë kënaqësi. Mua nuk ma zgjati, se e dinte mirë që, dhe po ta pija, në sy të tij as që do guxoja, kur sapo kisha vënë brisk në faqe. Unë prisja, por dhe ai nuk po ngutej. - Ndodhi dje, more jaran! Kam shkue në Fier me e dorëzue dohanin në magazje të ngrumbullimit. E kam

çue kierren bash tek dera e depos. Asht çue aj, makaziu, dhe po vren disi kualiteitn dhe, pasi e peshon, më ban za: - Kosov, hajde me hudh firmën! Më thirri Kosovë nga plisi mbi krye. I them: - Jam bosnjak, jaran! Ani, po më thotë, se dhe ju burra të gjatë jini si kosovarët. E më pyet apet: - Si të quajnë, more burri nga Bosnja?

- Rrahman Maka!- i jam përgjegj veta.

- Afrohu, bosnjak, me vu firmën!

Kur kam hy në makzje, ia kam zgjat gishtin me ma lye me bojë si punë firmet dhe aj:

- Pse ma zgjat gishtin?

- Se nuk di as me shkrue dhe as me lexue.

- Po as për firmën?

-Qebesa, jo-e!

Eh, more bosnjak që më je i gjatë sa një lis dhe don të firmosësh me gisht!- e ndjeva që e tha ashtu ulti. U mendua nja dy dekika dhe më ka thanë:

- Afrohu këtu! Jam afrue. - Pa hiqe një vijë të drejtë, por të shkurtë. E kam ba. Tash, - më ka thanë apet, - mbi nji këtë vijën e drejtë, ma baj nji tjetër, po kryq. E kam ba dhe njiat! Tani edhe nji tjatër, edhe nji tjatër, bash si ai psheshi i tërhanasë kur ta ban jotshoqe. Dhe, për njiat Zot, kam ba si po më thojte. Doli nji farë zhgarravinet, jaran. - Sa vija hoqe, poshtë e përpjetë?- më ka pvet.

- Gjashtë!

- Mbaje mend! Kjo asht firma jote mbas sodit, - më ka thanë. - Ha dhe dishka më ka thanë: - Rrahman, mbaj mend gjashtë vizat dhe vrej këtuna: firma sa më e keqe me kanë, aq ma mirë asht. E kam rrok në qafë atë farë ustait dhe, prej sodit, Rrahman Maka po ta «psheshi» firmën bash si ma ka mësue «ustai». Natyrisht, unë qesha me firmën «pshesh» të Rrahmanit dhe tek e urova për këtë firmë, e pyeta: - Po si quhej ai «ustai» aq i ditur që punonte makazinier?

Mixha Rrahman, solli sytë rreth e rrotul, dhe, kur pa, që nuk «rrezikonte» për më tej, ma priti:

mirë, ajo kish trokitur në derën e tij, së bashku me të bijën që qe, pothuaj, gjallë e ëma.

* * *

Ndërsa po merrej me sistemimin e disa librave, ai ndjeu se dikush hyri aty (si një mackë që hyn tinëz, -do shprehej ai më vonë).

-Porfesor, punë e mbarë!- përshëndeti ajo. -Oh, Iris, sa më befasove!

Sakaq, kur i dha dorën, ajo mënd iu var në qafë dhe e shtrëngoi fort. Profesori e ndjeu veten ngusht. Tentoi që të shkëputej, por, «pala tjetër», nuk shkëputej lehtë. Ai po dyluftonte me veten. Qe zënë si në çarg: midis dëshirës për të kaluar më tej apo të një frenimi që duhet të bënte edhe si moshë, por edhe si moral. Kishte frikë se shkelte mbi një tabu. Irisi ishte vajzë e asaj që kish dashur (ç›ne -kish dashur-po ai e donte akoma si dikur!!!) , dhe, ja tani si një bekim nga Zoti apo i trazuar nga djalli, vjen dora vetë, e bija. «Profesori», duke «tejkaluar» çdo rrezik, ia mbërtheu kokën dhe, kur atë kokë po e drejtonte nga vetja, ndodhi dhe «çudia»: ai pa që gjimnazistja e bukur lëpiu buzët(njësoj si e ëma-i shkrepi atij) dhe, si një befasi, iu lëshua profesorit me puthje, sa thoshje se kishe të bëje me një»sojleshë» të stërvitur , Porfesori nuk e hante thatë se, me kohë, e kish marrë «patentën e ustait»e puthi dhe ai nxehtësishtt, por nuk shkoi më tej. Kur u shkëputën, Irisi, i tha: -Sa e kam pritur këtë çast?-Si është e mundur? -pyeti dyshueshëm ai. -Mamaja.

Mamaja! –filloi ajo të shpjegoshesh. Ajo mënd «këndon» për ty. Të gjitha m›i ka treguar mua. Se unë e mamaja që, kur vdiq babi, para dy vjetësh, jo vetëm flemë bashkë, poor shpesh e kalojmë kohën dhe me ty. Dhe unë, pa u ju njohur, kisha filluar që t'ju doja. Kur erdha me mamanë dhe ju pashë kështu, po me atë imazh që kish ndërtuar mamaja për ju, m›u shtua dëshira dhe ndaj kam ardhur. Ai, i këndellur nga ky pohim e puthi përsëri, por, tani, qe një puthje aq e ngrohtë, sa ajo nuk ndënji pa i thënë:

mora me vete. Dhe, po ajo, si dikur, tutje-tutje, vajzërisë e»vuri» poshtë dhe kë? Një njeri si Adhurimi që kish nevojë për fre dhe jo për shtyrje. Kur u ngritën, panë që vajza kish dalë në korridor ku bënte sikur krihej para pasqyrës, që për lemeri të tyre, pasqyronte çdo gjë që "luhej" atje mbi divanin e kuzhinës. Dera qe»harruar» hapur. Ato ndënjën edhe paksa (Dashuria dhe Adhurimi donin që ajo natë mos kish mbarim, por dhe pak kthehej e shoqja, se ora po shkonte 9 e mbërmjjes), dhe, kur po i përcillte, ai ia shtrëngoi dorën me shumë intimitet Dashurisë (asaj mënd i këndonin sytë), dhe, tek do përcillej dhe me Irisin, gjimnaztisten e bukur me flokë të zeza, ndjeu këtë që i tha: -U befasova me bibliotekën tuaj (dhe vërtet: ai kish një bibliotekë për t›u patur zili), a më lejon që të»abonohem» dhe unë tani që dhe jua mësova shtëpinë. Kur të duash, si në shtëpinë tënde. Apo nuk je dhe e bija e Dashurisë, - e mikloi ai, duke e zënë prej qafe. -Ah, profesor, sa më bëhet qejfi!- shprehu gëzimin ajo. Dhe, kur do ndahej, Irisi mezi e shkëputi dorën nga ajo e profesorit.

* * *

Kur ikën, ai risolli në kujtesë gjithçka. Si u lidh me Dashurinë, si vinte ajo për të marrë libra tek ai; si zinin dhe diskutonin rreth librave dhe, mandej, dashuria mes tyre që nuk qe thënë të finalizohej. Ata kishin tri vjet me njëri-tjetrin dhe «rrethanat» qenë të tilla, që ai nuk e mori dot atë. Pse kot thoshin: mësues Adhurimi është me “qere?!”. I kujtohej, se veç tjerash, se kur kish ardhur me

lejë nga ushtria(dhe ushtrinë Adhurimi e bënte në një repart pune-dhe në këto reparte shkonin ata me «qere»), Dashuria e kish marrë vesh (ata atëherë që të dy banonin në të njëjtin fshat), dhe, fshehuriazi, kur të gjithë njerëzit ishin në punë(ajo sapo qe martuar në atë qytezën paksa larg dhe kish ardhur tek prindërit e saj), pra erdhi dhe gjithë ai mall i mbledhur, pas një ndarjeje të gjatë dhe «aksidentale», zuri dhe u derdh si një lumë kur del nga shtrati. Më tej, secili në fatin e vet dhe ja tani, si një ogur i

- Sejfulla Malëshova e quejnë, jaran. A ia ke dëgjuar emnin se, qebesa, nji miku jem në Fier po ma tregonte si profesor të madh, por nuk di pse ky «tatari» e ka ndëshkue randë. Unë, sa dëgjova emrin e makazinierit të duhanit, kalova në asosacione të tjera, por mixhës Rrahman nuk iu hapa. Tek do ngrihehim, përsëriti: - Eh, çfarë burrit! Sa i dijshëm! U përqafuam dhe u ndamë.

* * *

Për «ustanë» e firmës së mixhë Rrahmanit, kisha dëgjuar që në shkollë, në Elbasan. Libri i tij me vjersha, me pseudonimin Lame Kodra kalonte dorë më dorë, se ende «tatari « i Rrahmanit nuk e kishte «ndëshkue». Që në fillore, pa e ditur sekush ishte, unë dija përmëndësh vjersha të tij. Si sot më vjen ndërmënd, veç tjerash: « këmbëzbathur, bythëçjerrë/ punoj vetëm për të tjerë/». Vjershat «Pse e dua Shqipërinë» apo «Plaku dhe i riu» dhe kushedi sa dija aso kohe. Dhe, kur ndodhi që «tatari» i Rrahamanit e solli makazinier në ndërmarrjen e grumbullimit, e shihja nga larg me kërshëri. E shihja me sy, po nuk guxoja që t›i afrohesha. Ai, sikur qe i ndërgjegjshëm për këtë «izolim» dhe kurrë, deri sa vdiq në qershor të vitit 1971, nuk e pata parë që të shoqërohej me njeri. Të gjithë ata që pretendojnë për takime me të, të më falin në nuk i besoj. Nga gjithë të «ndëshkuarët nga tatari i Rrahmanit» në Fier, vetëm dy veta nuk u panë në shoqëri me të tjerë: Sejfulla Malëshova dhe pianistja e bukur dhe fisnike, hungarezja, Maria Rafael. Është lehtë të krijosh takime imagjinare me të vdekurit, se të vdekurit kanë një të mirë: nuk flasin. Por ç›ka shkruaj, nuk e luan topi. Pa vajtur tek «takimet» e mia me Lame Kodrën, mund t›ju bie një shembull që vërteton atë që shkruaj unë.

* * *

Nexhmi Bllaka ka qenë mik i Sejfullait. Ka qenë zëvendës ministër kur Lame Kodra qe ministër. Edhe Nexhminë «tatari i Rrahmanit» e ndëshkoi. Ka qenë nga ata të grupit të Riza Danit. Me këtë grup, «tatari I Rrahmanit» pushkatoi xhaxhanë tim, Hilmi Hysi, ish-jurist. Nexhmiu qe me fat: u dënua me burg. Kur

doli nga burgu, këmbëve dhe në Fier ku rronte Sejfullai. E kish marr malli. E pashë, - tregon Nexhmiu, - dhe i thirra. Jo vetëm s› qëndroi, por u dha këmbëve, sikur ta ndiqte dikush nga prapa. Po dhe unë nxitova dhe në një vend pa njerëz, më thotë: - Të pashë Nexhmi! Por çfarë do? Nuk e di hallin?... Pse kot e quante Rrahmani, Usta! I tillë qe. Por ja që mua m›u dha mundësia ta takoj. Në se quhet i tillë, de.

* * *

S›kish mbasdite vonë që mos shkonte në kinema. Le ta kishte parë filmin, atë do ta gjeje diku sipas biletës që kish prerë. Rastisi që ta kisha ngjitur. Kur u bë pauza e dokumentarit, mora guximin dhe e pyeta:

- Profesor, - i thashë. Kam gjetur një vjershë që nuk ka emër (qe e modës që për armiqtë e «tatarit» nuk vihej emri), mos është juaja?

- Pa ta dëgjojmë, - tha.

Fillova të recitoja aq sa dëgjonim të dy. Ai më ndërpreu: - Jo. Nuk është imja. Është e Petro Markos. Po ku shkruaj dot unë aq mirë sa Petro Marko?!!! Filmi filloi e mbaroi dhe me kaq qe dhe takimi me «ustanë» e firmës së Rrahmanit.

* * *

E shihja që çdo ditë që linte punën, bënte të njëjtën rrugë mu midis mapos së vjetër dhe gastronomit. I vetëm me kasketë me strehë dhe, tek ecte i përplaste këmbët fortë. Thuaj sikur ecte me çap parade. Askënd nuk përshëndeste rrugës. Por ja tek sheh një fëmijë me akullore në dorë:

- Sa lekë e more atë akullore?

- Dhjetë lekë dhe iku duke e lëpirë

- Kështu e bën dhje... , - tha «ustai»

Ndodhi, para se të vdiste, të shtrohej në spital. Askush nuk i shkoi për vizitë. Doli gjallë dhe kur shkoi atje tek dhoma ku punonte bashkë me një tjetër, i thotë:

- More, B... e more vesh që qeshë ca ditë në spital?

mendonte që t›i pyeste, e mori fjalën Dashuria. Kemi një muaj që jemi vendosur në një lagje tjetër nga juaja. Dhe vendosa që t›ua gjeja shtëpinë. E shikon: ja që të gjeta. Mora me vete dhe Irisin... si «trime», -shtoi me të qeshur dhe, siç shihej, me të»ngjeshur». Ajo, ndaloi nga shpjegimet dhe i hodhi sytë drejt tij, sikur do bënte një studim më preçiz. Vuri re, se, pas 20-vjetësh, Adhurimi kishte ndryshuar paksa. Vërtet që flokët ende ruanin po atë dëndësinë e dikurshme (ajo e dinte mirë se sa e sa herë kish «lozur»me gishtat e saj me ta), por thinjat anash tregonin se ai tani qe mezoburrë dhe vallë do ishte ai vrulli djaloshar i dikurshëm. Studimi, pothuaj, qe reciprok: Adhurimi ia kish ngulur sytë dhe pa , se, sado që kishin kaluar 20-vjet, ajo, Dashuria (në sinkron me emrin, de!), ruante, ende, freskinë e dikurshme: asnjë rrudhë në faqe, po ai shkëndijim sysh që të ndillte dhe, siç vuri re, ajo, ende, kish po atë lëpirje buzësh që të vinte në ngasje. Dhe ai, prej kohësh, i njihte këto reflekse»vrasëse» që të ndillni tutje, në arrati, në një kohë pa kthim.

E vetmja-fajtore pa faj- në atë mjedis, ku kujtimet kishin dalë nga sepetet ku qenë fshehur dhe po shafqeshin si një»film pa zë» sa tek njëri, aq dhe tek tjetri, qe ajo gjimnazistja, Irisi, që duke parë pozicionin e saj, për ta shpëtuar sado pak, këtë»shkëmbim mesazhesh», zgjati dorën tek rafti i bibliotekës së të zotit të shtëpisë dhe u dha të kutpoj, dy të tjerëve, se tanimë ajo»nuk ishte më aty!!!». Se, të thuash, të drejtën, biseda sikur kish ngecur veç nga ajo: fajtoreja pa faj. Kur Irisi, doli «ofsajt», kur thonë ata të sportit, Dashuria e mori fjalën.

-Ju kini dy dhoma e një kuzhinë këtu, apo jo?

-Po, -iu përjgigj Adhurimi.

-Ta shoh pak kuzhinën?

-Patjetër, - dhe ai i priu përpara.

Sa u sosën atje (as dy-tri çapa larg), ajo iu hodh në qafë dhe zuri ta puthte me aq mall, sa putheshin dikur-dikur.

-Çupa, -synoi të mbrohej ai. -Nuk thotë gjë ajo. Jo. Ndaj e

RRËFIMET E NJË MËKATARI /2

Dera trokiti. Kur e hapi, Adhurimi u befasua. Pa Dashurinë bashkë me vajzën e saj, që, siç e prezantoi ajo, pasi u ulën, sapo kish marrë maturën në gjimnazin e një qyteti, paksa larg nga qyteti ku banonte Adhurimi. I zoti i shtëpisë u priu mikeshave tek dhoma e pritjes. Sa u ulën ato, ai u ul ballas dhe, ç'është e drejta, nuk po i mbante emocionet. Si në ekran, në kujtesë zunë dhe i erdhën shumë çaste intime (dhe të dhimbshme, domosdo), që kish kaluar me Dashurinë, kur ajo qe vajzë-një bukuroshe tërë hire- që, për nga bukuria, i kish të rralla shoqet. Kur qe vajzë, kishte një fytyrë, pothuaj, farfuri dhe kish një nur që të ngrinte mëndjen. Dhe ai e kish dashur, ashtu siç dashuron një njeri që do me zëmër dhe , në nuk arritën që këtë dashuri ta finalizonin me martesë, qe një histori më vete. Qe një kohë që, dhe për dashuritë, ndërhynte partia. Dhe nga partia Adhurimi qe pak si «non grata» apo siiç thoshte një në fshat: mësues Adhurimi është me»qere?!». Pra, koha kish matur me një kut tjetër dhe Dashuria qe martuar diku tjetër.

* * *

Kishin kaluar, pothuaj, 20-vjet nga kjo dashuri dhe, ja pas kaq vjetësh, pa pritur e pa kujtuar, ajo bashkë me të bijën-kopje e së ëmës kur qe e re dhe e dashura e Adhurimit-, ja tek kanë zënë vënd si mysafire dhe, humbur kujtimesh dhe hamëndësish, Adhurimi nuk po i jepte dum dot kësaj vizite të papritur. Sa i qerasi (e shoqja qe në punë, në shkollën e mbrëmjes) dhe, ndërsa

Unë, - më tregonte B... , kokën ulur, se nuk ma mbante, pa isha dhe komunist. Dhe ai përsëriti:

- More B... në spital nuk qe Sejfullai, por qe një njeri! Dhe, kur vdiq qe i vetëm. E varrosën në një vend ku e shkelnin me këmbë kur vinin në varreza.

* * *

Në vitet e demokracisë kur punoja si inspektor në Drejtorinë Arsimore të Fierit, mbaj mend që poeti i burgosur, Nuredin Boriçi erdhi për të bërë thirrje për donacione për një qivur për Lame Kodrën. Natyrisht, sado që kisha dëshirën, nuk pata mundësinë dhe, në u arrit sadopak për këtë personalitet të kulturës shqiptare, tek shkruaj nuk kam se si mos e lakoj Nuredin Boriçin dhe, po të ishte gjallë mixha Rrahman, me siguri që do ia kish ngritur me shpenzimet e tij këtë qivur. Sidoqoftë, gjithë kjo «mori» ngjarjesh nuk më erdhën fare rastësisht. Qeshë para ca kohe në ish-fshatin tim, në Petovë të Fierit, dhe, tek takova dy nipoj të mixhës Rrahman, u mbusha me emocione malli. Aty, ngjitur me Petovën e Fierit, është një fshat (Rreth Libofshë) ku gjëllon një "komunitet" sërbësh. I njoh që të gjithë: kanë qenë bosnjakë, tani të konvertuar në sërbë. Natyrisht, as që i paragjykoj, por «nipojtë» e mixha Rrahmanit, Bajramit, Hasanit, Manos, Ismailit dhe më tej me mbiemrin «Maka» më deklaruan: jemi shqiptarë dhe nuk kemi punë me ata. Siç duket, «ustai» i firmës kish bërë punën e vetë. Dhe të them të drejtën, më erdhi mirë, siç më ka ardhur mirë që edhe «ustai» i firmës së Rrahmanit po zë vendin e duhur në historinë e arsimit dhe kulturës shqiptare.

Tiranë, 30 korrik 2014

IK E IK NËPËR ZHAPOKIKË

Ka qenë aty prag viteve ‘80-të, kur më ra rruga për në Zhapokikë. As kisha dëgjuar më parë për të: për këtë fshat të madh të Tepelenës. Me sa më kujtohet, sipas hartës gjeologjike të naftës, ky fshat qe ndarë në tri zona. Që i emërtonin naftëtarët kështu, them unë, arsyeja qe e justifikueshme: qe fshat me përmasa të mëdha. Si i fshehur fshati në pyje pa fund e anë. Unë ardhur nga Myzeqeja që kisha parë vetëm pyllin e madh të Vajkanit, këtu e humba pusullën. Një pyll me krahë kilometrikë në gjatësi e në gjerësinë e tij. Pse ishte i tillë, ky pyll pa anë e fund, pa dhe kish ndodhur ai emërtimi zonal i naftëtarëve. Pra, për ekipin e naftës kishte: Zhapokikë 1, 2, 3. Unë me BC-në e drejtorit zbrita për të pushuar tek Zhapokika 2. Sa të mbaronte punë ekipi i drejtorisë, - mendova, - po i hedh sytë pyllit. Po i hedh sytë qe si fjalëgoje se si mund t’i hidhje sytë vërtet në këtë pafundësi të gjelbër, që, në futeshe në të, zor se mund të shihje qiellin nga ata drurë të lartë e të dendur? Hoqa dorë nga hamëndësia ime dhe, tek do kthehesha tek vendpushimi, mbërriti një vendas. Më përshëndeti dhe, si gjithë vendasit e atyre anëve, nuk mund që t’ia lejonte vetes pa m’u bërë më konfident.

- Nga të kemi?
- Nga Fieri.
- Patjetër që pret shokët e makinës.

si të kishte një plagë vrasëse dhe pa shpëtim dhe Adhurimi tek penetroi fuqishëm në «seksin pakufi», ndjeu një kënaqësi të paprovuar më parë. Ndërsa u «shkrehën», ajo zuri që ta»lëpijë» të tërin ashtu siç bën një luaneshë me mashkullin e saj, ndërsyer nga instikti i kënaqësisë së seksit. Ajo e dinte mirë, se , kështu, mashkulli «ribëhet» shpejt dhe asaj nuk i durohej sa të zhytej në atë «det kënaqësie» që ajo e kërkonte dhe e kërkonte sërishmi, me ngulm. Kjo ndodhte se i shoqi, Kuqua, qe dhënë pas detyrës dhe, i lodhur dhe i stërlodhhur, duke bërë plane për»shkatërrime skalionesh» të armikut, rrallë i jepte kënaqësi të tillë. Kur rifilluan përsëri ai pa, se pak nga pak, po e linte fuqia. Se partnerja kishte nja dhjetë vjete më pak dhe qe mu në kulm të lulëzimit, kurse ai, sapo i kish lënë të pesëdhjetat, dhe»bredharak» në kësi punësh (po kur i quante që të gjitha, dashuri?!), pa që sa vinte dhe nuk ish më ai, i pari, Kur ndizte zjarr shpejt. Sikur po plakem, mendoi ai për një çast, por ky mendim qe punë sekondash, se»pantera» i kërceu sipër dhe ai sosi seç çfarë nisi. Kur u vesh dhe u bë gati ta përcillte, ajo i tha: -Dëgjo Dhuratën tënde (tani s›qe më e Kuqos, dhe ai u këndell.), unë dua të kem këtu përdita. Dua një Adhurim të vogël nga ty, Ja, këtë dua, dëgjove?... .

12 janar 2011

do shohim e bëjmë.

Atë ditë, Adhurimi, shend e verë shkoi në shkollë dhe ashtu nga mbrëmja, kur nuk e priste kjo fare, i tha të shoqes: Do t›u kthejmë vizitën atyre miqëve, ndaj ç›ke për të bërë, bëje me nge.

Kur shkuan atja, Leta vuri re se ata qenë përgatitur; se që në korridor ajo vuri re se mjedisi qe, si për miq, dhe si grua, nuk i erdhi mirë që ata e gjetën ashtu, kur u erdhën për vizitë. Por punë e madhe, u dha fund ajo hamëndësive. Por si grua ajo vuri re se e zonja e shtëpisë ish veshur aq shik sa Letës nuk iu ndënj pa thënë me veten (qenka stolisur sikur do shkoj në Honololu!!!). U riputhën me të zonjën e shtëpisë (sikur i kish këputur malli) dhe, kjo vajti zuri vënd mu përballë Adhurimit (me siguri, për ta joshur, mendoi Leta!) dhe, si e djegur nga qulli, s›mund të mos mprihte vigjelencën: se e shihte që të shoqit (gjahtar i madh qejfi), sikur i llamburitnin sytë tek gjuante qoft dhe; fsheurazi të tjerëve, andej, nga e zonja e shtëpsisë. Më pa shejtanllëku në këtë mjedis, qe Kuqua që baballëk siç qe, mundohej si e si të kënaqte mysafirtë.

Kur po përcilleshin, Adhurimit Dhurata i futi një pusullë nën dorë. Kur sosën në shtëpi, ai me vrap dhe shkoi në banjë. E hapi pusullën dhe lexoi: «I dashur! (qenka bërë fakt i kryer, -gazëlleu ai). Po të duah hajde nesër pas orës 9 të mbrëmjes se Çimi është me shërbimn në Divizion. Fëmijët janë në gjumë në atë kohë. I mbushur gazëllim, pasi e grisi letrën. ai harroi se qe natë dhe filloi të vërshëllej. Të nesërmen qe si me krahë. veç bubullonte nga gëzimi. -Do të vonohem, - i tha të shoqes se do shkoj nga Kozmai). Kky, Kozmai, qe shok i tij i vjetër). Dhe në orën 9 të mbrëmjes, ngjiti shkallët e pallatit dhe kur mbrriti tek dera e njohur, trokitti lehtë. Ia hapi Dhurata që sa mezi po e priste. Sa hyri, ajo iu hodh në qafë. Mbyllën derën dhe ai vuri re: ajo u zhvesh para tij dhe nuk i durohej sa të zhvishej ai. Por puna nuk priste. Të dy kollopan kërcyen me aq forcë mbi krevat sa, për një çast, por rrokullisej ndonjë oretke. Në krevat, ky»mëkatar» i sporvuar, pa që të kishe të bëje me një»ujkonjë». Ajo ofshante

- Aha, do presësh gjatë se ku dyshi e ku treshi (është fjala për zonat 2 dhe 3).

- Epo Zhapokikë është, - thashë unë.

- Zhapokikë, mor evlat nga kasabaja, por është e largët qeraja, - tha ai që, duke krijuar ato vargje, sikur dhe ma zgjati edhe ca pritjen time.

Por xhaxhai kish qëlluar i muhabetit dhe u ul shesh në një hije. Siç duket, herë e parë që trapit këtyre anëve dhe, sa për atë se "hë se Zhapokikë është", ma ke pak kabim. Se ky fshati ynë, or mik, është hane e madhe dhe, që t›i dalësh tej e mbanë, do një ditë të mirë në je ardhës si zotrote. E sa për pyllin... ohu-ha e kush ia gjeti fundin!

* * *

E pashë që po i hanin brirët për muhabet dhe vet po i ngeshëm, nxora paqetën (e kisha «Diamant» me kuti) dhe ia zgjata:

-Qofsh me nder, - më uroj, por këtë «myteberin» tim nuk e ndërroj. Dhe shiko këtu nga xhaxhai: - Gruan, duhanin dhe kaun e brazdës mos i ndërro!

-Mirë gruan, - e mbështeta unë, po ja dhe duhanin se të dhënka kollë, po kaun e brazdës nuk e kisha dëgjuar ndonjëherë. -Epo sa të rroç aq dhe do të mësoç. Jo se qenke nga kasabaja dhe m›i dike të tëra. Ja ta thotë xhaxha Selami nga Zhapokika dhe ta mësoç: dy qe mbrenë kur plugon. Po njëri e çan brazdën. Ai jatri i mban «iso» si në këngë. E, ore, e! «iso!». Pa provo të mbreçë atë jatrin, ta bën brazdën dy hunj e një purtekë. Epo vëre vëth në vesh. Tymosëm të dy në një kohë dhe unë i habitur nga gjithë kjo pafundësi pyjesh, i them: - Ore, xha Selam, sa i vjetër është ky pylli i Zhapokikës?

- Sa i vjetër? Sa bota, or kasaballi, të keqen xha Selami tyja! Epo sa bota, se kush i vuri metron apo i bëri historinë, por që nga koha e turkut kështu ka qenë. Unë: - Që nga kohë e Ali Pasha Tepelenës!

- Mor Aliu i Tepelenës dhe ai jatri që erdhi pas tij. Se

dhe ai Ali quhej. Epo nuk qe i dëgjuar sa ai, po koshadhet e turqëve i griu. I griu sa sulltani e shpalli jashtë tefterit. «Fermanli!»- thashë unë si për t›i ardhur në ndihmë. - Hë, më të lumtë, se ma gjete! Gjezdiste ato kohë, - tregojnë, - dhe një këngë: « E kam shpallur fermanli/ia dua kokën në sini/.

- Po a e zunë dhe a ia vunë kokën në sini?

- Ja, këtu më qëndro. Po ne të ngeshëm jemi dhe, sa të vinë ata tëndit, do ta kemi sosur dhe atë historinë e këtij jatrit, nga Zhapokika.

* * *

Ky Aliu nga Zhapokika kish dalë kaçak. Dalë kaçak se i vranë babanë dhe, pasi mori hakën, mbeti pyllit. Mbeti pyllit... epo me lënde lisi nuk rrohej dhe që thuaj ti, or mik, iu sulej atyre karvanëve turke. Qe i ri, pa dirsur mustaqja, dhe, si bëri nja dy «zullume» e zënë. Krah e kofshë në Janinë dhe që atje në burg: në Çana-Kala. Nja 5 vjet të mira. Apsana si apsana. Keq! Pisk e pati në burg, por kot nuk thonë: çdo e keqe ka një të mirë pas. Atje, në burg, (epo djalë i zgjuar) na mësoi dhe turqishten. Kur doli, - thoshin, - qe si turk safi. Erdhi në fshat, por kaçaku është si ujku: mendjen nga pylli. Sado që edhe u martua me një deliçupë nga Gllava, nga «zanati» nuk hoqi dorë. Tmerroheshin turqit kur afroheshin në rrethinat e Zhapokikës. Të bënte gjëmën, jo shaka. Të bënte gjëmën dhe , o burra, në pyll. Gjendet gjëlpëra në kashtë? Epo vjen një ditë e kupa që mbushet plot, zbrazet. Kështu ndodhi dhe me Alinë tënë. Zgjati ca dhe, ndërsa sulltani e kish lëshuar atë fermanin për «kokën në sini», koshadhet siç vinin dhe iknin. I dërgonin haber sulltanit në Stamboll: «Ik e ik nëpër Zhapokikë». Ja, kështu.

- Nuk e zunë?- shpejtova unë.

- Aha, marrke përpjekur!- ma preu hovin ai. Unë nuk të thashë që e sosa. Bobo, ç'paska hequr jotëmë me ty për 9 muaj! Po duro, mor evlat!

- Më fal, xha Selam, se e prisha!- kërkova ndjesë.

futi në kasafortën e saj. Në kafene filluan dhe nga pyetjet: ajo për të shoqen, Letën dhe fëmijët dhe ai për të shoqin (desh i tha: si e ke Kuqon?) dhe për fëmijët. Ndërsa qenë ulur, ai pa që Dhurta jo vetëm nuk druhej, por tregohej aq e afërt, sa Adhurimi, që më tepër kish nevojë për fre se sa për ngasje, po niste nga «loja» e tij paksa djallëzore. Afrohej me ngadalë dhe, si pa dashje, fillimisht afroi dorën pranë të sajës, Kur pa që tjetra as që lëvizi, atëherë u shtua»doza»; edhe këmba e tij sikur shkeli (gjithmonë pa»dashje» , de) , këmbën e saj. As këmba nuk dpnte që t›ia dinte. Atëherë ky»-pa dashje», e kapi atë dorë nga gishtat dhe kur dhe kështu, tjetra, nuk lëvizi, filloi që ta përkëdhel, sikur donte t›i vinte «doganën» për atë që kish bërë: se i kish shpëtuar jetën. Nga kjo përkëdhelje (dëjgo, më ndërpreu tek rrëfehej: tri gjëra pëlqejnë femrat. ta kesh si vëth në vesh nga unë: përkëdheljet, peshqeshet dhe lavdinë!), ai e shtoi dozën dhe kur nga na tjetër, kjo përkëdhelje, përjetohej me një purpur të lehtë në faqe; ai e kutpoi se»pakti» qe bërë. Beteja qe e fituar dhe pritej vetëm koha dhe vëndi. Dhe u bind se, kur dora e tij, zbriti poshtë tavolinës dhe tek kërkoi prehërin e ngrohtë, u prit me të njëjtën kënaqësi dhe ai»sherret» siç qe nga natyra, mendoi: anija ime zbriti butë në kozmos, duke bërë analogji me nj anije kozmike, për të cilën kish lexuar në «Zëri i popullit». Kur pa që Dhurata nga purpurë mënd po merrte zjarr nga fytyra, «mëkatari» e hoqi dorën, shkoi pagoi paratë dhe si dy miq, që kanë nënëshkruar një»pakt të fshehtë», dolën të gëzuar nga klubi.

-Më ke magjepsur, - i tha ai. -Po ti mua?Ah, ta dish!I thashë dhe Çimit (Kuqos, shtoi ai me mënd). Do të kisha ikur për dhjamë qeni, por fat, o Zot, ty të bie në këmbë, që dërgove atë ëngjëll, që më shpëtoi jetën. Të kam borxh jetën . Dhe këtë «borxh» e di Dhurata se si do ta kthej. –Mos më bëj me turp, - ndërhyri pa shejtanllëk ai. Mbasi bën veprimet e duhura për paratë e librave, tek e përcilte, Dhurata i tha. : -Hë si do t›ia bëjmë më tej? Unë kam menduar kështu. Në fillim do na ktheni vizitën dhe, mandej,

kur nuk i njohu, priti sa zunë vënd në dhomën e pritje, vrapoi në banjë, bëri një tualet të lehtë dhe hyri për të mirseardhur miqtë.

-Shiko, grua, -filloi Adhurimi, -kjo është ajo gruaja që desh shtypi makina dhe ky, po, kuptohet: i shoqi. Mirëseardhët, uroi ajo duke i zgjatur dorën Kuqos njëherë dhe, kur ia zgjati dhe Dhuratës, ajo pa që e tërhoqi drejt vetes dhe e puthi. Pasi u bë njohja e rastit, ata, pothuaj, i hapën kartërat. Që ketej e tutje do të ishin miq, se miqësia kish lindur në rrethana të jashtëzakonshme...

Pasi i qerasi, Leta u ul me Dhuratën dhe, që të dyja, kaluan në «stacione» të tjera ku nuk kish vënd për burrat. Kur u çuan, Kuqua në fillim dhe Dhurata pas tij, thanë si njëzëri: -Presim të na vini. Kur ta shihni të arsyeshme. Lajmin që do vini e lë Adhurimi tek banka.

Tek mbrritën në shtëpi, Dhurata i tha të shoqit: -A i pe se ç›njerëz ishin? Të mrekullueshëm. -Po, po, - pranoi Kuqua që nuk ia prishte kurrë së shoqes, edhe në shprehej gabim.

-Si t›u dukën?-pyeti Adhurimi të shoqen. -Të mirë, - tha jo, E kush i njeh më tutje? Dhe kur mendon se desh e shtypi makina, - tha Adhurimi... dhe, për pak, duke harruar se qe me të shoqen që ia njihte mirë «huqet». desh tha: apo si është si një tulipan. Se ashtu qe me të vërtetë.

* * *

Qe fundshtatori. Adhurimi kish mbledhur lekët e librave dhe»një rrugë e dy punë!». Edhe do hiqte një mal nga supet (mësuesët janë të trembur nga paratë nëpër xhepa, se tërë jetën janë fukarenj dhe të mësuar me pak para!!!), por dhe do takonte Dhuratën që punonte atje, në bankën e vetme të qytetit. Sa hyri në bankë, pa Dhruatën që doli nga banaku dhe shpejtoi drejt tij: i hodhi pa teklif duratë në qafë dhe, po pa teklif, e puthi në faqe, siç bëjnë në anët tona, me një të fisit. -Hajde, -e ftoi ajo, drejt e tek kafja. -Prit, - tha ai, se dua të heq këtë»malin» mbi kurriz (për çantën me paratë e librave) , pastaj e pimë dhe kafenë. -Nëma mua çantën, - tha ajo. Hyri pas banaku dhe ashtu siç qe çanta, e

- Ku e lamë?- bëri sikur harroi ai.

- Ik e ik nëpër Zhapokikë, - nxitova unë, se mos e ndërpriste këtu tregimin.

E, aty ta paçë fjalën, «ik e ik nëpër Zhapokikë», por ja u gjet dhe këtyre anëve një «sypërpjetë» që u çoi fjalë atyre që e ndiqnin. Një ta rrethuar, që thuaj ti, ashtu ardhur pa ardhur dreka, dhe i bërtasin: - Dorëzohu, o do të djegim të gjallë me gjithë tëtshoqe. Hë, - harrova të të them, - Esma e quanin të shoqen. Esma po hanko Esma me halle. Esmaja u bë shafran. -Mos e humb toruan fare, - tha Aliu. Di unë se ç›u bëj këtyre qafirëve. -Do na marrësh në qafë, Ali!- lëshoi kujën e shoqja. - Esma, - foli Aliu, - ata janë tre dhe, po t›u iki (se u iki kollaj), kam hallin tënd. Ndaj mos e prish terezinë dhe bëj si të të them unë. Sakaq , epo trimi e bën beli dhe kur bashkohet trimëria me zgjuarsinë, atëherë fundi po do jetë i bukur. Dhe që thuaj , zotrote që nuk po thuaj gjë hiç, dha ballë para shtëpisë, i paarmatosur, dhe u foli turqisht atyre të koshadhes. Seç u tha, gjatë apo shkurt, epo kush e di, po ata që e kanë sjellë nderi ndër ne, thonë: - Bujrum! Bujrum! Me demek, mirëse erdhët! Ke parë sikur të qenë miq dhe mezi po i priste. Bilez, për t›u dhënë besë drëgoi drejt tyre dhe Esmanë që, për të, i vinte zjarr gjithë Nahijes. Dhe ajo: - Bujrum! Bujrum! Ndoqën Esmanë dhe ay karakolll aty në ballkon, i paarmatosur. Pa kur erdhën tek dera e konakut, po më t›u flet turqisht sikur të kish lindur andej. U dha mirëseardhjen dhe m›i uli shesh atje tek oda e miqëve dhe Esmasë i tha: - Nga një pulë të pjekur për kokë! Muhabeti vu dhe u thotë noksani: do bëjmë rrugë të gjatë, pa të hamë nja dy kafshata bukë. Ua shtroi mirë e mirë dhe rakia- ballë kazani e bëri punën e vet. Sakaq Aliu rrëmbeu nga muri llahutkën dhe ia filloi një kënge që aso kohe nuk kish turk që nuk e këndonte. Ky po zërin bilbil gjyzar, papo e këndonte dhe turqisht dhe «koshadhja» e harroi për ç›kish ardhur.

- Esma, - foli kaçaku, - shpëtuam. I «lidha» unë në vënd të më lidhnin ata. Sufra plot, mishi me përshesh dhe rakia që u shkoi

në kokë, pale ajo kënga që i bëri çakërrqejf, i bëri turqit suferinë.

- Aferim kaçak!-foli ai, më i madhi tyre. Çok gjyzel! Dhe si erdhën dhe ikën. Po sulltani priste haber dhe ia kthyen: «Ik e ik nëpër Zhapokikë».

Tani po, e sosa. Kaq e dita, kaq e thashë, merre kasabali se ta lashë. Ty po të vjen tromobili, unë po tutje nga pylli. E falnderova dhe me që, «ma la», unë e solla për të mos humbur.

Tiranë, 16 korrik 2014

sikur, sapo të kish bërë një turp.

-Më vjen keq, Këtë do ta bënte kushdo. Ta zëmë sikur dhe një pulë të qe para makinës.

-Unë nuk kam si të ta shpërblej, këtë që bëre për mua. Dëgjo, - filloi të mbrohej ai, mos më bëj me turp. Se duket sikur më fyeni. Kushdo, kushdo kështu do të bënte.

Këto replika ata i shkëmbenin duke ecur, pothuaj, ngitur me njëri-tjetrin. -Më falni, - i tha aj, - po ne e humbëm fare. Po ecim bashkë dhe nuk u prezantuam me njëri-tjetrin. -Mua më quajnë Dhurata Kremenari! Mua; Adhurim. Adhurim Basha, - tregoi ai.

-Mos ma merrni për të keq. Po a kini kohë sa të pimë një kafe?- propozoi ai. -Posi jo, - pranoi ajo.

Zunë vënd në një cep të klubit dhe, atje ulur, filluan që të njihen dhe më imtësisht. -Jam nëpunëse në bankën e qytetit, e martuar me dy fëmijë të mitur (djalin 6-vjeç dhe çupën tri vjeç) dhe burrin e kam oficer në Divizionin e qytetit. -Kurse unë jam mësues në fshat, edhe imeshoqe mësuese; kemi dy fëmijë që, tanimë, ecin me këmbët e tyre: mbi 20 vjeç e ca. Kamariei u solli kafetë. -Gëzohem që u njohëm, - filloi ai urimin. -Gëzuar, e mbështeti ajo, po njohja jonë nuk mbaron me kaq: në darkë do t›i tregoj dhe Çimit dhe, me gjithë të, do vijmë në shtëpinë tuaj për t›ju falnderuar. -Mos e tepro, tani, - u mbrojt ai. Opo lëre atë muhabet, se e di vet unë. Kur u ndanë, ai ndjeu shtrëngimin shumë initim të asaj doreje kaq nazike, sa ai, sikur të mos ndruhej, do ta kish puthur tërë neps.

* * *

Një mbrëmje, tek hapi derën nga një e trokitur, Adhurimi pa Dhruatën me një oficer; nën kapën ushtarake, feksnin flokët e kuq dhe Adhurimi aty për aty, tek fuste mysafirët brënda, nuk ndënji pa medituar: gjynah që ky kuqo të hajë këtë mollë starkinge. Çifti po buzëqeshte dhe po me buzëqeshje, i ftoi i zoti i shtëpisë brënda. E shoqja, Leta, kur dëgjoi ftesën gjithë politesë të të shoqit (qe në kuzhinë duke larë pjatat), u stërzgjat për të parë mysafirët dhe,

RRËFIMET E NJË “MËKATARI”/1

Me Adhurim B..., unë njihem prej kohësh. Kur qeshë këtë verë në Shqipëri (qeshë larguar prej 10-vjetësh), e takova si shok të vjetër që e kam dhe zumë e u zhytëm në detin e kujtimeve si të qemë palombarë të vërtetë. Mes kujtimesh, siç ndodh mes miqësh, më thotë: -Dëgjo, ti më njeh mirë. Jam paksa”mëkatar” unë dhe dua që edhe të”rrëfehem”. “Qela” ku dua të rrëfehem je ti, se dhe të vjen paksa dorësh për të shkruar. Unë po të”rrëfehem” dhe ti trego. Po me një kusht: dua që dhe mishi të piqet, por dhe helli mos digjet. Pra, as emri im si “mëkatar” mos dal, po as dhe as emri i atyre me të cilat kam mëkatuar. Se dhe i kam dashur, por dhe më kanë dashur. Ore, - m’u lëshua tek rrëfehej, - e di ti që më duket sikur i dua prapë?!!! Ja, kjo qe biseda dhe unë”qela”po zë të rrëfej ato që ai i quan “mëkate”. Po të shihni, tregimit të parë, i kam vënë një numër. Nëse ky”mëkat” i parë, do pëlqehet nga lexuesi, unë dhe mund të vazhdoj. Ndryshe, të ma bëjnë hallall dhe leuesit dhe botuesit dhe, në nuk do vazhdoj, është veç pazotësia ime për të treguar dhe aq...

* * *

Ajo po ecte kokulur, pa u kujtuar për rrezikun. se, sakaq, një makinë desh e shtypi. Adhurimi, vrulltasi, si të qe diçka pa peshë, e kapi me të dy duarët dhe e tërhoqi drejt vetes.

-Të shtypi, - i tha. Dhe më fal që u tregova pak i «ashpër».

-Të faleminderit shumë, se, po të mos kishe qenë ti që ndërhyre, unë, tani, do kisha shkuar me të shumtit. Dhe qe skuqur flakë

"LENTE" PËR SYTË

(Sipas mikes sime, M. L.)

Pështjellim letrar

Nuk ka gjë që më “ngacmon” më shumë se sa sytë kur shoh një femër. Ky verb “ngacmon” duhet marrë pak me koificent korrigjimi: më sakt duhet të shprehesha kështu: “... djalërisë sime ndodhte kështu”. E humbja prej syve. Kështu ka ndodhur me mua në dashurinë e parë dhe kështu ka vazhduar deri sa sytë e mi “që mos i paça”, zënë e kërkojnë një palë sy. Tani sytë e mi e kanë humbur atë “sensin” e gjuetisë si puna e atij zagarit të vjetër që humbet nuhatjen, e, megjithatë, sa shoh një palë sy që të “verbojnë” lëshohem hergjele. Punë huqi, sigurisht. Se huqi del me shpirtin. Por këtë “pështjellim” nuk e shkruaj për vete. Jo. E shkruaj për një mjek (as mos prisni që mjekun ta lakoj me emër), që, ashtu si unë djalërisë së largët, e humbi nga një palë sy.

* * *

Mjeku i kish parë ata sy kalimthi dhe kish thënë me vete: - Kot thonë që është ngjallur veç Krishti! Se kjo që pashë (e kish fjalën për sytë e saj), a nuk i ka sytë aq të bukur si Elizabet Tejlorit? Të tillë i ka, - ngulmoi mjeku, - se o është ringjallur diva e madhe e Holliwood-it o nuk jam unë në vete! Dhe, ashtu mëdyshur në hamëndësinë e tij, mjeku kish ngrirë si një statujë mu tek dera e spitalit. Ai kish “ngrirë” dhe me sy ndiqte “Tejllorin” e ringjallur. Kur dëgjoi që kjo”Sytejllori” po pyeste për repartin e okulistikës,

mjeku “shkriu” siç shkrin dëbora nga dielli dhe nxitoi të bëhej ai “Ciceroni” apo siç thuhet në popull, kallauzi që t’i tregonte pavijonin e syve. Sado që nxitoi, u sëmbua kur një infermiere (si në ato garat” më i shkathti, më i shpejti” e ndihmoi “Tejllorin” që të gjente pavijonin që kërkonte. “Dhija mish e cjapi tavë”, - lëshoi një proverb kënaqësie mjeku i syve. Jam me fat, - përkëdheli veten. Kur qe në qejf, mjeku okulist, qe makazinë proverbash. Nuk kish nevojë të mendohej shumë. I thoshte ato jo ashtu «tymëse», por qenë si gozhdë trari të tilla që mund t›i ngulje pa frikë dhe në mur.

«Nuk shkoi Muhameti tek mali, por vjen mali tek Muhameti». Duke menduar se nuk kish se pse të hallakatej, ngjiti shkallët tërë shend dhe hyri në kabinetin e vet. «Tejllorin» e pa, por nuk duhet ta vinte re. Thëllëza do vinte vet: drejt e në kafaz. Për pak, gati t›ia merrte një kënge. Ashtu, në zë, si për vete, ia tha: « Syçkat si ato të tuat/ nuk gjenden në dynja». E dinte mirë se si vazhdonte kënga dhe, tek priste që «Tejlori» i ringjallur të hynte brenda, bëri si bëri dhe i tha dhe dy vargje të tjerë: «lum ai që i ka shijuar/ frikë nga vdekja më nuk ka...

* * *

Trokiti dera dhe hyri thëllëza. Mjeku që, tanimë, i «kish shijuar ata sy», u bë serioz dhe hyri në lëkurën e profesionit.

- Përse jini munduar?

- Për sytë. Ndjej dhimbje, sidomos, kur lexoj, - u ankua pacientja.

Mjeku, pasi e kish ulur në poltronën e vizitave, filloi vizitën. Qëndroi për një kohë goxha të gjatë, duke u sjellë dhe risjellë, pranë atyre syve dhe, sikur veç këtë kishte për të vizituar tërë ditën mbarë, po e «ngiste makinën e memories» si «afolio» për të bërë një studim sa më preçiz.

Ajo, shtrirë si një pafajësi e bukur dhe e dlirë si dëbora në një majë mali ku nuk e arrin kush, dhe doktori që «vete e vjen» nëpër këtë dëborë virgjine. Si mbaroi këtë vizitë «made in maratonë», tha mjeku me vete, - filloi t›i shpjegonte pacientes.

-Jo, jo, - tha kapistra, - ke sharë kumprativën dhe unë propzoj që ta shpallim kulak.

Kooooooooooooooooooooolak, - brëtisnin kush më shumë e kush më pak. Una, pa e prishur terezinë, i them: - Më morët tokën dhe nuk më pyetët se me se do ushqejë kalamanët. -Ti nuk do kumprativën dhe nuk ka tokë për ty. Kolak dhe e ke pak. Dhashë e dhashë dhe, kur ky, kapistra, po lëshonte jargë nga goja, një të nxjerrë atë shkresën nga xhepi dhe ja njaca (zgjata). Shikoje pak këtë, – i thashë. E mori ai dhe tani mbi të ra “kolera”. Erdh e t’u bë si ato dardhat e mia që piqen aty fundkorriku. Nuk e donte veten. -Shokë, - iu drejtua turmës, - unë si kamunist bëj autokritik para shokut Nasi dhe i lutem të ma fal. Që sot e tutje, askush nuk ka të drejtë të shkelë mbi tokat e tij. Është urdhëri i kumandantit. Pa erdh e t’u bën si ata qetë kur i ha zegali: kush e kush të ikte më parë. “Kapistra” m’u afruati dhe më tha: - Më fal, o xha Nasi! Të të falë Zoti, - thashë. Dhe nuk ua pashë bojën më.

thotë: - Po ku je, more Nasi Meço dhe përse je munduar deri këtu? -Kumandat, të pastë Nasi sa malet, ka një hall të madh, pa erdhi Nasi. Po ja, o kumandant, më morën tokën ata të kumprativës dhe si do t'i ushqejë kalamanët una. Kam dëgjuar që kumprativa është me vullnet, ata tanët me kamzhik. Të keqen Nasi tyja, kumandant, bëmë derman Nasit.

- Dëgjo, - më tha, - kumprativa është e mirë dhe, po të më dëgjosh mua, duhet të futesh me vullnetin tënd atje. Nuk je bërë i ndirgjigjshëm, kanë bërë gabim që ta kanë marrë tokën. Do t'u themi atyre shokëve në Fier që ta kthejnë përsëri.

-Të rroshë sa malet, o kumandant, por një rixha të ka Nasi tyja: - Nëm një shkresë nga dora jote, se nuk më lënë rehat ata.

-Ik, pa merak, më tha.

-Aha, - ngula këmbë si mushka mbi urë una, - në nuk e ke hazër atë shkresën sot, pres Nasi aty tek lulishtja, se behar është dhe jam mësuar una të fle jashtë.

-Po jo, mor xha Nasi, -tha kumandanti dhe fët-fët seç firmosi, pa i tha atij zabtitit të vinte vulën dhe ma zgjati: - Ta gëzosh!- më tha. Ai tha: -Ta gëzosh! Unë vrap dhe i kap dorën, me demek që t'ia puth. -Aha, xha Nasi, iku ajo kohë e "puthjes së dorës", partia për popullin është dhe të mirën e tij do. Një të marrë shkresën, një të futur në xhep. E mbërtheva xhepin me gjëlpërë me kokë dhe me një frymë tek "Sata". Sa do nisej. Hipa, që thuaj ti, dhe qeshë bërë me krahë. Më këndohej gëzimi në sy. Kur mbrrita në shtëpi, dielli sa po thyhej, po ata, të "kumprativës" po mbillnin vreshtë mu tek ara ime. Zbrita dhe, tek po ngjitesha atje mbi xhade, pashë që kthyen kokën. Unë as punë e mbarë dhe as si jini, por isha mbi kalë, or tynjatjeta, dhe e zbraza pushkën: - Eh, Nasi Meço! Eh, Nasi Meço! Të erdhi e mira në derë! Po e punon tokën me ysmeqarë!!!! Ata një të lënë punën dhe u mblodhën. Dërguan dhe haber më tej. Erdhën"kokësit". Po dhe ai "kapistra" me ta. Dukej aty e kish limerin. Unë po sikur nuk i shihja. Mbledhur a çmbledhur, punë për ta.

- Ju kini nevojë për lente, - tha doktori.

- Për lente!- përsëriti pacientja.

- Janë të domosdoshme dhe mirë që kini ardhur me kohë.

- Doktor, - tha «Tejlori», po dua të di çmimin, se...

- Çmimi është i diskutueshëm, - tha doktori.

- Si i diskutueshëm?- ndërhyri pak e skuqur.

- Jemi vërtet privat, por, para së gjithash, jemi dhe njerëz. Edhe ne jetojmë në tokë.

* * *

Kur shkoi për së fundi, doktori i tha:

- Këtë «operacion mjekësor» e ke falur nga unë.

-Doktor, të lutem, mos më bëj që të skuqem.

- Jam unë që po skuqem, - pohoi doktori. Jam mahnitur nga sytë tuaj. Më mjafton që i pashë dhe ky» vizion» imi për sytë tuaj, është "haraçi" që do paguani. E zënë si në çarg nga ky pohim kaq i çiltër, «Tejllori» sikur po thyhej. Ai e kundronte si një fajtor pa faj dhe, për të qetuar veten, kujtoi ca vargje të një kënge «... epo mirë, atëherë puthmë/ pa marr leje fola unë». I kujtoj ai, po vallë a kish dëgjuar «Tejllori» për një këngë të tillë? Sa mirë do të qe!

- E mira pret, - u dha fund hamendësive kur u nda me sytë e «Tejllorit».

Tiranë, 3 korrik 2014

TEK SHEGA E MURATIT...

As që do i hyja këtij tregimi, po mos takoja Reshatin. Reshati është djali i Muratit që ka patur këtë shegën. Shega e Muratit nuk është s'e bënte kokrra të florinjta, por ka një histori që është zhvilluar atje. Reshati është djalë i ri dhe, kur lindi ai, Murati - ndjesë të ketë - i kish vënë sëpatën shegës. Ia kish vënë sëpatën, jo se nuk i donte pemët, por e kish nga inati që ia morën të tërë tokën dhe sidomos atë, selishtën ku pat mbirë dhe kjo shega. Mbiu, u rrit dhe, tek shkonte i zoti vjeshtës për të korrur misrin, mbushte trastën plot me kokrrat të kuqe flakë të shegës. Të shegës që vet mbiu, vet u rrit dhe vet u selit. Selishta qe goxha e madhe nja dy hektarë dhe Murati qe i kënaqur me prodhimet që merrte dhe, sa për shegën, thoshte: epo thelë përmbi bisht! Njom gojën dhe aq. Njom gojën dhe aq, por prapa vinte historia. Erdhi "komprativa" dhe nuk pyeti as për selishtë as për shegë dhe as për Murat! Dha e dha Murati të shpëtonte qoftë dhe një copë nga ajo tokë pjellore dhe, sidomos, atë ku qe shega, por, po të lanë për prift, bëhesh dhe dhespot. Shkurt, i lanë vetëm ç'kish aty rreth shtëpisë dhe Murati katandisi: Murat-aga me gisht në gojë. I morën selishtën, po nuk i morën dot inatin. Kur duan të njomin gojën me shegën time, - shfryu në inat e sipër, - dhe një të rrëmbyer sëpatën dhe e preu shegën deri në rrëzë. As degat nuk ia mori. I vërviti jashtë tokës së tij, sikur donte t'u thoshte jazëk atyre që i morën tokën. Kaq. Vërtet që e preu shegën, po blloku nuk e humbi emrin. Thoshte brigadieri: - Sot të gjithë forcat tek "Shega e Muratit" dhe frymën

sepetet dhe në xhadetë. Sa erdhi "Sata", fiu lart. Mbrrita në Tiranë dhe pyeta ku ishte Kumanda e Përgjithshme (në atë kohë ku është Universiteti sot). Veshur me opinga, trastën e leshit hedhur mbi supe e tujte (tutje) nga Kumanda. Sosa ashtu thyer pa thyer dreka. Ushtar me pushkë atje. Ju afruash ta pyesja. Qy as gëk dhe as mëk. U kujtuash: nuk flet ushtari në vendroje. Kur shoh një zabit. U lëshuash nga ai. I them se si e kam hallin. Më thotë qy: – Nuk është kumandanti aty. Po mirë, - ia prita, - pret Nasi kur të vij. Ja, tek kjo lulishtja do rri edhe natën. Behar hesapi. Të nesërmen, prapë: - Nuk është kumandanti. Aha, Nasi, mos e humb durimin se do jetë grackë qo. Të pasnesërmen, prapë ai, zabiti. – Xhaxha, mos prit kot se nuk është. Epo do pres, or ti zabit, se e kam kularin në grykë una. Kur shkova të nesërmen në mëngjes, pashë me këta sy "grackën". – Xhaxha, hajde, - më tha ai zabiti, se do të presë kumandanti. Hou, - i dhashë fuqi vetes, - zbardhi dita, zbardhi shpresa. Ai para, unë pas. Më futën në një zyrë dhe aty një zabit tjetër. – Ja, - më tha qy, - ky është kumandanti! Me demek, mbathja nga ke ardhur, se nuk ta kemi ngenë. Qy brënda u ngriti në këmbë dhe më tha: – Hë, xha Nasi, pse je munduar. Harrova të thosha: m'i kishin marrë të dhënat para se të vija tek qy, kumandanti. -Kam ardhur për tek kumandant Enveri, - thashë. -Po qy është Enveri!- më tha zabiti. Unë po frrap nga xhepi i palltos, nxjerr basuretin e kumandantit. Shiko basuretin, shiko përballë. Ahu, sa larg! Sa Fieri me Tiranën. Më hipi një inat si me ata që më morën arat dhe më t'iu lëshova që thuaj ti: – U bëre ti larash që të m'i ngjash atij burri që njëherë e ka bërë nëna!!! (Epo thuaj që nuk ka Zot, po deshe. Se Zoti m'i tha në vesh këto fjalë që thuaj ti, dhe ngeci karkaleci njimëni këtij zabitit. Mos u bëti dhe në fytyrë. Si e mori veten, më thotë: - Prit pak këtu. Nuk kaluan as dy minuta, kur më priu përpara dhe drejt e tek kumandanti. Qy po, - thashë. Tani nuk kam nevojë për basyretë. Thënë pa thënë këto fjalë, kur më afrohet kumandanti dhe, pasi më përfshin me të dy krahët (thoshe: e kish grirë malli për mua) më

-Po mundohu, - ndrëhyri i vrëjtur, qy, “ ardhësi”. Sa më tha, mundohu, unë “bam-bam” rraha dyshemenë me këmbë dhe flakë për flakë i them: – Ja u munduash, doli gjë. Lëmëni në hallin tim dhe mos më bini në qafë. Por “kapistra” qe dinak dhe ma ngriti çargun. Kur e pa që nuk dorëzohesha, më bëri një pyetje me spec. Spec nga ato përcëllaket që të helmojnë kur i hedh në poçen e fasuleve dhe jo kështu të gjalla siç po m’i vërviste ky laskanderi nga kasabaja.

- E do partinë ti, Nasi Meço? Nasi, Nasi, - i thashë vetes, - ruhu nga çargu se të gjeti hataja. U zushë ngusht që thuaj tija, por zbriti Zoti nga lartas dhe sikur më foli në vesh. Se Zoti, prandaj rri lart, shikon poshtë dhe të ndihmon. Qe zëri i tij që më foli dhe iu përgjigjësh: - Më do partia mua?!!! Sa u përjgigjësh kështu, ngeci, karkaleci. U përtyp si ai akrepi kur ha bishtin e tij, dhe, ashtu nëpër gojë, sa mezit e zbrazi: - Të do!

- Më do partia, pa dhe unë e dua dhe t’më lërë kështu si jam. Nuk e donte veten, por kësaj radhe, shpëtova. E, ore u gëzova una, por kot thonë” mos u gëzo para kohe”. Si sosën me të tjerët në fshat (s’mbeti këmbë ropi pa u futur), m’u lëshuan prapë. Shikonin arat e mia dhe prodhimet sikur ua bënin me sy. Pale baçja. Piqeshin pemët me radhë dhe goja lëng, or tunjatjeta. Sekush tha: - T’ia marrim me tokë e me baçe dhe le të ngrohet në diell. Epo “kolera” hapet kollaj. Sado shtëpinë në pyll, por “sulmuan” një ditë të bukur dhe hynë si në baçe të tyre. Dal. I shikoj. Mizëri. Si mizat e dheut mbi një lis të kalbur. E vendosëm, në asamble, - më thanë, - nga sot ç’qe e jotja, është e kumprativës. Në daç, hyr në daç ngordh aty, tek pylli. Me demek, me forcë. I sherrit po nuk kam qenë i zoti. Ama të kisha fuqi, atij të madhit të tyre do ia shpoja barkun me cfurk. Po ku përzihet “kolera” me cfurk?!! Ndënja sa ndënja dhe merrja në gjyq veten. Ç’të bëj e nga t’ia mbaj? Dhe vendosa: -Do t’i hip “Satës” (autobuzi i vetëm që vinte nga Tirana dhe anasjelltas në atë kohë) e drejt e tek kumandanti (Enver Hoxha). Trastën me bukë, tërvaçin e duhanit, rrobat e reja që kisha në

atje.

* * *

Pija kafe tek “Taiwani” dhe ja tek mbërriti Reshati. Ky ka qenë nxënësi im dhe ka kohë që nuk e kisha parë. Për Muratin dhe të shoqen e tij, Shaqen e di që kanë vdekur, po, kur u ul Reshati, u çudit që e pyeta për një fshatarin e tij, Puçen.

- Ore, - i thashë, - rron Puçja?

- Ka ca kohë që ka vdekur.

- Po ty ç’t’u kujtua?- më pyeti ai.

- M’u kujtua se më ka treguar një histori që ka ndodhur atje, tek ishtoka juaj, që quhet “Shega e Muratit”.

Aha, - bëri Reshati. Mos vallë që babai im e preu atë shegën? - Jo. Jo. Është fare ndryshe. Puçja nuk ma tregoi veç mua, por gjithë repartit në një ditë zbori.

Tani kureshtja e Reshatit u bë dhe më e madhe. Për ta bërë sa më intime bisedën me Reshatin, unë po e sjell për lexuesin në vetën e parë. Tani fillin e tregimit po ia lë Puçes. Pa filluar, dua të kini një përfytyrim pak më të përafërt për Puçen. Sillni para sysh, një burrë nga fshati. pak më të gjatë se një burrë mesatar, me një kasketë me strehë në kokë, dimër e behar, me dy faqe buçko, të kuqe flakë (si shega e Muratit kur piqej) që, aq buçko i kish , sa, po t›i bije njërës, shpejto e bjeri tjetrës se mund të pëllcasë. Këto faqe të shëndosha tregonin se qe një kooperativist i pavrarë nga puna. Një nga ata që punës i qëndronte me «krahëmarrje». Kur them punës, po Puçja dhe në zbor të njëjtin huq ka: me krahëmarrje! Edhe në zbor ne jemi civila. Puçja veshur me ca rroba doku si pangjyrë, nga koha, dhe, ndërsa në kokë ka atë kasketën me strehë, me dy duar mban, si për t›u «mbështetur», një shkop thane nja dy pëllëmbë më të gjatë se vet trupi i tij. «Vuaj» nga gjunjët, - qahet ai. Dhe është për t›u çuditur: ky që «vuan» nga gjunjët, e ka gojën brisk. Po ç›ta zgjas, do ta shihni vet më tej.

* * *

Çlodheshim në një varosh aty, mes pyllit, dhe zinim e tregonim

qyfyre. Sapo kishim bërë një «betejë» për të shpartalluar «armikun» dhe, si «fitimtarë», po trapisnim larg e larg me qyfyre, ku lakoheshin gratë. Emëruesi i përbashkët: gratë janë mëkatare dhe ne, burrat, engjëj!

Po mes nesh dolën dhe burra «sojlinj» që u dilnin grave në mbrojtje. Kur ky «pazar» po shitje fare lirë, tak dhe hyri në muhabet Puçja. Vrring ia bëri shkopit (medemek ky i duhej për «stërvitje») dhe mori fjalën:

- Aha, për gratë, ma paskeni muhabetin ju! Dëgjoni xhixhan ju. Se që t›i vëmë kokë muhabetit, nuk më duhet mua me gratë e botës. Kam atë timen unë dhe për të do ju tregoj.

- Ore, - ndërhyri një i moshuar, - ti ke gojë e të zëshë këtu emrin e tëshoqe që e nderon një fshat i tërë! Po Puçja, pa e prishur terezinë, tha:

- E, re, pepe, e! Po kalit ia di huqet, ai që i hipën sipër. Ai që e thirri «pepe», qe xhaxhai i Puçes. Dhe Puçja filloi...

Ardhshë ashtu, thyer pa thyer dielli, në shtëpi. Po prisja që të vinte ajo. Kur erdhi.

- Hë, erdhe!

- Erdha.

- Më bëj një kafe dhe një godë raki.

- Ç›kafe? Do iki se do thyejmë kapule misri, tani që u ngrys. Kështu na tha brigadieri.

- Ku do thyeni kapule misri?

- Tek Shega e Muratit!

- Jo. Nuk do shkosh. Është blogu i madh ku nuk e merr vesh i pari të dytin. Pastaj ai brigadieri është pusht dhe iu do natën për «atë punë»

- Mua më merr të keqen ai, bën atje ku gjen.

- Moj, e njoh mirë unë, po mos shko.

Eh, Puçe-aga, Puçe -aga (i thoshte për vete) do dhe ti, po nuk të lë brigadieri. Dhe për të na mbushur mendjen, shtoi: - Epo kot nuk tregojnë që i tha burri gruas për në shtrat dhe ajo paskësh

hajde, o Loni, brenda se pimë ndonjë sapllake dhall. – Jo, - më tha, - po nesër në tetë të sabahut të jesh tek zyrat e kumprativës. Aha, - thashë, me vete kaq e paçë. Më zuri dhe mua ajo "kolera" e Moskovit. Po ku e gjetën atë yrnek, xhanëm? Po gjënë e tokut, nuk e ha as qëni. Mezi prita sa të gdhihej, Jepja e merrja tërë natën e natës me veten time. Si do t'i shpëtojë atij "kulari". I rëndë, or ti, donte qafë bualli ai kular. U nisa heret se donja nja dy orë të sosja atje tek zyrat e kumprativës. I kishin vënë dhe emrin e atij "kumbarit" nga Moskovi: kumprativa "Lenin". Ah, që nuk i bie zjarri dhe ta shuajë me gjithë emër! Sosa. Po më prisnin. Thoshe ti, sikur u qe hapur barku për mua. Shoh kryetarin e kshillit, atë të kumprativës, sekretarin e partisë dhe një bot tjetër. Qy, siç duket, qe dhe më i madhi. Dukej që atje tej si Balashi im. Qy, Balashi im, ka atë baliskën në ballë, por dhe qy, boti, veshur kasabas-she, me kapistër (kollare) mbi këmishë dhe me kostum. Ata të fshatit, "kokësit": ja kështu si una, por në vënd të takies sime të bardhë, kishin kasketa me strehë. -Si u gdhitë?- pyeta Në vënd t'ma kthenin përgjigje, ky i kshillit i tha atij, qytetsit: -Ja qy është Nasi Meço. Me demek, sikur kisha vajtur tek "terziu" për të prerë rroba dhe qy të më merrte masën.

-Shoku Nasi, - tha kapistra, - të kemi thirrur që të bëhesh kumprativë! Unë po u hodhshë përpjetë, sikur erdhi dikush nga prapa dhe më shpoi me bodec.

-Aha, - iu përgjigjësh. Për këtë punë më kini munduar deri këtu. Jo. Jo. Është samar i rëndë qy për mua dhe nuk e mbaj dot.

-Siiiiiiiiiiiiiiiiiiiiiii?!- u hodh përpjetë tani "kapistra"

-Shiko, të keqen Nasi tyja, nuk jam una për kumprativë.

Se unë punën e kam me "hopa".

- Si me hopa? -pyeti kapistra.

-Ja: sot punoj. Nesër rri e shplodhem. Shullëhem në diell. Kështu ma keq qefti, de. Kumprativa, or mik, do punë tërnjë (çdo ditë). E Nasi tërnjë nuk punon dot. Kam një qerre me kalamaqër una dhe nuk i ushqej dot me kumprativën.

“KOLERA” NË FSHAT?!!!

Mendoj se nuk duhet të jini “lodhur” shumë me atë xha Nasin tek “Oha, Balash!”. Por dhe në jini lodhur, xha Nasi di se si t’u çlodhë. Kjo është një “çlodhje” pak e veçantë në llojin e saj, por, gjithësesi çlodhje është. … ra dhe në fshatin tënë “kolera”. Kolerë xha Nasi quan komprativën (kooperativën). Ra së pari në Krutje të Lushnjes. Epo kolera, kolerë është: bie në Lushnjë, por e sjell era dhe në Fier. Para se të vejë në Fier, ngre “mera” në fshat tonë. Viti 1947. Marr pa marr tokat nga ajo agrarja (reforma agrare), kur erdh murdallëku nga Moskovi. Me një dorë na i dhanë tokat, me dy duar na i përrlan. Kumprativë që thuaj ti. Të hashë bashkë në një çanak. Del nuk del çanaku, punëz e madhe. U bëti dhe fshati ynë kumprativë. U bëti s’u bëti, aq më bën mua. Unë shikoj terezinë time. Shtëpinë nga fshati e kam goxha larg. Hane, bir, kur i thonë. Por e bëja llogarinë pa pyetur për hyqymetin. Hyqymeti e zë leprin me qerre. Avash-avash, sa të bëhet shelegu dash, - thoshnjam unë, - kokat le të thyejnë ata të “çanakut”. Nuk u del atyre, mua më del e më tepron. Kështu, o shpyrti i Nasit, mendoja unë, por a të lë i ligu që të ngresh kasoqe (kasolle?). Punët, alla bereqaves Zotit, më shkonin birinxhi. Dorëzoja ç’i kisha shtetit dhe zot në punëzën time. E, ore, e! Kur i bën hesapet pa pyetur hanxhinë, mirë e ke terezinë. Kur ndjej një zë. O Nasi! O Nasi! Urdho përgjigjem dhe, sa dal nga dera, shoh kaçatorin. Aha, - thashë, - më kërkojnë në kshill, se për ç’tjetër erdhi qy. – Po

thënë: - Prit, të pyes brigadierin!!! Ne ia dhamë të qeshurit, po buçkalani vazhdoi. E shkurt muhabeti u nis, ashtu errur-pa errur për tek «Shega e Muratit!. U nis ajo, po dhe unë nuk e hëngra thatë: rrugë pa rrugë, mshehtas saj, andej ku do thyenin kapule. U afruash. E pashë timeshoqe që e hodhi kapulen para këmbëve. Hedh sytë përreth: xhin-xhan. Tjatra nga ajo larg sa ç›të thuash. Tinëz-tinëz, me çapalepri, një t› u afruar, or ti, dhe tak iu hodhësh lart. Iu hodhësh lart... , këtu ndaloi si për t›u mbushur me frymë, dhe, pa të keq, e zbrazi: - Ua jap me senet: gruaja e ndershme nuk brret që t›i hap nam vetes. Kështu që rashë më të «njomë». Ajo kapulen, unë «baulen». Mbarova «punë» dhe frymën, rrugë pa rrugë, e në shtëpi. Ne mënd e ndezëm pyllin me të qeshur, por «buçkalani» vazhdoi. E prita gruan sa të kthehej. Kur erdhi, epo aty jua kam llafin.

- Erdhe.
- Erdha.
- Nuk të thashë se do të «zërë» brigadieri.
- Të thashë që mua më merr të keqen.
- Po nuk t›u hodh sipër atje mbi kapule?
- Ato tregoja ndonjë tjetre ti, se me mua nuk të shkojnë. Dhe mezalla s›e lëshonte pe, sado ia tregova ato «ojnat» deri në një. Ja, kështu, i dha fund tregimit Puçja dhe, tek e mylli fjalën, tha: - Aha, për vete, nuk më mban barku: nuk besoj tek gruaja. Ju bëni si të doni?

Tani qe Reshati që u shkërmoq së qeshuri.

Tiranë, 16 qershor 2014

NJË IMAZH QË NUK DUA TË HARROJ…

Kujtimit të shkrimtarit të persekutuar, Dr. Astrt Delvina

Kur u emërova mësues në zonën e Libofshës (flitet për rrethin Fier), atje njoha për herë të parë Dr. Astrit Delvinën. Në Libofshë atë e kishin sjellë, pas një burgu (politik, sigurisht), se nuk kish se si që në prag të viteve ’60-të, kur numri i mjekëve numërohej me gishtat e duarëve, një mjek si Dr. Astiriti që qe diplomuar në Itali, të emërohej nja 15km larg Fierit. Natyrisht, ky emërim qe si një thelë përmbi bishtin, por në inversin e shtrëmbër të kësaj shprehjeje popullore. Pra, thënë më shkoqur qe një internim. Sado që tek ky emërim ish një”hije”, kushdo e dinte dhe e lexonte në vijë të drejtë. Por, nga ana tjetër, s’kam si mos vë në dukje faktin tjetër që askush nuk e hiqte veten sikur e njihte këtë të vërtetë kaq domethënëse. Edhe doktori nga ana e tij shërbente me qytetari dhe qe i gatshëm që t’u gjendej me dijet e tij cilësore të gjithë atre që kishin nevojë. Unë qeshë gati 10 km larg nga Libofsha dhe me doktorin shiheshim rrallë. Nuk kam qenë ndonjë i njohur i veçantë i tij dhe as ndonjë mik i tij intim. Kemi patur vetëm ato përshëndetjet që njiheshim dhe aq.

* * *

Unë nuk marrë përsipër mendimet e kolegëve të mi të

i dua një më një una. Vajçë të nesërmen që në sabah. Atje që të dy zabitët: i madhi dhe qy murtati i dardhave. Jo myrtat por sikur kish dalë nga varri. Verdhur si ato dardhëzat e mia që më flaku në blacë.
-Dëgjo, xha Nasi, - foli ai, i madhi: qy jo vetëm dëmin do ta shlyej, por dhe do të kërkoj falje.

-Mor të më tundi mua 350 lekët se nuk dua as t›i shoh surratin. As më lipset falja e tij. E bën veç nga frika. Nxori lekët. I numërova një për një dhe, kur i pashë që qenë tamam, i futa në kuletëzën time, falnderova të zabitiin e madh dhe ika.

Kur kthyer pa kthyer mirë në shtëpi, më vjen një shafer:
-Hë, më të lumtë, - më thotë. Na ke hequr një samar nga kurrizi. Qe zullumqar i madh.

E kishin hequr se zabiti i madh kur pa qëndrimin tim, duket xhëç nxuri. Epo mirë ia bëri. Nuk të bie në qafë. Ç’ke që më bie? Se vërtet sot më kafshon dhe nuk jam i zoti, por nesër s›dihet se si e paguan. Për një thelë, paguan një pelë. Si ky që për 5 qillo dardha la dhe punën.

* * *

Historitë me Xha Nasin janë të shumta. Ndoshta një herë tjetër do t›u tregoj për të. Sidoqoftë, unë e kujtoj me shumë mall. Kurrë nuk ma prishi qejfin dhe më duket se përsëri e shoh atje toka, buzë kënetës, duke ngarë tokën dhe tek unë vërvis atë gjylen time prej trazovaçi: - A u lodhe, o xha Nasi? Pres atë përgjigjen e përherëshme: - E, u lodha. Do vish të më çlodhësh?!!!

** kam rujatur të folurën e tij.*

Tiranë, 20 tetor 2013

di që zbresin për të pirë ujë nga rruga e gjatë. Zbresin dhe, sa shohin koshin plot, lëshohen me një frymë për të blerë. E shikojnë xha Nasin ashtu të shkurtër, gjasme si të «humbur», dhe hyjnë në pazar. -Me sa dardhat?

-Me 70 lekë?

-Bëmë dy kg.

Xha Nasi peshon dhe kur blerësi i zgjat dyzet lekë, xha Nasi ia pret:

-Evlat, nuk po ble kumbullore po dardha të Nasi Meços që s›i ka njeri në kaza të Fierit.

Tjetri «mbrohet», unë i mora për 17 lekë.

-Me aq shesë kumbulloret una. (Kumbullore xha Nasi u thotë domateve). Ai, tjetri thotë: - Po si shtrenjtë hesapi. Xha Nasi: - Teste- teste qo dynja: ca kumbulloret, ca gorrricat dhe ca dardhat. Nuk lëshon pe sikur aty të prishen të gjitha. Në tepron ndonjë kg, e çon në shtëpi, se dëm nuk vete.

I sherrit nuk ka qenë kurrë. Po i re në qafë, drejt e në hyqymet (në pushtet). Dhe nuk ndahet deri sa të vejë nderin në vënd. Kënaqet me atë masë dënimi që vë «hyqymeti», se vet nuk ka takat t'i dalë sherrit mbanë.

E di ç› më ndodhi? Erdhi një nga këta «zabitët» (e ka fjalën për oficerët) me motor. Siç bën terbiet shaferat e maqinave (të shkretët shafera bëhen grusht para tij) dhe më thotë: - Ç›janë këto çmime kaq të shtrenjta? Ku ke parë ti me 70 lekë një kg dardha? Dhe sikur t›i kisha vrarë të atin, ma mori koshin me dardha dhe ma vërviti mu në blacë (ferrë e madhe). Unë po as gëk as mëk. Sikur qeshë shafer. Epo qenit kur i vjen ngordhja vete e përmjerë mu tek dera e qishës. Unë kyç gjuhës. Drejt e në degëz të mbrëndëshme. Kërkoi të madhin e tyre. U them: - Kam një punë me «axhale». Më çuan tek ai zabiti i madh. I tregoi hallin. I them: - Po nuk më shleu dëmin, shkova dhe do i shkruaj dy gjisht letër kumandantit unë. (Fjala për Enver Hoxhën). Mirë, - më tha, - nesër në sahatin nëntë të mëngjesit të vish këtu. -Vjen Nasi , o poça. Ama paratë e dëmit

shkollës 7-vjeçare të Libofshës, por, ma do mëndja, që zor se ka patur dijeni ndonjëri prej tyre (me përjashtim të dy elbasanësve që jepnin mësim atëherë në atë shkollë), se Doktor Astriti qe dhe shkrimtar. Them kështu se në ato vite(1959-1960), atij i qe ndaluar që të shkruante. Dhe ndaj them që pak vetë e dinin. Kur them për ata, elbasanasit, e kam fjalën për dy Uranët: Uran Hastopallin dhe Uran Asllanin. I pari jepte gjuhë-letërsi dhe them do ketë këmbyer ndonjë muhabet me doktorin dhe tjetri, Uran Asllani, sado që qe profilizuar për shkencat, qe një erduit i vërtetë. Se qe i biri i intelektualit me zë, të ndjerit, Suad Asllanit. Uran Asllani mund të vinte me shpatulla për muri qoftë dhe për librat e lexuar, cilindo prej nesh në atë kohë. Tek shkruaj, dua të jem sa më racional dhe nuk dua që të krijohet ndonjë përfytyrimi i përçud për imazhin që më ka lënë i ndjeri, Dr, Astri Delvina.

* * *

Ka qenë ditë e shtunë (se vetëm pasditeve të të shtunës mund të shkoja në shtëpi se qeshë 25 km larg shtëpisë) dhe, pasi kisha bërë nja 10 km në këmbë. mbrrita në Libofshë. Kur hyra në të vetmin klub që kishte Libofsha asaj kohe, takova dhe doktorin. -Hë, -më tha, - do shkosh në shtëpi?-Po, - i thashë.

-Mirë, - më tha. Rrugën do ta bëjmë bashkë se dhe unë do vij për në Fier. -Aq më mirë, - doktor, se kush e bën gjithë atë rrugë vetëm.

Piva kafen dhe pasi lamë qendrën e fshatit, morëm të përpjetën e vështirë për tek Manastiri i Ardenicës. Rruga e makinave që ka mbi tridhejtë e ca vjet që është bërë, asi kohe nuk ekzistonte. Dhe e gjithë zona, ngjette të përpjetën e Mansatirit (e quaj kështu se ky objekt s'ka si nuk njihet nga shumica e shqiptarëve) dhe, mbasi mbrrin atje, tek kodra dominuese, merr, pastaj, një tatëpjetë thikë për të zbritur në Kolonjë. Dhe sa herë e bëja këtë rrugë me të përpjeta e të tatëpjeta, më vinte në mënd Nastradini, ky personazh pak internacional e butaforik, që kur ngjitej zë qeshte dhe kur zbriste, qante. Kur e pyesnin, shpjegohej: se pas të mirës kish të keqe dhe anasjelltas.

Mendoja kështu dhe ia thashë dhe doktorit. Ky qeshi me battutën time dhe , si i ditur që qe, bëri sikur e dëgjoi për herë të parë. Unë po harroja se po i tregoja arat babait. Unë riosh, 17-vjeçar dhe doktori qe gati 40 vjeç atëherë, por kish bërë goxha shkollë dhe kish parë dynja me sy. Po pse thonë që rrushi i papjekur nuk hahet. Sidoqoftë, e pashë që qe në qejf dhe më tha: -E di atë këngën dhe, papritur përgjigje nga unë, zuri të thoshte vargjet:

"Ma ngjisje përpjetën/…(unë, pa e lënë të vazhdonte) Porsi dhelpëri/

Ai: -Seç t'u duk këmisha

Unë: -Lëkurë gjarpëri.

Ore, qerrata, - më tha pa e mbajtur gëzimin, - po qenke esnaf. Aha, doktor, i thashë: -Këngët i dua shumë. Por Zoti më ka dënuar, nuk di të këndoj. Nga "inati" i përpij vargjet e këngëve, sidomos, ato popullore.

-Ashtu?!-pyeti si me habi ai. Por mjafton që i di dhe ua di vlerën. Dhe, mes udhëtarëve, siç jemi unë e ti, mjafton që të dish vargjet, se nuk ka se kush të shanë.

Kështu, për të mos e ndjerë këtë përpjetë, pa na sill dhe ndonjë tjetër.

Dhe fillova: "Në sokak të ngushtë/ku na solli era.

Doktori, tanimë çakërrqejf, ma priti: -S'më the kalimera/moj t'u mbilltë dera/. Është e bukur kënga e popullit, - më tha. E di, - shtoi, - populli përmjet këngësh bën apo shkruan historinë. Historinë me luftë dhe pa luftë. Se dhe këngët e luftës populli ynë i ka të bukura. Tash mua më erdhi gjahu në shteg dhe, për t'i dhënë të kuptonte se e dija "sekretin" që ai kishte shkruar që paraçlirimit dhe, për këto shkrime, kishte bërë dhe burg, tak dhe citova rreshtat e një kënge popullore që e kisha lexuar në ndonjë prej atyre shkrimeve të pragviteve '40-të. Dhe ia fillova:

"Vjen ushtria porsi bletë (pashë që ndaloi dhe u bë sy e veshë!)

e verë i sigurokam me këta krahë. Epo doli fjala... nuk del kot. Jo. Se njerëzia sytë i kanë në ballë. Pastaj, hesapi i tjetrit bëhet kollajaz fare dhe gjithmonë i terezitur. Hesap-qesim aq. Mirë, o mirë, hapur fjala, hapur fjala po merr vesh e tërë mëhalla. Por qo fjala, të keqen xha Nasi tyja, qe pak si me spec. Spec bërë nga ato piperkat me majucë dhe djegëse aq, sa po e kafshove pak, tërbove dhe more pyllin. Unë dëgjoja dhe, mësuar me fjalën që e ngiste gjatë e gjatë, prisja për atë «piperin» e fjalës që kish helmuar xha Nasin. Ai e shihte që e ndiqja me kërshëri (kënaqej, me siguri se e merrte si mbështetje nga ana ime) dhe ma zbrazi:

- Ore, a të kam thënë që borxh as mos merr dhe as mos jep? -Po, e mbështet unë.

Mirë, ore mirë, po më vjen mua një ditë qy Jani i Zarikut. E njeh apo jo?

Kur pa që i dhashë shënjë që e njihja, vazhdoi.

E, që thuaj ti, qerdhi. Epo mirëse erdhi. Se shtëpia edhe për mikun është. Aha, në shtëpinë e Janit s›kam vajtur una, po ja erdhi qy. Erdhi, Të ketë ardhur për muhabet? Po nuk jam i muhabetit una. Jo. Po hall do ketë, se kot nuk ka ardhur. Dhe më thotë:

- Nasi mua më duhen ca lekë hua!!!

I them: - Po kush të ka thënë ty, Jani, që Nasi ka para.

Nuk po fliste. Ja kështu si ti njiméni. Foli nuk foli, po hua kërkon dhe do përgjigje. Ty po ta kam thënë huqin tim që as jap dhe as marr borxh, una. Epo të tërë nuk ta dinë huqin, de. Dhe i them: - Të tha kush të tha, nuk ka rëndësi. Tani më digjo mua dhe, në të pyeçin dhe të tjerë, thuaju kështu: - Shumë lekë nuk kam una. Pak kam. Të jap pak, harrohen ato. Prandaj, o Jani i Zarikut shiko në tjetër vënd, se tek una gjete qishë (kishë) ku të falesh. Dhe iku që thuaj ti dhe më nuk vjen për borxh tek Nasi as edhe një. As i kam dhe as më ke. Dhe jemi birnxhi.

* * *

Pjekur dardhat e xha Nasit për merak. Unë ia di huqin. I ka nxjerë t›i shesë mu buzë xhadesë, tek çezma e Vajkanit. Pret « Satën» se e

Fier-Lushnje e anasjelltas, u zhbë, sa hap e mbyll sytë në vitet epasnëntëdhjetës dhe sot nuk gjen një shkop për be). Sado që pylli kish një shtrije prej 10 km, asnjë shtëpi nuk qe ndërtuar mbi të, veç shtëpisë së xha Nasit. Kish 6 fëmijë dhe aty, për reth shtëpisë, kish selitur një bahçe që nuk ia gjeje shoqen anë e kënd. Thoshte: u bëre me fëmijë, ke hedhur mbi kurriz atë kryqin e Krishtit. Qy (Krishti) vuante për të tjerët, ti për fëmijët. Nuk bëre kështu, je birbollan. Ke tokën, punoje. Gruja (nuk e thoshte gruaja) dhe toka, që the ti, duhen pluguar. Mbill, do korrësh. Gruja dhe toka janë si zjarri. Hidhi shkarpa, që të ndizen. Dhe qeshte. Po fëmija të do dhe bylmetin, por dhe frutat. Pemë. Ore pemë. Ke krahë të njomë, bëji ysmet tokës se t›i jep të tëra. Nuk ke nevojë të trokasësh nëpër botë, t›u bëftë xha Nasi tyja. Unë që thuaj ti, as jap dhe as marr borxh. Jam qy që jam. Të kam borxh dhe nuk ta kthej, hajde dhe hamë me gjithë lecka. Jo në më ke dhe nuk ma kthen, të hëngra. Epo sadaka nuk ka, de. Ndaj më bie bretku sa hap sy dielli dhe dersa perëndon. Se një krah jam unë. Detyrime, tatime që kam ndaj shetit, gërr. Se shteti është «trim»: të merr gjak në vetull. Po dhe hall nuk të qan, por as turp dhe as mëshirë nuk të ka. Vetëm të kërkon. Nëm atë që nuk më ke. Me demek, të kam dhënë tokën.

Harron se toka është e Perëndisë. Aha, nuk ka shtet që ka frikë nga Perëndia. Dëgjo, xha Nasin ti. Se dhe Perëndia është larg. Larg dhe lart. Shteti po është afër. Sa të vijë Perëndia, vajti xha Nasi me gjithë halle. Hë, ku e paçë fjalën? Hë, tek borxhi. Është i lig. More borxh: ke shitur shpyrtin. S›je më i lirë. E di pse ta them, që kur të rritesh t›i kesh si mësime nga unë, xha Nasi. Të thuash nesër: - Aha, ma ka thënë xha Nasi mua këtë. Epo fjala shton fjalën. Është si era fjala. Ore, ke parë ti që sikur bën këmbë dhe, pa sosur brenda, ka sosur fjala. Çu-çu këtu tek pylli ku jemi imëni, kur, sa të vesh në shtëpi, ka mbrritur. Ka veshë gardhi, - thonë. Por nuk thonë kot. Ja qenka hapur fjaja që unë, xha Nasi, paskam para. Se nuk reshperoj me njeri dhe zahiretë dimër

-Pse s'u bie, more Gjolekë?

Unë u bie, po s'kam fishekë…

Tash pashë që u përmallua dhe më tha: -Ore, ku e ke gjetur këtë këngë?

-Në një shkrim të Doktor Astrit Delvinës tek një revistë e asaj kohe që ma ka dhënë Efendi Yzeir Sallata. Një lot përmallimi iu varë ndër sytë dhe, pasi bëri pikiatë, ra për tokë. -Eh, - tha…

Kënga u pre. I thashë: -Më fal, në të lëndova. -Po, jo, more djalë, nuk më lëndove, por hoqe koren e një plage të herëshme. Dhe plagës, po i hoqe koren, zë dhe të dhëmb. Sakaq kishim mbrritur tek Manastiri dhe, si të lodhur që qemë, u ulëm nën hijen e selvive. Kur pranë nesh erdhi, siç duket roja i Manastirit. që na përshëndeti siç bëhet kudo atyre anëve. Doktori, siç duket, e njihte dhe pyeti: -Është Hirësia e tij aty?-Jo, -tha, - ka shkuar në Lushnje. Unë i them: -Po për një prift manastiri vete dhe thuaj "Hirësi!". -Dëgjo, - më tha, -ky nuk është si ata priftërinjtë që njeh ty. Ky. Imzot, Hirësia e Tij, Irenea Banushi, është një erudit si një institucion që duhet të kesh nderin sikur dhe njëherë të flasësh me të. Pa më thuaj, - më tha, - njeh ndonjë prift që të ketë karizmën e një fetari të veçantë. Njoh vetëm njërin, doktor. Papa Polizoii Ikonomin në Fier. Aq autoritar është që, sa e sheh, po qe ulur, do ngrihesh në këmbë. Dhe ka një portret prej burri të pashëm. Rrobën fetare e mban akull dhe mjekrra e bardhë, kur reflekton nga dielli, sikur të vretë sytë. Aq impozant është ky klerik, sa ne, myslimanët, themi: -Papë Alizoi!

Sikur, medemek, ky profit orthodoks është dhe yni.

Doktori qeshi me përshkrimin tim dhe, pastaj, më tha: -U lodhëm nga kjo malore e "egër". -U lodhëm, - e mbështeta dhe unë. Dhe mos kujto se ta di njeri, - tha doktori, - përveç nënës.

* * *

U ngritëm dhe morëm të tatëpjetën thikë për të dalë në xhade. Tatëpjetë, pothuaj, nuk thamë asnjë fjalë. Se nga lodhja,

këmbët sikur nuk zinin në tokë dhe, prapë m'u kujtua Nastradini. Dolëm në xhade dhe, për fat, hipëm në një karroceri të një makine nga ato të naftës. Atje u përziemë me punëtorët dhe nuk thamë dot asnjë fjalë. Unë zbrita në Mbrostar-Ura(4 km larg nga Fieri) dhe doktori vazhdoi rrugën për në Fier.

Dhe më, për çudi, nuk e takova dot. U transferova para tij nga zona e Libofshës dhe, siç mora vesh, pasi kisha ikur unë dhe atë e kishin transferuar në Levan.

Një ditë prej ditësh, kur unë kisha ikur ushtar-më duket në vitin 1967-mora vesh që doktorin e kishin arrestuar për së dyti. Akuza: për agjitacion e propagandë. Ashtu, gojë mbi gojë, thanë që i kishin gjetur dhe ca shkrime. Më erdhi shumë keq për mikun tim të dikrushëm. Kur erdhi demokracia, mora vesh që kish dalë nga burgu dhe lexova atëherë romanin e tij "Globi në rrjetë". Por, siç duket, shumica e shkrimeve të tij mbetën qelive apo në duarët e hetuesëve sharlatanë. Ca më keq do të jetë, që ato të kenë rënë në dorën e ndonjë plagjiati që, duke përfituar nga fakti se Dr. Astrit Delvina ka vdekur qysh në vitin 1990, dhe t'u bëj veprave të tij ndonjë"retushim" dhe të dalë sikur i ka shkruar vetë. Se janë çudira që nuk më çudisin këto. Aq më shumë më lind ky dyshim se burgun e dytë e paska bërë sipas dëshmisë të një shkrimtari mediokër që paska ngjitur shkallët drejt kupolës.

Sidoqoftë, miku im i asaj të përpjetme, ka mbetur në kujtesën time si një imazh i bukur. Për të mos u ndarë nga ky imazh, unë e solla për ju.

16 tetor 2011

- A u lodhe, o xha Nasi?! Dhe ai:

- Oha, Balash! Ndërsa qetë qëndronin, xha Nasi, dilte para qeve, ngulte çapzën e hostenit mu para qeve (shënjë që ata nuk duhet të lëviznin) dhe, si kthehej nga unë që prisja përgjigje, ma kthente:

-E, u lodhësh. Do vish të më çlodhësh?!!!

Kjo batutë kaq shpotitëse sikur ma mbushte shpirtin dhe harroja dhe lodhjen, por dhe urinë. Kthehesha nga shkolla dhe mend ia thërrisja për të ngrënë. Ikja dhe tek merrja atë maloren mbi xhade sikur ia merrja këngës. Përgjigja kaq hokatare e xha Nasit ishte si një bateri karikuese që gjeneronte motorin tim. Po mos kujtonte se kështu ndodhte vetëm një herë. Jo. Sa herë që xha Nasi punonte, e njëjta metodë «sulmi» nga unë dhe përsëri e njëjta përgjigje.

Xha Nasi! Ç›njeri babaxhan! Kurrë nuk u mërzit nga një rrush aguridh si unë. Përkundrazi, ma priste me shpoti sikur do më kthente diçka që ma kish borxh.

* * *

Po unë vallë për kaq gjë do shkruaj? Jo. Qëllimi im nuk është fare tek natyra ime prej trazovaçi, por dua që ta njihni pak më mirë këtë njeri babaxhan. Për të patur një ide për xha Nasin, ju them vetëm kaq: përfytyroni një burrë paksa të shkurtër, veshur me atë dokun e lirë të viteve ‹50-të, copë e zezë sigurisht, dhe veç kësaj dhe takien e bardhë të myzeqarit që nuk e hiqte nga koka. Qe paksa i zi nga ngjyra e lëkurës dhe unë që nuk njihja as kufi moshe, por as dhe turp, i them: - Ti, xha Nasi, je i zi! Dhe ai (sa babaxhan që qe!), në vend që të zëmërohej, ma priste:

- Të keqen xha Nasi tyja ke ngrënë fiq ti? Fiku i zi është më i ëmbël. Dhe shkrihej së qeshuri me mua duke më bërë një afrim prej prindi. Ja, i tillë qe. Goxha njeri. Goxha prind. Nuk para bëhej shumë me njerëzit. Shikonte punën e tij. Shtëpinë e kish mu në mes pyllit të Vajkanit (ky pyll shekullor me dhjetra e dhjetra hektarë me një shtrirje për t›u patur zili , mbi xhadenë

OHA, BALASH!...

Ja tek kthehem në vitet e adoleshencës unë, trazovaçi, që dy gurë nuk i lija tok. Sherri, po të ishte i fshehur, do ta shpikja se nuk e ndjeja veten rehat. Bëja goxha rrugë të gjatë (gati 10 km vetëm xhade) dhe, po t'i shtoje dhe nja dy km të mira në një terren të thyer gjysëm malor, e kuptoni vet se si ndihesha. Këto kilometra nuk i bëja për sport, por vazhdoja shkollën në qytet (qyteti kaq km larg qe nga fshati im) dhe një natyrë eksplozive si imja nuk mund të rrinte rehat. Ngacmoja ndonjë që kalonte xhadesë (zakonisht këta qenë fshatarë të panjohur) dhe, tek reflektoj sot për këto noksanllëqe të mia, çuditem se si asnjëherë nuk ndodhi që të më jepte ndonjë shuplakë (aq meritoja sa nuk ke se si i vjen anës) qoft dhe njëri prej kalimtarëve. Por kur marrë të shkruaj për këtë të kaluar të «lavdishme» timen, s›kam se si mos e veçoj njërin prej tyre. Këtij dhe ia kushtoj tregimin. Kjo batuta «Oha, Balash!» është e tij dhe unë, kur e dëgjoja nga goja e tij, sikur ngopesha duke e harruar fare atë 10 km xhade. Se atje, ku mbaronte xhadeja ime, (Fier- Lushnje dhe anasjelltas) e shihja atë që ngiste qetë duke mbjellë tek ara e tij. Tokën e kishte mu buzë kënetës (këneta e fshatit Mbrostar- Ura, e bonifikuar aty nga viti 1960) që ato vite nuk ish e bonifikuar. Jo vetëm që qe e pabonifikuar, por shpendët e egra e mbushnin plym kënetën e madhe prej qindra hektarësh që me ujërat e saj shtrihej gjer tek xhadeja. Aty e kishte një copë të madhe toke ky, xha Nasi, që unë e «sulmoja» me fjalët e mia prej trazovaçi:

NDJESË VEZIRIT!

"Ti Neim qe s'di këndim
Je ministër për arsim?!"

Fan Noli

Kur marrë të shkruaj për këtë tregim, më sillet para sysh një skenë ku Artisti i Popullit Luftar Paja, shkëmben batuta me kryetarin e tij. – S'më heq dot, o zoti kryetar! Ai: – Të heq! – Ëhë, nuk më heq dot! dhe gjithë ky shkëmbim batutash, përcillesh me idenë se sekretari (Luftari) qe analfabet dhe kryetari me gramë. Kur tak vjen urdhëri nga lart: analfabeti kryetar dhe ai me gramë, kryetari, sekretar. Dhe Luftari (kush më mirë se ai? !) : – Eh, të thashë? Aty tani dhe bëj si të të them. (të më falni në batuta s'është origjinale, po merreni si kontekst!). Salla shkërrmoqej me të qeshur dhe, natyrshëm, do qeshte me ketë paradoks. Ama i referohej kohës së Zogut. Dhe domosdo do qeshje. Se për të qeshur qe. Po vallë a shpëtuam nga këto paradokse ku i paafti të drejtonte të aftin në kohën e Enverit? Unë them se jo. Dhe për këtë kohë, të cilën e kam jetuar me gjithë larushinë e saj, edhe do të flas. E kam thënë edhe diku tjetër. Kurrë nuk flas për gjëra që nuk m'i ka parë syri apo dëgjuar veshi.

* * *

Idenë për dikë në është i aftë apo i paaftë, them që do ta kem rrekur kur mbarova të mesmen. Në shkollë të mesme, kur nuk më

mungonte gjykimi (natyrisht, në kufijtë e moshës. se ezhdërha nuk qeshë, de!) shikoja se sa të aftë ishin të gjithë mësuesët e mi; sa me përkushtim punonin që të gjithë. Dhe, natyrshëm, modelonin para nesh, nxënësve të tyre, vetëm dhunti pozitve pa bërë as pikën më të vogël të lëshimit. E filluam shkollën 5 klasa paralele dhe "bryma" ra mbi dy klasa me gati 80 nxënës.

Koloneli doli me mua. Kur shoh që reparti qe rreshtuar. Mbrriti dhe komandanti i repartit tonë dhe ky kolonel. Unë aty me ta.

Koloneli rus urdhëroi: -Tetar Borja pjerjod! (dil para rreshtit). E pashë qimeshëllirën që doli dhe u mat të shpjegohej me eprorin e tij.

Po koloneli rus nuk e zgjati shumë, shkoi dhe ia hoqi spaletat tetar Borjes se kish "rrahur" rreshterin shqiptar. Mua, sado lotët nuk më pushonin, po nuk kishte kënaqësi më të madhe, kur pashë tetar Borjen që ta hipnin në një xhips ushtarak dhe që athëherë nuk u pa më në reparrtin tonë. Unë e dëgjova me një fyrmë dhe ai më pyeti:

-Hë, a kam qenë disident unë?!

-Po, - i thashë, - gjithsesi ke qenë një "disident" i çuditshëm.

** Kujtimit të kolegut tim, Arqile Pambuku, që ka vjete që ka ndrruar jetë.*

Tiranë, 7 prill 2013

Jo, ky qimeshëllira qe i lig dhe lindur për poshtërsira. Kish vajtur para meje dhe, pasi kish hequr një nga llampat e radiollokatarit, më urdhëron mua:

- Serzhent Tello, gatov aparat!

Jep e merr unë që ta vë në punë aparatin, po hiç. Qimeshëllira mënd jargosej nga kënaqësia dhe, ndërsa mua inati më kish hipur në majë të hundës, ai tërë mllef, e zbrazi:

- Eto diversant !!! Medemek, atë llambushkën e gadishmërisë e kish marrë diversanti. Shtinte larg qimeshëllira. Ca se nuk e shihja dot me sy (tek lëpinte gjuhën nga kënaqësia), ca se po më vinte në lojë dhe më lakonte për mungesë vigjelence, po më t'ia lëshoi: fap-fap nja dy fllacka të forta, sa i lëshuan shkëndija sytë dhe tërë mllef, i them:

- Diversanti i sat-tëme! Ore qimeshëllira i mutit. Po unë jam rreshter, kurse ti je tetar, ore kokëbardhë nga Siberia. E bëra veprimin, i nxorra këto batare sharjesh nga goja, por i paramendova pasojat: më priste gjyqi ushtarak. Kisha qëlluar një specialist rus. Dhe, aty për aty (nuk priste puna më) vrapova në kuzhinë, gjeta një kokërr qepë. E zhvesha atë dhe i bëra të dy sytë. Lotët po më shkonin çurg dhe sytë dukeshin sikur isha ngritur i lemeritur. Si e pashë veten në pasqyrë, po me vrap shkova e trokita në derën e kolonelit rus. Trokita dhe nuk prita as da as na, po drejt e brënda. Koloneli u çudit që një nënoficer shiqptar vjen e trokit dhe hyn si i alarmuar në zyrë.

Papritur që t'më pyeste (e ku mirrja vesh nga rusishtja unë?!), fillova ashtu si duke qarë:

-Menja tetar Borja, bau-bau, pëllëmba menja! Bot … dhe çurg lotët.

-Shto? Shto? – u alarmua me të vërtet koloneli.

Dhe unë: Bau-bau (zija faqet me dorë dhe u bija me shuplakë), menja, tetar Borja. Lotët po vërgaj.

Koloneli erdhi dhe t'u nxi dhe, sakaq rroku telefonin dhe bisedoi me dikë. Unë aty: -Bau-bau, menja… lotët. .

NDAL TRI HERE?!

Tregim (përsiatje nga koha e ushtrisë)

Mikut tim, Sotiraq Ferro!

Ushtria! A nuk është ajo si njëmarrëzi e domosdoshme, siç thoshte Napoleoni. Populli, dikur, ushtrinë e ka quajtur si një shkollë ku, edhe në se nuk arsimoheshe, do të vije patjetër si tjetër njeri. Do ishe rritur pakësa. Ose më saktë: do ishe pjekur dhe burrëruar. Në kthehesh ashtu siç edhe kishe vajtur ushtar, atëhere, po populii, thoshte: -Këtij hiqi fillin, nuk nxurri në ushtri e si mund të bëhet rob më?!

Dhe, kur e ke kohën kështu me pashë siç e kam dhe unë, s'do mend do ta çosh kapistallin e kujtimeve edhe andej nga vitet e ushtrisë, të cilat, sado të ashpëra, prapë se prapë, të vijnë e të rrinë para sysh me të gjitha atributet e tyre. Në këtë mori kujtimesh, ka prej tyre që janë për t'u përshkruar dhe për t'u mbjatur mend. Se, në se unë që po shkruaj dhe shumë bashkëshokë të mi i kemi hequr në kurriz këto gjëra që sot të bëjnë edhe për të qeshur, por edhe për të qarë, ia vlejnë për t'i vënë një notë asaj ushtrisë sonë të vështirë e të rreptë që operoi herë me modelet jugosllave, herë me ato sovjetike dhe, së fundi, me ato kineze. Në këtë mozaik modelesh (njëri më i keq se tjetri) ajo që mund të mbahet si emërues i përbashkët, është që as më pak dhe as më shumë veç fakti që grada më e ulët (që fillonte me ushtarin) dhe deri në

shkallën më të lartë (komandantin e përgjithshëm: atëherë-Enveri "Inë"-dhe mandej shoku Ramiz e, fill pas tyre z... e Co), mvarësia ishte njësoj si e atij rajasë para agait. Domethënë, agai i merrte erzin rajasë dhe ky nuk kishte gojë të ankohej. E shkruar e zezë mbi të bardhë: -Zbato urdhërin dhe, mandej, dil në raport. Që po t'i vëshë kësaj thënie analogen në gjuhën e popullit, do të thoshte: -Vdis, pa ngjallu!

E di që gjithë kjo hyrje ime e gjatë do të mërzisë lexuesit, por e bëj sa për një sqarim të vogël.

* * *

Në një të ftohtë brisk të 14 dhjetorit 1964, 14 ushtarë të rinj, të sapomobilizuar, midis të cilëve qeshe dhe vete, nën komandën e një oficeri, na morën dhe na çuan nja dy km larg repartit, buzë detit. (ushtrinë e kam bërë në Shëngjin!). Aty, sado që të ftohtit të shponte kurrizin dhe ne po na dridhej buza, na urdhëruan që të zhvishemi lakuriq duke mbajtur vetëm të mbathurat në trup. Askush nuk bëzante. Kur oficeri urdhëroi: -E shihni atë anijen atje në det (mund të ishte pa frikë rreth 30m larg bregut) do shkoni atje dhe do shkarkoni drutë që janë mbi të. Se anija, -sqaroi oficeri, -ka mbetur ne cektinë dhe s'del dot në breg. Se drutë, -vazhdoi ai, -janë për repartin dhe për familjet e oficerëve. Dhe si prifti, kur thonë që kërceu nga belaja, u hodhëm në det. NJë nga një dhe, pastaj, sikur e vumë poshtë të ftohtit (a nuk thonë që e ftohta del me të ftohtë?) vazhduam të shkarkonim atë anije që, na dukej, se nuk do të mbaronte kurrë së shkarkuari, aq shumë qe ngarkuar. Sakaq dhe oficerin erdhi dhe e zevendësoi një oficer me gradë më të lartë. Qe major dhe siç i raportoi, ky tjetri, kish detyrën e komisarit. Komisari ish më usta se i pari. U ul mbi një pemë aty afër bregdetit dhe ndiqte punën tonë. Duhet thënë që nga të gjithë (qemë 14-veta, që të gjithë fierakë dhe, pothuaj, asnjë nuk qe të paktën, pa shkollë të mesme) unë dhe miku im, Sotiraq Ferro qemë më hileqarët e atij grupi të mundimshëm. Unë, sa herë dilja nga deti për në stere (tokë) , bëja si bëja dhe derdhesha

Dhe, papritur reagimin e tij, ia dhashë vrapit sa më hanin këmbët. Prapa më ndiqte brohorima e shokëve se inatin e tetarit vetëm e përfytyroja, se nuk e ktheja kokën prapa. Kur më pa që dhe unë ia dhashë të qeshurit, më tha: – Hë, u binde tani me "disidencën" time. Unë po qeshja me shpirt se u çlirova nga ndonjë dyshim me ngjyrime politike, pa kjo për të qeshur qe.

Por nuk mbaron këtu "disidenca" ime, -ndëryhri Rakoja. E di, – shpejtova unë, - pastaj tetari ta ka marrë shpirtin dhe ta ka nxjerrë "disidencën" nga hundët.

- Jo. Jo. Vërtet që më vuri postë jashtë radhe , muzikën e fsheha (sikur më kish humbur) dhe këtë "haraç" e pagova deri sa më dërguan në kurs për radiollokator.

* * *

Shkova në kurs dhe "shpëtova" nga tetari. Kursin për radiollokator na i bënte një tetar rus. Aso kohe (janë vitet '50-të) në repartet e mëdha kishte oficerë e nënoficerë rusë. Kursin e mbarova me rezultate të mira dhe u gradova rreshter. Shpëtova nga tetar Marku dhe çdo ditë kisha vëndin tim të punës në radiollokacion. I madhi i repartit tonë qe një kolonel dhe po një kolonel që dublonte atë qe rus. Mirëpo a e ke dëgjuar atë shprehjen ti që deles së zezë venë dhe i ngjiten rrodhet. Kështu ndodhi dhe me mua. Sado që qeshë graduar rreshter, kur vinte puna, duhet të rrija "sus" para atij tetarit që, ndryshe nga tetar Marku, ky qe rus. Qe ai specialisti që kish ardhur nga Rusia. Dhe mbahej apo nuk mbahej. Zakonisht, rusët, silleshin mirë, por ky, tetari "im", kish qëlluar njeri i keq. Donte si e si, për të na zënë në gabim. E quanin Boris. Një qimebardhë (qimeshllirë thoshin në mes tonë se qe punë me rrezik me rusët, shkoje si spata pa bisht) dhe aq i lig qe, sa hallall ta bëja tetar Markun, me atë të "metën e vogël nga pas. Epo do e hidhje vallen sipas muzikës së kohës. Tetar po komandant, or tunjatjeta. Kapelja nuk më rrinte mirë, por nuk ma mbante, or burazer. Kur një ditë nuk durova më. Shpërtheva.

Çfarë, - thashë unë, - dhe atij i the: – E ke sumën prapa.

lirë, i bija ndonjë avazi si me nostalgji nga jeta civile. Tetari më dëgjonte dhe nuk i pëlqente, sado që unë vetëm në kohë të lirë e përdorja. Dhe ja një ditë m'u afrua dhe më tha: – Shoku ushtar Raku pa ma jep njiat mue. Mendova se qe kurioz dhe ia zgjata. E mori në dorë, provoi t'i binte dhe, kur pa, që muzika lëshoi një zë çjerrës, e futi në xhep.

- Shoku tetar, - sulmova unë, është muzika ime dhe nuk është e repartit.

-Po veta jam komandant dhe kur po e gjykoj veta ta napi apo nuk ta napi.

Flokët m'u ngritën gjëmb, por, të them të drejtën nuk ma mbante. Me inat dhe fuqi nuk ia dilja dot. Dhe mendova që t'ia punoja. Si e si t'ia merrja muzikën time. I vura zëmrës një gur dhe një ditë, kur tetari qe në qejf, futa në punë "grackën" time. I them (rreth e përqark qenë ushtarët e tjerë) : – Vallaj, tetar Marku, i mirë je shumë veçse ke një të metë të vogël.

Ai u këndell (epo kush nuk këndellet që të jesh i mirë po të kesh vetëm një të metë. Dhe kjo- e meta- të jetë e vogël?!) dhe, ndërsa ma zgjati muzikën që më mbante peng, më tha: – Aman, shoku Raku, ma thuej çfarë të mete kam?

-Nuk ta them dot, - ngulmoja si më kot unë.

-Aman, bre, ma thuej se due me e përmirësue, hej ?!

-Jo, shoku tetar, nuk mundem.

Ushtarët sy e veshë se cila do qe ajo e meta (dhe, patjetër, e vogël) që kish tetar Marku që e paskam vërejtur unë dhe ata nuk e dinin. Tetari vdiq duke m'u lutur, por unë kisha vendosur t'ia bëja shpirtin derr. Edhe shokët për rreth zunë të mbajnë anën e tetarit:

-Po thuaja, o Rako, se na plase.

-Po të lutna shoku Raku, po mos më korit, he, burrë!- bëhesh dysh tetari.

Unë si u largova aq sa më hante syri nga ndonjë rrezik i beftë (se çfarë nuk prisje nga ia lloj?!), më së fundi, i them:

- I mirë shumë je shoku tetar Marku, por e ke sumën prapa !!!

tutje pas shkurresh, gjoja, isha keq me urinën. Por komisarit që nuk i shpëtonte gjë nga sytë më thirri në raport:

-Nga je ti, mik vëllai? Unë: -Nga Fieri. -Më thuaj pak emrin dhe mbiemrin. Ia thashë. Ai: -Po të pyes për origjinën se sikur s'më duket për nga Fieri mbiemëri yt. Unë, duke pasur jo pak oficerë "Hys", i them si me krenari: -Prindërit e mi janë nga Skrapari! Ai: -Ja, kështu mik vëllai, kam unë një mik nga ata Hysët e Skraparit që thotë: -S'kalohet viti duke bërë shurrën, po shtroju punës. . . Domethënë, qeshë qarë kot nga ai oficeri i ri, ky i vjetëri (kot nuk qe komisar) na i bëri kurrizin vrimë. E, çfarë t'ju them? E shtrova kurrizin, po anija si ai karakolli që të trembë me atë lartësinë etij dhe ajo, me atë ngarkesën e saj, i ngjante një "gogoli"që kish hapur gojën për të na ngrënë. . Dreka kaloi dhe ne, sikur të mos kish ardhur i gjithë reparti në ndihmë, dhe sot do të ishim duke shkarkuar atë anijen që kish mbetur në cektinë. Në perëndim të diellit, me ndihmën e të porsaardhurve, i dhamë fund atij kalvari të mundimshëm. Pa bukë, të lodhur, të ndërmuar, të mbërdhiur nga ai i ftohtë thikë dhe, si llafazan që jam dhe nga që më kish ardhur në majë të hundës, iu lëshova majorit (e, ku ta dija unë seç ishte ushtria?) : -Shoku major, -i them. -Ç'do? Ja, -i thashë jo pa shejtanllëk, dua të them këtë: Edhe unë kam një shok skarparli. E, po pastaj, -m'u kthye ai. Ai shoku im, që thuaj ti shoku major këndonte një këngë. -Ç'këngë? -u bë kurioz majori. Kënga thoshte, -vazhdova unë, -/O devish, o rondokop/drekë e darkë i ha tok/Ushtarët ia dhanë të qeshurit dhe majori i sëmbuar keqas, më tha: -Qenke llafazan i madh. E shikon atë trarun aty. Hidhe në kurriz dhe drejt e në repart. Domethënë, thelë përmbi bisht. Epo ç'vjellë goja, e paguan zverku. Ndërsa unë hodha trarin mbi kurriz (ju lutem a s'e gozhuduan Krishtin kështu? !) , shokët të gjithë ndonjë të ngjajshmin tim, por unë më të rëndin, zvarrë këmbët, nëpër rërë, e , si iu ngjitëm një maloreje që s'qe dhe aq e butë, sosëm në repart. Rrugës u them shokëve:

-Na paskan sjellë për të vdekur këtu. (dhe qenë të mirë të gjithë

ata se, sikur edhe njëri t'i thoshte komisarit këto fjalët e mija, e dije vetë ku përfundoje). Me shpirt në dhëmbë e çova trarin tek reparti dhe, sa mbrritëm në kuzhinë, Lefteri (kuzhinieri) hapi derën dhe ne u lëshuam të uritur drejt pjatave të supës që, ca se kishin që në ora dy mbi pjata, ca se të ftohtit e dhjetorit qe brisk, qe kthyer në një ngriçë si xhel. Po uria ha dhe dërasën dhe jo atë supë të ftohtë akull. Dhe, për çudi, kur Kristaqi (ndjesë i pastë shpirti se ka vdekur tanimë!) zuri t'i binte fizarmonikës, ne dy dhe nga dy, filluam të kërcejmë sipas ritmit dhe sakaq u them shokëve: -Qëpar ju gënjeva. Ju thashë që do vdesim. Shiko se ç'të vdekur po bëjmë dhe vazhdova kërcimin. Do të thoni ju: -Ore ç'na dërdëllis kokën me ato gjëra. Ku na rreh ne e ku të reh ty? ! Epo unë nuk vrapoj dot ndaj atyre temave fluturake si ato mitet e mashkullit, jo po orgazmat, jo po vagina (tema të nxehta këto domosdo) , po ja që pres me të vjetrën.

* * *

Dëgjoni, na shpjegonte oficeri instruktor, në vend roje pushkën e ke të mbushur, fishekun mos ia fut në gojë, dhe duhet ta ndalosh atë që të vjenë në vendroje, duke thirrur tri herë (me intervale: ndal! Ndal se do të qëlloj dhe kur ky (kushdo që të jetë) nuk ndalon, atëherë mbushe pushkën (vëri fishekun në gojë) . Mirë, o mirë, po qenkësh një ushtar që për karrierë, kish bërë emër për guxim. Ndërsa ti i thoshje"ndal", ky, birçja, vraponte drejt teje dhe, sakaq, të merrte pushkën nga dora. Dhe kish turpëruar nja 4-5 ushtarë dhe po përgatitej që, për këtë guxim dhe shkathësi njëherësh, ta pranonin në parti. Se qe nder i madh të pranoheshe në parti atë kohë, pse ta mohojmë. Ushtari i"guximshëm" kish fituar simpatinë e komandës dhe urrejtjen e ushtarëve. Sidomos dy malësorë nga Puka dhe një nga Mirëdita as që e shihnin dot me sy. Epo kur qenit i vjen ngordhja, -thonë, -vete e përmjerrë në derë të xhamisë. Roje një djalë nga Dibra (e kush ia mban mend emrin tani pas dyzet ekusur vjetësh?!) . Sedërli i madh, me një kokë sa një shpellë. As trazonte njeri, por as hante bodec. Se,

- më tha, - sado që imatë është kuadër nga të luftës, por unë jam "disident?!". Sa e filloi këtë bisedë, unë pak u "rrënqetha", se nuk më rrinte mirë samari. Jo vetëm nuk më rrinte mirë, po sikur po më vriste dhe po ma bënte kurrizin copë.

-Ore Rako, – e ndërpreva, - po ytatë veteran dhe ti disident, po lëre atë muhabet dhe kalo në "linjë". Me "linjë", mes nesh, ishte muhabeti për ato. Kur them ato, ju duhet të kuptoni se ose ishte fjala për ndonjë kolege, o për ndonjë që qe shfaqur ashtu, kalimthi.

Se të thuash të drejtën: koleget e bukura nuk mungonin në shkollën tonë dhe jo vetëm kaq: qoft Rakos (epo vet nuk e bëj hasha!) dhe qoft mua, na haheshin hudhrat. Dhe u çudita me këtë "disident" në tavolinën tonë. Nuk flas kot, nguli këmbë Rakoja. Ty ashtu të duket, po, kur të t'i rreshtoj faktet do bindesh.

Bobo, mendova, seç ka ndodhur me mikun tim dhe, ç'ka më trondiste dhe më keq, më lindi dyshimi i ndonjë provokimi dhe mpreha vigjelencën.

- Pa hë ta dëgjojmë njëherë këtë "disidencën" tënde, - lëshova pe unë, sado që pak i trëmbur qeshë.

-Unë e di që ti shpreson për ndonjë disedencë si andej matan (qe fjala për vëndet socialiste me të cilat kishim patur miqësi), por kjo "disidenca" ime është e tjetër lloji. Isha ushtar, andej nga Korça, – filloi ai të më tregojë, - dhe si komandant skuadre pata një tetar nga Veriu. Qe graduar si ushtar më i vjetër, por ke parë, e mbante veten si gjeneral. Mua po inati në majë të hundës, po ato të shkreta rregullore ta hanin shpirtin. Ky, Veriori, vërtet ta merrte shpirtin, po kur e hiqte veten si me edukatë. Kurrë nuk të thërriste me emër, pa i vënë atë nofkën: shoku. Shoku Raku (po kur s'më thoshte Rako, po Raku!) shkoni me qrue kartolla në kuzhinë. Shoku Raku këtu e shoku Raku atje, m'u bë si burrë i nënës. Doja ta vija poshtë e t'i hyja dorë me shqelma, po ku unë e ku ai. Qe si lis nga trupi. Ta çaje me sëpatë. Kisha një muzikë nga ato gjermanet. E kisha timen dhe, sa herë që kisha kohë të

“DISIDENTI” I ÇUDITSHËM

Me Rako Telon, si të thuash, kisha ngrënë një thes me kripë. Qëlloi që në nga dy nga emrimet e gushtit (gjithmonë në gusht deri mes viteve ’70-të bëhej kuadri në arsim) të punonim në të njëjtën shkollë dhe, me që dhe na pëlqente muhabeti, u bëmë miq. Rako Telo qe nja 5-vjet më i madh nga unë, por nuk qe aspak problem që mos na puqeshin urat. Edhe kur takoheshim në qytet (ai banonte në qytet se unë tërë jetës kam banuar në fshat), ne takoheshim në klub dhe, kur qëllonim të qemë të dy kokë për kokë, digjnim vajguri me hallet e botës. Shkurt: e vinim në lupën tonë gjithë botën dhe mikrobotën. Por, sado kokë më kokë dhe, pothuaj, intimë: vetëm biseda politike nuk bënim. Se, ndërsa ai, politikisht, qe si kulaçi mbi vezën e pashkës, unë, përkundrazi: isha me “plevitë” të rëndë.

Kështu që politikës i ruheshim ashtu siç i ruhet delja gërshërëve. Mua nuk ma mbante, ai qe mbroth: si me koracë dhe, kështu, atyre porblemeve u kish vënë kapak.

Por, për të qenë i ndershëm tek rrëfej, një gjë e kisha të qartë: Rako Telo kurrë nuk lakonte për keq emrin tim, qoft dhe në qoshka të fshehura. Ky qëndrim, ta merr mëndja, që ishte reciprok. Pra, nga kolegë, qemë bërë miq. Kur thoshte një miku im: – Me këto buzë që kemi, do puthemi ! Secili prej nesh kishte huqet e veta dhe, si të tillë, e kishim pranuar njëri- tjetrin.

* * *

Një ditë prej ditësh, më tregoi një histori që më gajasi. Dëgjo,

ndërsa emrin s’ia mbaj mend, po veprimet ia mbaj ama. E nxjerë para repartit të rreshtuar këtë dibranin komandanti (seç kish bërë, me demek!) dhe e bën me fjalë për ujë tëftohtë. Po fjalë të rënda, ama. Ai, atje, duro-duro para gati 50 ushtarëve, kur tak i kërcen ai delli i malësorit dhe më t’i përvishet oficerit: -Shoku toger kur nxehem una ia q. . . nënën babës sim dhe jo ty që nuk të kam gja fare dhe hajd ta mbaje. Por qe i shpejtë oficeri që si me këmbë të lepurit, u fsheh brenda kapanonit. E; pra, me shërbim ky dibrani qe. Por atij tjetrit, “trimit” duket i kish thirrur dikush lart. Dhe niset në “aksion”. Mendon sa, roja, t’më thotë”ndal” me të parën, unë i jam afruar me vrap dhe, sakaq, ia marr pushkën. Hesap pa pyetur hanxhinë. Dibrani ia kish vënë atë të shkretë në gojë dhe, kur ndjeu që dikush i afrohet, thotë ndal (sa për triherë) dhe hap zjarr. E vrau. Erdhën dhe e arrrestojnë. Betohet se i ka thënë ndal tri herë e ku të di unë, po nuk e besojnë. Kur vijnë dëshmitarët. Pukjani: -Për besë e fe, or ti, tri herë e kam ndi që i ka thanë “ndal! . E tjetri kështu. E tjetri, e tjetri. Shkurt: dibrani shpëtoi dhe e transferuan në një repart tjetër, larg nga rethi ynë (më duket në jug) .

* * *

Reparti ynë kishte gati mbi 100-ushtarë. Bënim jetë gazerme dhe, për të dalë deri në Shëngjin, që nuk ish jo qytet, por as sa një qytezë, duhet të kishe rezultate të larta në disiplinë dhe gjithë treguesit e tjerë që nuk qenë të pakta. Postën (letrat se rrallë mund të vinte gazetë, vetëm po të abonoheshe privatisht) për të gjithë repartin i tërhiqte një ushtar që punonte në zyrën sekrete te repartit. E them këtë abonimin se në Shëngjin vetëm unë qeshë abonuar në gazetën “Drita”. Ish kohë plazhi. Një shkrimtar nga Shkodra, kish ardhur për pushime dhe në postë kish marrë”Dritën”. I thoni ushtarit (natyrisht, s’më njihte) se e ka marrë shkirmtari X. . . (Ateherë ky, shkrimtari, kish botuar vetëm një libërth të vogël, por, me demek, qe “shkrimtar” dhe s’do t’i prishej ajka? !) . Po kur e gjeta (se laj -thaj vetëm një gazetë”Drita”kishte) më t’iu

përvesha dhe e bëra për ujë të ftohtë. -Pse, -i thashë, -qenke shkrimtar dhe marrke gazetën time/E të tjera që tani nuk i mbaj mend.) Ushtari qe komunist dhe, në aparencë, sillej shumë mirë me ne të tjerët. Mirëpo sikur u bë rrugë që shumë nga ne jo vetëm nuk po mirnim letra, por as edhe lekë nga shtëpia. Dhe qe çudi: që të gjithë ata që ankoheshin se nuk po merrnin letra, ky, ushtari i zyrës sekrete, i merrte, i qeraste dhe , ndonjëherë, u huante dhe lekë. Merri dhe, kur t'i kesh m'i jep. Epo, hë, pra, gjej të tillin të dytë. I thjeshtë po, i ëmbël dhe i shkueshëm që, lëmë o zot, dhe, veç kësaj, hiç fodull. Se të punoje në zyrë sekrete s'qe shaka. Ah, sikur të ishin komunistët kështu! Më thotë mua, Sotiraqi, (Sotiraq Ferro që po i kushtoj dhe tregimin) , dëgjo, unë do ta zë atë që na vjedh të gjithë ato letrat që kanë para brenda. -Si do ta zëshë? -pyeta dyshues unë. Ja se si do ta zë. Mori një qind lekësh dhe me mua si shoqërues, vajti tek klubi i vetëm e Shëngjinit dhe e bëri dhjetëshe. Domethënë, dhejtë dhjetëshe. Mori një zarf të hapur dhe me atë në dorë drejt e në postë, ku dhe vinin letrat tona. -Hava, -i thotë postieres, në këtë zarf unë po fut veç letrës sime, të sajuar kot, edhe këto dhjetë dhjetëshe. Tani unë po e mbyll, në prezencë të dyve, po i vë adresën time të marrësit dhe të dërguesit sikur po më vjen nga Fieri. Të lutem, – i tha Havasë, – tani vëri vulën që u bë hyrje. Ne dyshojmë se postieri (ushtari që merrte postën) na hap letrat dhe ato që kanë para, i gris, pasi merr ato. Ti, Hava, për mundimin, na këto dhe Raqi i zgjati një 50-lekësh, vetëm do t'më thuash që e mori letrën (bashkë me letrat e tjera ai, postieri ynë) . Dhe kështu edhe u bë. Ne shkuam në repart dhe prisnim se ç'do ndodhte me këtë grackë të ngritur nga një mëndje si e Raqit. Pas një ore, erdhi dhe postieri. Prit se mos Sotiraq Ferro të kishte ndonjë letër. JO, Jo. Hiç. Kur postieri i tha që nuk ke gjë dhe pa një dyshim në fytyrën e Raqit, i thotë: -More ç'ke kështu? PO të duhen lekë të jap Unë dhe kur të duash m'i jep. Epo hajde më gjej më ëngjëllor. Po nuk e dinte, ky djall i vockël që hiqej si ëngjell me gjithë atë tesere komunisti, se mendja e Sotirq

mbetin aktuale, ato fjalët që ka thënë bejtexhiu i madh popullor, Hasan Zyko Kamberi. Po vallë a do vijë ndonjë kohë kur njeriu, sidomos ai që jep drejtësi, të mos tundohet nga paraja e pistë?Unë shpresoj. Shpresoj... dhe besoj. Pasqyrat janë përpara: disa vënde të Europës Perëndimore dhe Amerika, pothuajëse, e kanë arritur. Dhëntë Zoti që dhe ne, në Shqipëri, ta arrijmë.

** vapemë- dhe gëlqeror që i hidhet bërsisë për ta ëmbëlsuar*
*** një karroqe me gjela- 5 kg flori.*

ngrënë në dy çahire, them që ka erë të keqe. Është e helmuar dhe të helmon. Të errë sytë dhe të humbë mëndjen. Se ti, or babaxhan, më je i ri dhe aq di. Tani dëgjomë deri në fund, që të ikësh i ngopur.

* * *

Të vimë prapë tek ky muhabeti me «kadinë». Këtë e mora vesh, - ithashë. Jo, jo. Nuk ke marrë vesh asgjë. Ti e di që në Malas unë kam miqtë e mi. Edhe këta të Kamberit i kam miq. Por njërin që ku nuk i shkon fjala, atë Muçon nga Muratajt, e kam mbi kokë e s›ka më. Ti e njeh se ke dajot atje. E pra, ngrihet ky, Muçoja nga Muratajt që kish krushqi me këta të Malasit(me derën e Kamberit) dhe më t›i shkon «kadiut» në shtëpi. E njihte Muçon «kadiu» se kish ngrënë një darkë me prefektin tek Muçoja. Kishin mbetur miq. Tek bën atë përshëndetjet e rastit, e hapi «torbën»Muçoja. «Kadiefendi», ithotë, kam ardhur për një hall. «Gjermani» qe sojëli në pritje. Po hë, o Muço-aga, i thotë, pa ta dëgjojmë atë hallin tënd. Kam ardhur për atë Kamber Malasin që dënove, me të drejtë zotrote me pushkatim, po sikur të sjellë një karroqe nga ato me gjel **, a ia shpëton jetën dot?Gjykatësi, u mëdysh pakësa, po foli shkoqur: qoftë e bërë «lajmësia». Dhe ndodhi ajo që të tregova pak më parë. Paraja, or të keqen xhaxhai ty, e kthen ujtë përpjetë. Unë që aso kohe nuk haja hiç bodec, mënd u hodha përpjetë. Ka ndodhur atëherë, -thashë, po sot, aha s›ka më kështu. Eli-zeli kështu ka qenë puna e parasë. Të dehë ajo qëne, të dehë, - tha xha Mevlani.

* * *

Në vënd të epilogut...

Kur e kujtoj këtë ngjarje krejt të vërtetë sot, s'kam si mos vë buzën në gaz dhe të kujtoj ato fjalë aq të çmuar të atij mikut tim të mirë, xha Mevlanit, për paranë. Vërtet që paraja të helmon. Të dehë pa pirë. Them kështu se edhe ata njerëzit e drejtësisë (përjashtime ka, si gurisht), janë pak a shumë si ai"kdiefendiu" që njoha krejt rastësisht, atje në një klub të qytetit B... Se edhe sot

Ferros ishte e tillë që, po të kish punuar në zbulim, sot do të kish qenë një nga ata që do përmendje me emër. Kish punuar në tregëti dhe puna e kish bërë të tillë që të parashihte rrezikun qoft edhe nga një ënjgëll. E denoncuam "ëngjëllin" në komandë, dëshmitar qeshë unë dhe Havaja dhe "ëngjëllin" që atë ditë e hoqën nga zyra sekrete dhe e përjashtuan nga partia. Qe koha që lirohej dhe nuk e di seç u bë me të.

Siç e shihni, këto janë vetëm ca pasazhe nga koha e ushtrisë sime që, gjithësesi, ka qenë jo vetëm e vështirë, por dhe një shkollë e vërtetë kalitjeje. Kur pashë, në vitet e tranzicionit, që pjessa derrmuese e djemëve që kishin moshë për ushtri, i shmangeshin asaj, s'do mend që nuk më vinte mirë. Se, në fund të fundit, ushtria është një marrëzi e domsodoshme, apo jo?

Po thuajeni fjalën tuaj, de! . . .

7 Korrik 2007

DERVISHI

Kish mbetur jetim dhe, thuaj, qe rritur rrugëve. Bukën e përditshme e nxirrte duke lypur. Por bënte kujdes që në një derë mos dukej dy herë se njerëzit ishin në hall, siç mendonte ai. Kishte dhe raste-dhe s'qenë të pakëta- që dhe mos i jepnin gjë, por kjo as e fyente dhe as e inatoste. Se dora e thatë, çfarë do të japë, në fund të fundit? ! Më tepër lypte fshatrave se jo vetëm që fshatarkat (se ato gjente në shtëpi, de!) ishin më bujare se qytetëset, por, veç kësaj, qyteti qe larg. Dhe në qytet, kur shkonte, duket sikur do të humbte.

Salltanetet as që i njihte dhe kënaqej me ç't'i jipnin. Falënderonte nga larg se, elbete, nikoqirja mund të qe e re dhe lypësi nuk kish nge dhe për avaze të tjera. Se mjaft që kish mospasjen, por dhe ato këmborë i duheshin! Ndryshe, krejt ndryshe ndodhte kur gjente ndonjë plakë në shtëpi. Me të jo vetëm shtrohej në muhabet, por nuk harronte kurrë që me shënjë mirësjelljeje t'i puthte dorën hëm kur mbrrinte, edhe kur largohej. Pak këtu dhe pak atje, ai e shtynte si e shtynte.

Një ditë (po shkelte për herë të parë në atë fshat) i hodhi sytë dhe pa një ndërtesë të madhe: më e lartë se të tjerat dhe veç fshatit, pranë një pylli. Ajo që i bëri përshtypje qe fakti se ndërtesa dukej qe qarkuar me një mur, një pjesë e të cilit dukej që larg. -Atje do shkoj, -vendosi. Kur u afrua tek ndërtesa që shihej nga larg, pa se jovetëm muri e kish qarkuar atë, por ngjitur me të qe dhe një pyll

është e mundur?-kërceva i çuditur unë. Ore, më tha miku, unë të them ujku e ti më thuaj ku është gjurma. Kam qenë këtu unë den baba den dhe i njoh mirë si «kadinë» dhe Kamberin. Kamberin e njihje, - shpejtova t›i thosha unë, - se ai u pushkatua. Kush u pushkatua?- ma ktheu pyetjen me pyetje. Kamberi, - iu -përgjigja. A nuk vrau atë botin dhe a nuk e dënoi ky, miku yt, «kadiefendiu», me pushkatim? Po prit, ore i uruar, se nuk kam mbaruar unë. Kamberi bëri diktimin dhe avokati (kadiu) shkoi në gjyqin që do i bëhej. Atje-dhe ky gjyq qe berihaj më i madh aso kohe në qytetin tonë, - avokati çuditi trupin gjykues me mbrojtjen që i bëri, atij që kish dënuar me pushkatim. Kur kryetari ri i gjyqit (kam qenë vet në sallë dhe e kam dëgjuar me këta veshë), i thotë këtij, të vjetrit, tani avokat: -Zoti avokat, si mund të mbroni një njeri që po ju vet, e dënuat me pushkatim?Ky, miku im, i ftohtë si është mermeri, iu përgjigj: -Zotëri kryetar, nuk është kurrë vonë, për të dhënë drejtësi me urti dhe me gjak të ftohtë. Duke qenë se e kisha studjuar me imtësi dosjen e të pandehurit, Kamber Malasi, pashë që i rrëmbyer nga një çast dobësie njerëzore, rashë në atë kurthin: po vrave, do të vritesh. Dhe dhashë atë dënim kapital. Dhe, pastaj, duke hapur ato»xhepat e ligjeve» që aq mirë i njihte, ky, miku im, «kadiefendiu», e bindi trupin gjykues, që Kamber Malasi, të dënohej me 25 vjet dhe jo me pushkatim. Kur je i dënuar me vjet, qoft dhe me burgim të përjetshëm, rron me shpresë se një ditë, për një arsye apo tjetër, do dalësh. Kështu ndodhi dhe me Kamber Malasin. Ndodhi që na u martua Mbreti(se u martua axhami, de! Këtu miku im ia dha të qeshurit) dhe bëri falje të madhe, Kur fësht na doli dhe Kamberi. Doli po ymrin e ka nga «kadiu», ama. Epo bravo i qoftë, -i thashë, po sikur nuk mban erë të mirë ky muhabet, sado që ti e ke mik, atë, «kadinë». S›mban erë të mirë, - përsëriti ai fjalët e mia, po pse paraja erë të mirë ka?Më sulmoi ai po me pyetje. Natyrisht, i thashë, që erë të mirë ka. Ishim mes viteve›60-të ku rrogat qenë fikse dhe vënd për allishverishe nuk kishte. Për ty, -ndërhyri, - ka erë të mirë, po për mua që kam

Kurrë nuk futesh në klub me njeri tjetër veç o me komandatin e xhadarmërisë(flas për kohën e Mbretërisë, domosdo), o me atë kryetarin e prefekturës a bashkisë. Me njeri tjetër, mezalla. Mirëpo aty nga viti 1935 në B... ndodhi një ngjarje e bujshme. Jo brënda në qytet, po në fshatrat për reth. Ti ke dëgjuar për fshatin Malas. Tunda kokën si shënjë pohuese. E, ja, atje, në Malas. Kamber Malasi, i biri Meçanit, qe pronar i madh dërstilash. Kish kamje. Kamje si trashgim, por merte dhe pak përpjekur, ky, Kamberi. Se paraja, ore nipçe, ka vërtet fuqi të çuditshme. Aq fuqi ka sa të dehë. Të merr mëndjen. Ashtu siç ta mer pija. E keqa është se paraja të dehë pa pirë. E, pse ta zgjat: Kamberi i ngopur me kamje, i kish hipur kalit pak së prapthi. Një e dy dhe e kish sherrin mu në majë të hundës. Dhe një ditë prej ditësh, kot së koti, tek u grind me fjalë me dikë, tak nxjerr kobure dhe e vret. Berihaj erdhi më përpara se të fshihej. Dhe, sakaq, or të keqen, niset zaptieja dhe na e bjen duarlidhur këtë Kamberin e Meçanit në xhandarmëri. As që e zgjatën shumë hesapin, po pas dy ditësh, i bëjn gjyqi. Kryetar i gjyqit, po ky, kadiefendiu», që ma pe sot. E ku të falte ai? I rrept si një gjerman (atje e kish bërë dhe shkollën, pa kish marrë dhe ato huqe) na i bën gjyqin ky. Epo thoshin poshtë e lart, se do dënohet lehtë, se ka florinj Kamberi i Meçanit nga Malasi. Gjyqi si gjyq. Kadi»gjermani» na i dënoi këtë Kamber me pushkatim. Mirë t›i bëhet, se kush ttha aty rreth: vrau, ta vrasin. Kokë për kokë. Me pushkatim, po sipas ligjit, kish të drejtë diktimi(ankesë), ky, Kamberi. S›e mbaj mënd sa kohë i lanë për këtë»diktimin», por ajo që bëri më shumë bujë në B..., qe kjo, tjetra. Pas një jave, ky, «gjermani», na kërkon dorëheqje si gjykatës (dorëheqja i kërkohej vetëm Mbretit!) dhe, ç'qe më e madhja, Mbreti ia pranon dorëheqjen dhe»kadiu» u bë avokat. Si ishte e mundur?Jepnin e merrnin njerëzia (se qyteti qe i vogël, de, jo sa është sot), por nuk i dilnin dot në kut. Kur ndodhi më e madhja: jo vetëm»kadiu»u bë avokat, po ka marrë të mbrojë vet Kamberin nga Malasi. Atë që ai e dënoi me pushkatim. Si

pa fund që, thuaj, se të lemeriste me drurët e dëndur e të lartë. Lypsit as që i duhej me pyllin. Trokiti tek porta hyrëse që, ndryshe nga shtëpitë e fshatit, ish me dy kanata. "Kam rënë në"gjah" të mirë", -mendoi me vete.

Trokiti. E ku dëgjohej e trokitura në këtë portë të madhe? ! Përsëriti të trokiturat edhe më të forta dhe, kur u bë gati, ta qëllonte me grusht, një kanatë e portës u hap, dhe u rrëfye një dervish. Njerëzit e "tarikatit" i njihte nga veshja dhe lypsi, sa e pa dervishin, bëri një temena. Dervishi: -Përse ke ardhur? Ke sjell gjë për teqenë apo do të takosh Babanë? Lypsi, zënë ngushtë nga këto pyetje, rrinte sikur kish bërë faj! Por kjo gjendje s'mund të vazhdonte, ndaj i tha:

-Dua ndonjë gjë për të ngrënë!

Dervishi: -Shtëpia e Zotit ka për të gjithë dhe, si i priu përpara, e çoi drejt e në kuzhinë. Atje i dhanë për të ngrënë dhe, kur mbaroi së ngrëni, dervishi e pyeti:

-Nuk ke njeri në shtëpi?

-Jo.

-Po të afërm a ke?

-Jo, jo. Jam i vetëm, asnjë të afërm nuk kam.

-Pa prit pak këtu, -i tha dervishi, -të vete t'i them Babait, se, ndoshta, të mbajmë këtu si çirak për të të bërë dervish. -Mirë, – pranoi lypësi.

-Ejvalla, nazar! -tha dervishi, pasi u përkul para Babait të teqesë. Babai, veshur me takëmet e Tarikatit që përfaqësonte, ulur mbi një shilte të trashë, nën hijen e një lisi, këmbët e zbathura i kish vënë mbi një jar ujë të ftohtë, se qe gusht e të piqej koka; mbi një palare të madhe ish një kokë e pjekur dashi, një faqore rakije dhe, veç tyre, ndonjë frut i stinës.

-Ejvalla, nazar, -përsëdyti dervishi.

-Çfarë ka ndodhur, evlat? -iu kthye me pyetje dervishit, Babai.

-Ka ardhur një lypës, njeri pa njeri, dhe thashë të të pyesë ndoshta e marrim çirak që ta bëjmë dervish.

-Visheni dhe ma sillni t'hu, -urdhëroi Babai.

-Shpëtove, lumëzi, – i tha dervishi lypësit. Por dëgjo: për çdo gjë që do të pyesë Babai, para se të flasësh, do t'i thuash"Ejvalla, nazar! -dëgjove? Kur të vesh, do t'i puthësh dorën dhe, kur të ikësh, po kështu. Tani hajde të çoj tek dervish Bektashi që të marrësh rrobet e Tarikatit tonë.

E veshi dhe, pasi priu përpara, ia paraqiti Babait. "Dervishi i ri" kaloi përmjet një bahçeje që të lezetoste shpirtin dhe më tutje pa një pyll që të lemeriste. Ndërkaq, arritën tek Babai. Babai, veshur me atë rrobën e bukur qendisur me fijëza të arta, me atë sarëkun në kokë , të bardhë me një jeshile të zënë, me mjekrrën e bardhë dëborë e të gjatë, dukej edhe më madhështor se sa qe dhe të dukej, për një çast, sikur, me të vërtetë, qe më afër zotit.

-Jetim je?

-Hejvalla, nazar, jetim jam.

-S'ke të afërm!

-Jo, asnjë. Mirë, more dervish Musai, ma ço tek dervish Bektashi, të marrë një kosore, një kazëm e një lopatë e ma sillni prapë këtu. Kështu dhe bënë. Kur u paraqit, për së dyti, lypësit sikur i erdhi goja dhe i tha:

-Ejvalla, nazar, sa bahçe e bukur kjo e teqesë!

Dhe Babai: -E bukur, e bukur, po ka qenë pyll si ky që më është këtu. Por një dervish si puna jote e ktheu në bahçe. Prandaj më fillo dhe ma pastro këtë pyllthin këtu se do ta zgjeroj bahçenë! "Dervishi i ri" sa s'kafshoi buzën nga e keqja! Të pastronte pyllin? ! Dhe kush? Ai që tërë jetën nuk kish zënë punë me dorë. . . Ah, o Baba, t'u bëftë mu në grykë! -mallkoi me vete lypësi. Të mbettë ndonjë copë nga ato që po ha, po ashtu shul e shul, e të shkosh mu në esfel! Po sa para bënin këto mallkime tani?

Filloi dhe, pas një ore, kullonte djersë. Të çlodhej, s'e linte syri prej zhgabonje i babait. Aq po lodhej sa i dukej se në këtë vapë xërr do pëllciste si ndonjë flluskë sapuni apo si ato gjinkallat e mjera që këndonin mbi trungjet e pemëve. Forcat po e linin dhe,

Qesha unë, kamarieri dhe më tej kush dëgjoi. Se këta pleqtë s›para pyesin për nome: edhe klubin e qujanë si në shtëpi. Bërtit në shtëpi, bërtit dhe në klub. Por në Shqipëri janë mësuar me këto «adete» dhe s›para e bën kush qejfin qeder. Ndërsa miku im i moshuar, e gjerbi»kafenë e bardhë», pashë që lëpiu buzën sikur do t›i vinte notën: qe apo jo nga ajo e Skraparit. E, - i thashë, -si duket? I kanë hedhur «vapemë»* siç bëje ti dikur atje, në fshat për ta ëmbëlsur bërsinë. Oh, - m›u përgjijg tërë qejf: shkoi e vate «vapema», po e mirë është sa të ngrohë gjakun. Duke u marrë me këto muhabete, pamë që në klub të hyjë, një i moshuar me «republikë», me kollare dhe veshur pak më»shik» se sa miku im. Ky, miku im, qe pak si skiç dhe nuk vuri re të porsaradhurin, po, kur ia rroku syu, dëgjova t›i thotë: -Urdhëro, «kadi efendi», urdhëro se e di se si është: si ato të asaj kohe. Ëhë, -tha i porsaradhuri, -shkoi e vdiq ajo kohë, Beqir-aga.

Natyrisht, unë u çudita me këto replika kaq të»ashpëra», se ishin pak shaka me zarar. Sa për mikun tim, e dija që krahët i kish të shëndoshë(djalin e kish prokuror të rrethit), por për këtë»kadi efendinë», nuk dija gë. Po si mund të dija, kur për vete qeshë mik dhe kalimthi aty. U ul dhe i afërmi im, tregoi se qeshë mik i tij, me profesion mësues dhe aq. Për mikun që u ul me ne, tha: ka qenë kryetar i gjykatës në atë kohën e Mbretërisë. Edhe ky, «kadiefendiu», piu veç»kafe të bardhë», nga ajo, e Skraparit. Vet, kadiu(kështu po e quaj), qe gjirokastirt dhe mbetur aty në qytetin B... Qe në pension dhe i biri(se një djalë paskësh), kish qenë lidhur me partinë, dhe , si i ati, mbas lufte, u gë gjykatës. Kot nuk thonë që pema nën pemë bie. Nuk qëndruam shumë tek klubi dhe u ndamë dhe me «kadi efendinë».

Kur sosëm në shtëpinë e mikut tim, i them: -Ore xha Mevlan, more po ç›m›i kishit ato hidh e prit: jo kadi efendi, jo Beqir-aga. Ëhë, dhe, tek qeshte, miku im zuri të rrëfehet:

Me «kadiefendinë» a gjykatësin kemi njohje të moçme. Atëherë kish bërë emër jo vetëm si njohës i mirë i ligjeve, por dhe i rrept.

GJYKATËSI

"Kadiut, po t'i ftesh paranë,
Ters e vërtit sherjanë..."
Hasan Zyko Kamberi

Këtë ngjarje që sot po e sjell për ju, e mësova krejt rastësisht. Sado që ndodhia është e kohës së Mbretërisë së Zogut I-rë, unë, me që të dy aktorët e kësaj ndodhie i njoha po, rastësisht, pata një mbresë që nuk mund ta mbaj vetëm për vete. Aq më tepër që në qendër të ndodhisë është një gjykatës, po e sjell pa bërë as analogji dhe as përgjithësim. Veç për një gjë çuditem: fjalët që ka thënë një nga bejtexhinjtë më popullor për drejtësinë, edhe sot pas dyqind e ca vjetësh, sikur e ruajnë aktualitetin. Pse është kështu, ndaj dhe po e sjell.

* * *

Kisha shkuar për një vizitë tek disa të afërm në qytetin B... I zoti i shtëpisë, i moshuar aso kohe, më priu për tek turizmi i qytetit. Mua për një ekspres dhe ai, si qejfli, i kafesë së «bardhë». Hymë dhe ndërsa unë poprisja ekspresin, kamarieri, duke ia ditur «huqet» te afërmit tim, ia solli atë kafenë e «bardhë». E ke nga ajo, e Skraparit, -i tha. I afërmi im qe i njohur si nejri i shpotive dhe ia priti flakë për flakë kamarierit: -Dëgjo, or djali i babait, dy gjëra nuk duhet të ndërroj njeriu: pijen dhe gruan.

veç kësaj, dëgjoi zërin e Babait:

-More evlat, jepu duarëve se ashtu si e ke zënë as mot nuk e mbaron. Se dëgjo këtu: as Zoti nuk i do dembelët? ! Tani "Dervishi i ri" ish gati që t'i sulej me atë kosoren Babait dhe, pastaj, të ikte nga sytë këmbët. Nga shiu, ra në breshër.

Sakaq, që nga pylli po dëgjohej angullima rrënqethse e një qeni. Ulërima qe aq e madhe, sa "dervishit" nuk iu durua:

-Baba, -tha, -të vete të shoh se çfarë ka ai qeni?

-Shko, -e lejoi Babai, -po mos u vono se je mbrapa me punën.

U bë me krahë dhe gati fluturoi për në pyll. Pas ulërimës e gjeti kafshën dhe u çudit. I zoti i qenit, pasi e kish lidhur qenin pas një peme, i binte me myk të sopatës në kokë dhe në trup. Ndaj dhe qeni ulërinte.

-Pse e rreh qenin? -e pyeti "dervishi"

-Po e rrah, po s'po ngordh, se më hëngri bukën e drekës! -Si, or si? Mos e rrih, – i tha "dervishi", bjema mua t'ia çoj Babait të teqesë. E vë Babai që të qërojë pyllin dhe ngordh vet pastaj. . .

Gusht 1973 - Qershor 4, 2007

PROFESORI

(mësuesëve të mi në ish-Normalen e Elbasanit)

Unë s'e arrita profesorin për ë cilin duhet t'ju rrëfej, por ia vlen të shkruash për të. Kur unë qeshë nxënës në atë shkollë, në mes të viteve '50-të, profesori i nderuar kishte dalë në pension. Sidoqoftë, ngjarja për të cilën do t'ju tregoj, e lartëson atë. Dhe jo vetëm atë! Se ai ishte vetëm njëri nga ata mëSues aq të nderuar që, veç formimit të lartë kulturor, rrezatonin disiplinë, egzigjencë dhe, sa për tundim, thyerje nga ndjenjat sentimentale, as që i njihnin. Ishin sa të ashpër, aq dhe njerëzorë. Prej tyre nuk merrje vetëm dituri, por mësoje se si të rriteshe si njeri. Fomimi i tyre me kulturë perëndimore të vinte në ngasje dhe, doje s'doje, do ta hidhje"vallen" pas muzikës së tyre që, gjithësesi, qe një"muzikë" , me të vërtetë, e bukur.

Në po e lë pa emër profesorin, e kam bërë enkas. Për arsye subjektive dhe objektive. Por, pavarësisht kuturisjes sime, them që ia vlen që ta njihni dhe ju se çfarë ka bërë ai. Them ia vlen se-dhe kjo më shtyti të shkruaj- shihni se ç'ndodh me shkollën në Shqipëri dhe me arsimin në përgjithësi. Kur pashë që sado që ministria, për provimet, mobilizoi, gjasme mësuesët më të zgjedhur në Shqipëri, dhe, edhe me këta të zgjedhurit"ena eprovimeve" rrodhi, se pati nga këta të"zgjedhur" që u shitën badjava, atëherë m'u kujtua ky, profesori, dhe jo vetëm ky. Pra, figura e mësuesit

i bardhë i një bejtexhiu?!)

-Muçua mirë, po me gruan keq/s›e dëgjon Muçon pë dreq/-Hajde grua tek dysheku! -Prit o Muço Kokëdybeku/se nuk jam ajo, e para/Prit, Muço, kur të vijë radha?!!!E ka radhë birgadieri/Ik, o Muço brekëpërmjerri!!! -Se ta dish, të keqe xhixhai tyja, gratë e sotme e kanë»dy herë nga hendeku/njëherë nga dysheku/...

Sado që qe plakur dhe mrulur, bejtet i kish në majë të gjuhës. Ato, bejtet, qenë vet jeta e tij dhe ashtu dhe e ka sosur. Pra, jo duke folur, por duke «kënduar». Tani që po e mbyll këtë rrëfim timin, më vjen me të vërtet keq që po ndahem me të dhe bejtet e tij. Sa do më pëlqente që dhe njehrë të rikthehej dhe të fillonte nga bejtet e tij, që, mjerisht, unë i solla të «sakatuara, për ju. Nuk do më vinte keq fare, përkundrazi do ndjeja lehtësim sikur të dilte dikush që e ka njohur më mirë se sa unë dhe ta bënte të plotë portretin e tij të bukur të këtij bejtexhiu me zëmër të madhe. Se ai nuk kishte asnjë mik të veçantë, por qe mik i të gjithëve.

I paharruar qoft emri i Muço Kajës nga Gjonasi i Lushnjes.

23 tetor 2007

deri në Shkodër. Dhe dikush që e njihte mirë, e pyeti:

-Po në Shkodër? -Niset Muçua për në Shkodër/edhe sos me këngë e lodër... Sos? E thashë jangllësh!!!Sos një»punë» në Bahçallëk, se ndryshe më thonë: jazëk! -A

ke qenë në Elbasan? -Elbasan, o vuna dorën/Muçua po e tund këmborën/Elbasan me kumuria/lojti Muçua nga burgjia/Elbasania si venusi/a s›këndoi Usta Isufi. Sa Isufi, sa Budini/turru Muço nga Peqini/Në Peqin pazar i vogël/Muços i vjen mëndja rrotull/peqinasja me ferexhe dhe bën sikur s›më sheh/mua dy lopë më duken tre.

Një herë tjetër në Berat/Aty po: hoqa adhap! Vjen beratsja tak me sy/o Muço, oi-oi/epo kot nuk jam sojli/dhe i hip si kalëdori/sa i zbrita/tak më hipi/ç›e do, m›u këput «rripi»/dhe m›u sul t›më hajë me dhëmbë/po shyqyr që pata këmbë/se përndryshe Muçua vjati, veç nga çupa nga Berati...

-Po kur shkoje në Vlorë?-Fier-Vlorë për dy orë/del një vajzë ma bën me dorë/domethënë, a tund këmborë/mirë e tund, po ç›thotë vlonjati/mos kujto se është Berati?/I bën bisht ky Muço Shkreti, por ç› e do se e zu deti/dhe hëngri dhe kur s›deshi, për vlonjakun as që pyeti...

* * *

Natyrisht, bejtet janë, pothuaj, të «sakatuara»se unë aq i pëlqeja, sa i kisha mësuar përmëndësh. Se jo pak, po ky avvaz për çdo të martë për dy-tri vjet të mira.

Kisha vjete pa e parë, se, tanimë, po plakesha vet dhe pushteti i «popullit» i preu pazaret, duke i marrë bagëtitë, se, siç thoshte Iliçi nga kishim marrë «yrnekun», prona e vogël lind pronën e madhe dhe kështu shkohet në kapitlaizëm. Kishin kaluar gati 20-vjet pa e parë mikun tim, kur një mbasdite, prag viteve ‹80-të, e shoh xha Muçon. Ish plakur mjaft, por unë thashë pa ta provoj, i ka lënë bejtet a jo? Se fukarallëku ish ulur këmbëkryq në fshatra, se ndaj qe «kujdesur pushteti popullor». I afrohem dhe i them: -Ç›kemi, xha Muço, si ia çon me dynjallëk? Dhe ai (epo ku shteron shpirti

është përçudnuar dhe, thuajëse, e ka humbur vlerën. Unë kam punuar si mësues për 41-vjet dhe këtë "degradim" të figurës së mësuesit e përjetoj me keqardhje. Dhe them me plot gojën: -Jo. S'kanë qenë të tillë mësuesët. Ata kanë patur dinjitet dhe, nëse ky dinjitet i tyre u përdhos, shkaqet të çojnë larg. Larg e lart! Jo larg e lart për tek Zoti, por larg e lart tek qeveria. Tek shteti! Ky, pra, shteti e denigroi figurën e mësuesit dhe e detyroi atë që të shitet për 5-aspra! Sidoqoftë, në mes asaj armate mësuesësh, ka prej tyre që jetojnë me shpirt në dhëmbë, por dinjitetin nuk e shesin.

* * *

Mirë pra! Profesori i tregimit tim kishte nxënëse, veç tjerash, edhe çupën e të vëllait. Kjo (e mbesa) ca se nuk e honepste dot lëndën e tij (jepte fizikën) , ca se këtë lëndë e kish me xhaxhanë, as që ish kthyer nga fizika. Shkurt: nuk mësonte. Profesori, gjithmonë, sa herë e kish ngritur e kish vlerësuar me notën dysh (vlerësimi si notë maksimale kish 5-ën). Veç kësaj i kish tërhequr vëmendjen që të mësonte dhe mos kujtonte se ish e mbesa dhe do kish favore. I thosh ai, po çupa as e vinte ujtë në zjarr. Përfundimisht, e la për në vjeshtë dhe e porositi rrept. Në vjeshtë, kur pa, që cupa s'ish përgatitur, e la. -Do përsëritësh vitin, -i tha ai. E mbesa ia dha të qarit, se kurrë nuk e priste nga xhaxhai këtë mbetje në klasë. AsHtu, me lotë në sy, në vend të drejtohej nga shtëpia, e mbajti frymën nga Ura e Shkumbinit dhe, si la librin e fletoren mbi tokë, u vërvit në lumë. Atje janë gazermat e ushtrisë dhe një ushtar, tek ndjeu britmën për ndihmë (kontakti me ujët e kish kthielluar, siç duket) u hodh dhe e nxorri nga lumi. E çoi tek oficeri rojës dhe ky e shoqëroi për në Komandë të vendit (dega e mbrendshme më vonë) .

Komandati i vendit , një oficer me gradë të lartë, e mori në pyetje. Pasi e pyeti se pse i kish hyrë një aventure të tillë, vajza i tregoi shkakun dhe kur tha që profesori që e la, ishte as më shumë dhe as më pak, po xhaxhai i saj, u nxeh dhe dërgoi një polic që ta sillnin profesorin në fjalë urgjent aty. Shkoi polici, e gjeti dhe e

futi tek zyra ekomandantit.

Komandanti: -E njeh këtë çupën? Profesori: -Si nuk e njoh? Kjo është çupa e tim vëllai? ! -Mbesa jote, ë? Pa pyete se çfarë ka bërë ajo? Prof. -Se çfarë ka bërë unë nuk e di, por di që e mora në provim, nuk kish mësuar dhe e lashë! ! ! -Po ti, mor profesor, nuk i vije dot një tresh? Sa për të kaluar klasën, se nuk do bëhej ndonjë qamet i madh? ! Prof: -Jo. JO. Unë nuk kualifikoj dot njerëz të paditur. Se, dëgjo komandant, po deshe të rrëzosh një vend nga themelet, kualifiko njerëz të paditur. Se i padituri mund të bëhet doktor dhe merr më qafë njerëzit; mund të bëhet ingjinier dhe rrëzon ndërtesat, urat etj. Por mund (këtu duket profesori u nxeh) të bëhet dhe oficer dhe shkatërron ushtrinë. Komandanti duket u shkund nga mendësitë e tij dhe hyri në ato të profesorit, ndaj i tha vajzës: -Profesori e ka mirë. Ky vit iku, mëso këtë vit që fillon.

Ja, të tillë ishin ata! Punonin jo vetëm me përkushtim, por rrezatonin në plotninë e tyre. Dhe, kur vinte puna, në mjedise argëtimesh me ne, ata tjetërsoheshin dhe bëheshin aq intimë, sa të dukej se kishe përpara miq të vjetër e shumë, shumë të dashur. Shkruaj me superlativa për ta, se kanë qenë modele të papërsëritshëm dhe, për secilin prej tyre, mund të shkruaj faqe e faqe të tëra.

Dhe si epilog. . .

Ju thosha që në fillim se kam qenë nxënës i asaj shkolle në mes viteve'50 dhe më sakt: maturant në vtin 1959. Mësuesët tanë qenë të gjithë të mrekullueshëm: që nga ata që na jepnin lëndët kryesore dhe deri tek ata që na jepnin shkathtësitë (vizatim, pundore, muzikë fizkulturë) . Dhe mbi atë ansambël mësuesësh të mrrekullueshëm, të arsimuar që të gjithë në perëndim, s'mund që të mos veçoj drejtorin e shkollës, Vasil Kamani, që qe jo vetëm një pedagog i madh, por dhe një drejtues që ka dhënë një kontribut të veçantë. Nuk është vendi këtu për të folur për të, po ky tregim do të ishte, pakësa, i mangut sikur mos shtoja diçka nga jeta ime në këtë shkollë.

u grahte lopëve, nuk pushonte duke thënë bejte njëra pas tjetrës. Të dukej se sikur i nxirte bejtet nga xhepat e mëdha të potureve. Sa soste njërën, tak fillonte tjetrën dhe, kështu, deri sa arrinim në Fier, gati dy orë rrugë. Njerëzit, veç meje, e njihnin dhe fillonin ta gudulisnin. -Nga do shkosh, xha Muço? Dreqi ta hajë!harrova që t'ju njihja me të: E quanin Muço Kaja dhe qe nga Gjonasi, një fshat fare i vogël, aty ku ndanë kufiri i Fierit me Lushnjen. Sa e pyeti i pari : -Nga do vesh, xha Muço?

-Unë po shkoj sot nga Fieri/ku më pret buzësheqeri / buzëshqeri-trëndelinë/ prite-prite, Muço "zinë", se për ty, harron shtëpinë. Gjindja shkrehej së qeshuri, kurse unë që dëgjoja për herë të parë, mënd kakarisja si ajo pula shiqirake, kur lë furrikun. Se kish plot njerëz xhadesë se shkonin për pazar në Fier dhe pazari, aso kohe, bëhej të martave. Pra, ka qenë e martë kur e kam njohur xha Muçon. Dhe unë mezi prisja të martën tjetër. Duke parë se ç'bënin të tjerët, edhe unë sikur ia mora dorën këtyre"gudulive" për ta kurdisur xha Muçon. Qe njeri me shpirt të bardhë dhe nuk prishte qejf me njeri: i kujtdo moshe të ishte. -Po nesër ku do vesh, - e shpova pasi e kisha marrë atë urimin e parë. -Nesër unë do shkoj në Lushë dhe shikoj një syrrrush/unë i fal flori për gushë/edhe bëhemi gushë për gushë. –Po pasnesër?-Pasnesër, në Kavajë/kavajoten e përrlaj, se më kot nuk jam ustaj. -Pas Kavajës, shkoi në Durrës/në Durrës, një arrëgungëz/po ç'më ka, ç'më ka një gushëz/ka një gushëz, ka një sy/o Muço, pse s›vdes tani?

Dhe, pas Durrësit, në Tiranë. Në Tiranë kryeqytet/o Muço çfarë të gjetë/desh t›u bë kurrizi petë/qe një vajzë si sherbet/edhe dang , mua, isharet/ishareti më -pëlqeu, por ç›e do, se erdhi»beu»/edhe tak nxjerr kobure/desh më dhjeu mu në poture. Qe i çuditshëm. Nuk kish nevojë që ta ngacmoje shumë. Fillonte dhe nuk donte lutje.

* * *

Qe pajtuar si qeraxhi (njëllloj punëtori me mëditje) nga tregëtarët dhe këtë punë e bënte aq mirë, sa kish grahur bagëti

BEJTEXHIU

Ka ca njerëz, të rrallë domsodo, që e kanë më lehtë të flasin me vargje, se sa të bisedojnë siç bisedojnë të gjithë njerëzit në botë. Kur them të rrallë, janë si të lindur enkas me këtë predispozitë, si një lloj bekimi nga Zoti, se ndryshe nuk ke se si e shpjegon këtë mënyrë të "foluri" të tyre. Dhe, sa i njeh, jo vetëm që befasoshesh që të bëhen kaq intimë, por të vjen keq kur ndahesh prej tyre. Se, kur ndahesh, ndjen një boshësi dhe mëdyshesh se vallë a do t'i shohësh më. Le t'ju kujtoj për një çast veç njërin prej tyre: Babë Dudë Karbunara, rilindasi i madh ka qenë njëri prej tyre. Babë Duda që si një bjetexhi i lindur: edhe kur e torturpnin se përhapte mësimet e shqipes, u drejtohej xhelatëve, me bejte plot humor: -Bini, o djemtë e Skënderbeut, me shkopinjtë e mëmëdheut!

* * *

Dhe unë në tregimin tim do t'ju njoh me një bejtexhi të bukur, të cilin e kam njohur qysh ngga viti '50-të kur isha nxënës në klasën e pestë. Sapo dola në xhade, se vija në Fier, për të vazhduar klasën e pestë unike (9-vjeçarja e sotme), se nuk kishim shkollë unike në fshat, shoh një burrë, paksa të gjatë, që kish vënë përpara 5-6 lopë.

-Mirëmëngjes, xhaxha!-përshëndeta. -Mirëmëngjes, o trëndafil me vesë. Katër pula e gjeli pesë. Unë po ia dhashë të qeshurit, se nuk më kish ndodhur tjetër herë kështu. E pashë që qe me humor dhe, sado që isha i vogël, sa, po të donte ky xhaxhai, mund të më fuste në një xhep të potureve, se poture kish veshur, vura re se, tek

Drejtori i shkollës kish një autoritet absolut para nxënësve, po se po, por dhe ndaj mësuesëve. Sado që numri i nxënësve ishte tejet i madh, nuk ma merr mendja që të kishte nxënës t'i shpëtonte vëzhgimit të tij. Se nga mëngjesi deri në mbrëmje vonë e kalonte në shkollë apo në konvikt (ky ishte në të njëjtën ndërtesë me shkollë) . Duke ndjekur praktikën tonë pedagogjike, drejtori e kish pëlqyer punën time si praktikant (të më falin dhe lexuesët dhe bashkëshokët! Nuk vuaj nga kompleksi i Belul Gjeraqinës, por dua të jem sa më i sakt) dhe më thirri në drejtori, e më tha: -Hys (më thërriste në mbiemër) për gjithë shkurtin (1959) nuk do vesh në shkollë, se do bësh punën mësuesit në Ushtrimoren tonë se mësuese Manushaqja nuk do vijë në punë se është e sëmurë.

Kështu që unë u bëra mësues para kohe, por pa rrogë ama. Vetëm nuk shkoja në shkollë si maturantët e tjerë. Të them të drejtën-pse ta mohoj- sikur u përkëdhela në sedër nga ky vlerësim, se vlerësim ishte. Ndërsa shokët e mi bënin 6-orë mësim, unë bëja 4 dhe ndonjë ditë 5 orë. Mirë po kot nuk thonë se dardha e ka bishtin prapa. Dy ditë, pasi isha"bërë mësues", puplat m'u bënë krahë dhe mend po fluturoja! Nuk flitej me mua! Vjen në orën 4 të mëngjesit kujdestari i konviktit që të na bënte zgjimin dhe për të dalë në gjimnastikën e mëngjesit. Ndërsa të tjerët u ngritën, unë, "mësuesi", nuk u çova. -Çohu! -foli kujdestari. -Kush të çohet? Po unë jam mësues, s'e ke marrë vesh zotrote? -More për ç'mësues më flet? Do çohesh apo jo? -JO, nuk çohem. Do ikësh apo si e ke punën: Kaq ta mbësh dhëmbin, nuk çohem. Dhe nuk u çova. Kujdestari, priti sa vajti ora 7. 30 dhe frymën tek drejtori. Ai më thirri, më bëri për ujë të ftohtë dhe me autoritetin që i jepte rregullorja e shkollës, aty për aty, komunikoi para nxënësve: "Përparim Hysit i zbritet nota e sjelljes nga 5 në 4! "Unë, sa dëgjova këtë komunikim, u skuqa si kungull i pjekur në furrë dhe, në përlotje e sipër, para syve të drejtorit, u nisa për në klasën time, tek shokët. -Ku shkon? -më pyeti drejtori. -Në klasë, tek shokët, se tani nuk jam më mësues, se jam me notë të thyer në sjellje.

-Jo, -ma preu ai, do shkosh të japësh mësim për tërë shkurtin dhe dëgjo: në konvikt të sillesh mirë se dhe mund të përjashtojmë fare. Dhe shkova. Sado me sjellje katër. Pra, si mësues me sjelljen katër, jam pak unikal: Ndoshta i vetmi. Po ku të falnin ata? Sa herë kujtoj këtë sjelljen time të thyer, më kujtohet Ladenaku tek "Viti '93″ i Hygoit. A nuk e dekoroi ai topçinë për heroiznin dhe për pakujdesinë e pushkatoi? Ja, të tillë ishin! Të jepnin aq sa meritoje. As më pak dhe as më shumë. Nderim dhe vetëm nderim për atë armatë aq të nderuar

Nga një qiri për secilin prej tyre se, mjerisht, shumica kanë ikur nga kjo botë. Sa për ata që janë ende gjallë, unë, sado që tani jam plakur vet, secilin prej tyre që do takoja, do t'ia puthja ato duarët e rreshkura që , njëherësh, sa fisnike janë aq dhe të dashura. Dhe njëherë, nderim...

1999 - 25 maj 2007

fund armikun tënd, se, ku ta dish, një ditë mund të bëhet mik dhe mos ia beso të gjtiha të fshehtat miku, se, ku ta dish, një ditë të bëhet armik.

Sentenca, sidoqftë, është si një"antipastë" që i shkon asaj thirrjes së Njeriu të mirë, Uan Janos (Kakani) që bërtiste: "Dëgjoni, milet!" Një thirrje, që unë pa dashje, e zbardha plotësisht. Paqe mbi varrin e Njerit të mirë, Uani Jano (Kakani)! Amen! …

Nëntor 1974 - 24 prill 2007

futa “Berretën”. (Të gjitha shtëpitë ishin me kashtë). Nxitova për tek Ndrizka dhe, sa sosa, i thashë këtij: - O burra, të shkojmë tek Novruzi (skraparli tjetër ky)për darkë. Ky na priti krahëhapur dhe thirri dhe dy të tjerë për muahbet. Unë po muhabetin vu dhe ca mëshumë: disa herë ungrita në valle, se më digjte qerja dhe ashtu m’i donte mushka drutë. NË mëngjes mbrritën xhandarët me Mestanin në krye dhe dyshimi qe për mua. U ngritën një taborr me njerëz se qeshë me ta dhe shpëtova. Më tej, plasi kryengritja e Fierit më 1935, më arrestuan dhe Mestani nuk më la torturë pa bërë, po krimine Portëzës nuk ma zuri gojësh. Më dënuan me 20-vjet. Më torturuan çnjerëzisht dhe ndërsa plagët nga torurat m’u qelbën dhe po më ngangrenizoheshin, doktori i bashkisë, gjoja “kujdesej” më sillte një pomadë për t’u mjekuar. – Mos e përdor, më tha bashkëshoku i qelisë, një doktor italian. Mos epërdor. – më tha, – po deshe të mos vdesësh. Lartmadhëria, vërtet, më ka marrë lirinë, po profesionin nuk ma heq dot. Nuk e përdora dhe shpëtova. Kur dola nga burgu (pas një amistie) pak ditë në shtëpi, edhe në çetë (me Çetën E Skraparit) pastaj në brigadë VII dhe shkova deri në Vishegradë. Pas Çlirimit, u gradova major dhe shërbeja në MPMB. Një ditë kisha për detyrë të kontrolloja burgun e Tiranës. Shkova dhe drejtori u mat të më raportoj: Sa më tha: Raporton kapiten I Mestan…. menjëherë idhashë komandën “qetësohu” (e njoha, sa e pashë “mikun” tim të dikurshëm), e ftova për një kafe. Atje më tregoi se si ishte bashkuar me LuftënNÇL dhe, pas luftës, me që kishte përvojë e kishin caktuar me atë detyrë. Mez tjerash, i thashë: _More, xha Mestan, sç u bë një vrasje më 1933- dhe unë në Portëz ish athere- dhe nuk ummor veh kush e vrau atë çobanin. Dhe ai: - Dëgjo, shoku major, bëra aq vjet në Fier dhe i vetmi krim që nuk zbulova. Dhe unë: - E varava unë! ! ! – Ah, sikur ta kisha ditur, sot do të kishte një major më pak…Ja, kaq qe dhe tregimi i tij. Dhe unë, duke i bashkuar të dy ndodhitë në një, them: sa e çuditshem që është jeta! Ka raste që edhe armiqtë i bënë miq dhe anasjelltas! E kanë mirë arabët që thonë: - Mos e sha deri në

AS ME QEPË DHE AS ME HUDHËRA!

Kujtimit të Bacë Hasan Makës

Kisha vjete pa shkuar tek Bacë Hasani. Dikur një gardh na ndante me shtëpinë e tij dhe s’kish gëzim apo davet pa qenë tek njëri-tjetri. Kur them kështu, e kam fjalën për prindërit e mi, se unë, pothuaj, isha pakësa më i madh se Qemali, djali i madh, i Bacës. E quaj Bacë, se, kur zhvillohen ngjarjet e këtij tregimit tim, Bacë Hasani i kish kaluar të tetëdhjetat. Dhe në kisha vjete pa u parë me të, kjo ndodhte se ne kishim mbi 30-vjet që ishim larguar që aty, kurse Baca mbeti atje dhe, siç e shihni, sapo e takoj. Po kur do të thoni?!

* * *

Ka qenë pranverë e vitit 1989 kur shkova atje, tek ajo shtëpia e Bacës mbi një kodër dominuese në fshatin Petovë të Fierit.

Është një kodër, disi më e ulët se ajo ku është ngritur manastiri i Ardenicës(objekt shumë i njohur për një masë lexuesish) . Në po e përmend këtë, manastirin, e bëj jo pa shkak: nga shtëpia e Bacë Hasanit për tek manastiri në fjalë, po të ecësh mirë, do rreth 40-minuta, kurse nga kjo shtëpi për në Fier do të paktën nja tri-katër orë. E, ç’ta zgjat? Shkova i përmalluar dhe po me mall më priti Baca. Shtriu duarët e tij të gjata drejt meje dhe, tek më përqafi, më shtrëngoi fort sikur me këtë do t’më shprehte gjithë dashurinë etij. Se më ka dashur vërtet. Jo vetëm se u rrita aty,

si komshinj që qemë, po unë, veç të tjerave, sado që ne ikëm familjarisht nga Petova, punova për 25-vjet mësues aty, dhe, s'kish se si mos bëja vizita të pashershme në folenë e vjetër. Pra, shpesh shihesha me Bacën.

Por isha transferuar edhe si mësues, dhe, siç kuptohet, ndaj dhe takimi i kësaj pranvere qe me mbresa. Më futi në dhomën e zjarrit, ku digjesh për qejf një zjarr që ta donte shpirti, në këtë pranverë, pakëz, si të ftohtë. Aty, mbasi u ula, Baca, gjithmomë i kujdeshëm dhe i shquar për mikpritjen, më ofroi dy jastëk të mbushur me lesh për t'u mbështetur më mirë. Sa bëmë ato pyetjet e zakonshme, për shëndetin, për familjen, Baca tak dhe më zgjati kutinë e duhanit dhe, kur pa mosaprovimin tim, më tha:

-More, jaran, apo nuk je rritur ti? Prandaj edhe s'na mësojnë fëmijtë në shkollë, -shtoi duke qeshur, – se mësuesi është i vogël.

Dhe pasi e drodhi për qejf të vetë, e vendosi mbi cigarishten e gjatë, një cigarishte prej sërmi me filograma argjendi mbi të ku pjesa që vihej në gojë, qe prej qelibari. Cigarishtja tregonte për një terjaqi duhani dhe, pasi e tithi, sikur do të ngopej, tak dhe hapi televizorin. Në ekran tregoheshin pamje nga demonstratat paqësore në Kosovë. I shikoje pamjet dhe nuk kishe si mos alarmoheshe. Shantazhi mbi këta pjesëmarrës aq paqësor qe jo vetëm i llahtarshëm, por dhe i përgjakshëm. Goditnin pa mëshirë njerëz të moshave të ndryshme: burra, gra, pleq dhe ca më keq: dhe fëmijë. Baca, ca se ishe prej atyre anëve(kish ardhur familjarisht vet i katërt vëlla, dy nipoj të rritur dhe me një tabor fëmijë) ca dhe se i përjetonte ato goditje që s'ishin së pari, gati shpërtheu:

-Po shkjau, shkja asht dhe kështu ka me kan! Përnjime: mos kujton se ndryshojnë. Jo, lum miku, dinjo Bacalinë ti këtu, more jaran. Ani-ani, po ky magypi(e kish fjalën për RRahman Morinën, në atë kohë i plqyeri i Beogradit për Kosovën) nuk ka çajre pa pague haraç! Se, shiko lum miku, ka ca njerëz që nuk hahen as me qepë dhe as me hudra! -E, bash, nji aj, Rrahaman gabeli(endryshoi për mllef) ka me epague. Se kurrë asaj Kosovës

sytë etij zhbirues dhe dukej sikur më thoshte: - Skraparli, nuk ma hedh dot! Të kam nën vëzhgim dhe, po të mbërtheva, të piu e zeza. E kutpoja se ç'më thoshin sytë e tij, po bëja sytë katër se, kot nuk thonë: ruhu, të të ruaj! E mbaj mend mirë. Ka qenë perëndim dielli, në korrik. Sa lashë xhadenë, për t'u ngjitur në Portëz (harrova të të them: rrugën Portëz_Fier dhe anasjelltas e bëja me një biçikletë"Bianka") përmjet një rrugice të ngushtë, me biçikletë prej dore, kur shoh që m'u lëshua një qen- ujk çobanësh. Lashë biçikletën dhe, tek po matesha të gjeja ndonjë gur apo dru që të mbrohesha nga qeni, ndjeva që dikush më goditi mnë kurriz me aq forcë, sa m'u errën sytë. Tek rashë për tokë, mjegullueshëm vura re atë që më qëlloi: qe një dymetrosh, me shpatulla lisi që, po ta çaje dërrasa, me të shtorje dy dhoma të mira. Hoqi qeni dhe u zhduk. Mbasi e mora veten, fillova të arsyetoj: - Me siguri, – mendova, – është dora e Mestan Efendiut.

Në daltë prapë, nesër, kuptohet që e kam nga matjani. Zakonisht, sado firarshe, po mbaja një kobure "Berretë" me vete. Atë natë s'e pata. Të përleshesha me mikun trup më trup, e shihja që s'e haja dot. Efendi Mestani e kish bërë të mirë zgjedhjen. Shkova në shtëpinë e Ndrizkës dhe ç'më ndodhi as që e zura me gojë.

Të nesërmen "Berretën" në xhepin e fshehttë dhe frymën në Fier. Tek klubi ku pija ndonje teke çdo mëngjes dhe kafe, sikur me porosi, më priste xha Mestani (se i moçëm qe!). Përsëri m'i hodhi sytë etij prej zhgabonje dhe dukej sikur këtë herë më pyeste: - E, si ma ke kurrizin? Mos ma ke më të butë se sa barku? ! Ky shikim më bindi edhe më, në hamendësinë time. Mezi prisja, sa të errej që të provoja ato që hamendësoja. U err dhe tek u ngjita tek ajo rrugica e një mbrëmje më parë, tak dhe u afrua"miku" që pa më përshëndetur, hapi krahun me sa fuqi që kishte dhe, kur po matej të gjente vendinmë të përshtatshëm për të goditur, unë, sakaq, gishtin në këmbëzën e "Berretës" dhe elashë shakull përdhe. Pastaj, menjëherë, në shtëpinë e parë të fshatit, nën një strehë

– vazhdoi ai, – po erdhi telegrami prej Tirane që thoshte: ”Të kapet vrasësi me çdo kusht! ”- Hë, a e kapën? – s’iu durua dikujt pa pyetur. Dhe Uani: _Gjejgje telegramit tuaj, ju njoftojmë se: ”Viktimën e zumë, po vrasësi na iku! ! ! ”. Të gjithë ia dhamë të qeshurit. Secili nga ne, shihte tek kjo rrëfenjë diçka të sajuar, aty për aty nga Xha Uani, që për rrëfenja të tilla plot kripë, si ai dhe s’kish shok tjetër. Por nuk kish qenë kështu. Se…

* * *

Kishin kaluar vjete nga kjo histori e xha Uanit. Në shtëpinë tonë erdhi një veteran që veprimtarinë revolucionare (po të shprehem kështu) e kish filluar që në kohën e Zogut. Qe jo vetëm kushëri yni, por dhe vërsnik me tim atë, me të cilin, siç tregonte qe i lidhur ca më tepër.

Unë ca se ma donte puna (isha mësues letërsie) dhe ca se doja të mësoja për atë veprimatri të herëshme të tij, nisa ta ngacmoj me pyetje dhe, kur të gjithë ranë të flenë, unë rashë në dhomë me të. Dhe ç’më tregoi ai, pa e ndryshuar, po e sjell dhe për ju.

Veprimtarinë e kam filluar aty nga vitet 1932- 1933. Në këtë”valle”, si skraparli që jam, më futi Riza Cerova, mik i familjes sonë. Xhaxhai, Pasho Hysi, – tregoi ai, – një mushkë e dërgonte në mulli vetëm për familjen e Rizait. Rizai ishte oficer i Zogut, kishte parë dynja me sy dhe së bashku me oficerë dhe civilë të njohur, formuan një organizatë që u kodua me siglën”Dora e zezë”. Pra, ai më futi në “valle” dhe, sado që ne qemë në gjendje të mirë ekonomike, më dërgoi me”shërbim” në Ndërmarrjen Botore në Fier. Isha si punëtor përgjegjës (kishim kudo njerëzit tanë) dhe për të banuar, rrija tek Ndrizka, në Portëz ku ka shumë skraparlinj.

Bëja sikur punoja, po, për të mos i ngrënë hakën, edhe Lartmadhëria nuk e hante thatë. Na mbante nën vëzhgim. Në Fier, në atë kohë komandant i xhandarmërisë ishte një matjan, besnik i Lartmadhërisë, Mestan quhej. Sa herë shkëmbehesha me të (Mestanin), ky m’i ngulte

loke s’ia kanë munguar trimat. Po, hej, -shfyu përsëri, -pritna zot rrezikun! Përnjimend ka me dalë atje, dobare, ndonjë Isuf? ! -A ke ndie për Isufin, a? -Jo, bacali!

Oh, -bëri. Gati u korita. Mirë pra, Isufi asht i ati i Lutfos. Dhe pa pritur miratimin tim për Lutfon(në të vërtetë Lutfon e njihja dhe ekisha takuar në shtëpinë e Bacës) vazhdoi: -Ka qenë ky Isufi, dy metro burrë! Me të ra plisi prej koke kur po i shti sytë. Po trim? Shok veten. Ka pas ken me Azem Galicën dhe kur Azemi ka dek, ky, Isufi, ka ran kaçak dhe bë tmerr për qeverin aso kohe. Aq tmerr qe ba, sa po kërkohej me flori koka e tij. Po zihej rjolli(shqipja) . Ai po pyjeve, shpellave, maleve dhe, sakaq, grabiste karvane dhe ç’mertte prej tyre, darovë për të vorfër. Familja po kish ra në Shqypni e aj, i vetëm, atje.

Një ditë -bajram paska ken- ka xan vend pas një qivuni të lartë tek vorrezat, veshur tebdil, dhe po pret. Dikush ka me ardh ndaj s’e hup durimin, aj. Kur ç’po sheh? Dy serb(njihehin nga veshjet që larg) janë tuj ardh dhe rruga për aty i bie. E, aj Isufi, tuj prit. Janë tuj avit dhe po etjerrin mirë bisedën. Ç’ka po dëgjon? Po i thotë njani tjetrit: -More Vuk sot asht dita ebajramit dhe bash aty tek varrezat po ua bëjmë nga një mut të madh këtyne kosovarëve. Mirë e ke mendue, -ia ka prit tjetni, që, ça di veta ça po qe qujmë: hajd ta zam: Zuk. E than, e bajn. Aiii? PO pse nuk u shtie, more Isuf? E, ndërsa ulen, Isufi hiç: as i gjallë dhe as i vdekur. Sa mbarojnë”punë”, lidhin pantollet dhe pasi lëshojnë nga një”T’u baj mirë”, bëhen gati me vazhdu rrugë. Kur tak si në hije, shfaqet me dy kobure në dorë, veshur tebdil, Isufi. Dhe, ndërsa afrohet drejt tyre, u thotë: -Jam Isufi I Lutfisë, more? Çfarë bëtë dhe thatë? Serbët, sa dëgjuan emrin, i zuri e zeza, ranë në gjunjë dhe i thanë: -Aman, na falë. -Çfarë thatë? -gjëmoi duke u afruar dhe më! U detyruan të tregojnë dhe Isufi: -Kthehuni dhe hajeni atë që keni ba! Ata: -Aman! -Hajeni se ju vrava! -gjëmoi frikshëm, aj. Dhe u ulën, secli pjesën e vetë, kurse Isufi koburet rranx veshit. Mirëpo kishin dhjerë bajagi(mjaft) dhe s’mbarohej. Aty, si mbillet

zakonisht për sevap në vorre, kish mbjellë do qep e hudra, dhe njani po i lutet Isufit: -A e marr një qepë? Dhe, kështu, me qepë e hudra e mbaruan atë që ban. E, kështu, lum Baca, njerëz si ai RRahmna Morina nuk hahen as me qepë dhe as me hudra. Po ka me dal, opet, (përsëri) ndonji Isuf apo shumë Isufa. Po jan shtu, more jaran, edhe këta që"s'hahem me qep e hudra". Dhe qeshi. Ani, ani, -e mbylli tregimin, – ti ke me epa vetë, se je i ri se Kosova do ikë prej sërbit. Vane vath në vesh prej meje. E unë atëherë s'kam me kan, po ani, ta gëzojnë të rinjtë. Tek u mata që t'i thosha ndonjë fjalë inkurajuese, ma preu: -E i vetë i madhi Zot, por e shoh s'do e arrij dot. Por ta gëzoni bre dhe ti, si e këndue që je, thuje edhe nji fjalë për mue. I premtova duke u larguar dhe, siç e shihni, këtë po eshkruaj në kujtim të tij. Se, sado që e lashë gjallë(po shkonte 90-vjeç) , mora vesh që ka vdekur.

Ah, -them, -sikur të ishte gjallë edhe tani dhe të shihte me sytë etij se si do vejë puna e Kosovës. Që ta shihte se"Isufat" i "mundën ata që "s'hahen as me qep dhe as me hudra"dhe, veç tjerash, të shikonte se si"imperialistët amerikanë" kanë dhënë dhe po japin kontributin më të çmuar për pavarësinë e Kosovës. Sa do të gëzohej! Paqe mbi varrin e bacë Hasan Makës! Amen! . . .

Korrik 2002-maj 2007

"DËGJONI, MILET!…"

Kujtimit të Njeriut të mirë, Uan Janos (Kakani)

Nuk ka fierak që s'e mban mend, Uan Janon (Kakani). Ishte jo vetëm një burrë i zgjuar, por kishte një humor shpotitës që të bënte për vete.

Veçanërisht, humori i tij shpërthente kur xha Uani, ky njeri kaq i mirë, ishte bërë xurxull. Në se njerëzit thonë se ç'ka barku, e nxjerë bardhaku, unë them që në rastin e Uanit, kjo thënie zhvlerësohej. Ai atë që thoshte, e thoshte si i pirë, ashtu dhe i papirë. Se kishte një kurajo të pashoqe dhe nuk ia bënte syri tërr. Po të hynte në klub (më vjen për të qeshur, tek shkruaj kështu se, ku mund të përfytyroheshin klubet pa atë? !)të gjithë do të linin ato që kishin përpara, se e dinin që Uani do të zbrazte ndonjë nga ato: të tijat! Kjo prani e tij qe zakonshme, dhe kurrë nuk u mor vesh pse, ky njeri kaq i mirë, qe dhënë pas pijes. Sidoqoftë, për një" nga ato të tijat" unë do t'ju tregoj. Hyri ai dhe, kur pa që klubi"Partizani" qe mbushur plot, lëshoi thirrjen: "Dëgjoni, milet! "Dhe ndaloi. Një nga ata (i njohur i vjetër, me siguri)pyeti: - Po çfarë të dëgjojmë, more mik? Dhe ai: - Dorë e thatë, s'ka uratë! I pari ia mbushi një dopjo dhe xha Uani, pasi e ktheu"eksi", doli mu në krye të klubit, sikur do të mbante fjalën e rastit. – I vranëLartmadhërisë së Tij, Zogjit I, një mikun e tij, këtu, në Portëz. (1)Njerëzit, të tërë, u bënë sy e veshë. E vranë,